



**RAPORTI VJETOR  
2013**

**KMDP**

P Ë R M B A J T J A

*Fjala e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale . . . . . 5*

**I. POLITIKAT DHE ZHVILLIMET E MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE GJATË VITIT 2013. . . . . 8**

**II. NDËRGJEGJËSIMI DHE ECURIA E REGJISTRIMIT TË KONTROLLUESVE. . . . . 11**

**II.I 28 Janari 2014 “Dita Evropiane e Mbrojtjes së të Dhënave Personale”. . . . . 11**

II.II Aktivitete sensibilizuese për ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale. . . . . 12

- Seminare/Aktivitete.
- Me të rinjtë.
- Komunikimi me Median.
- Të tjera.

II.III Publikime. . . . . 15

- Historiku “5 VJET të autoritetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”(këtej e tutje KMDP).
- Revista “Ligj dhe Privatësi”.
- Të tjera.

II.IV Formularët e njoftimeve dhe ecuria e regjistrimit të subjekteve kontrollues .. 17

- Politika dhe Strategjia në lidhje me regjistrimin e kontrolluesve..
- Menaxhimi i Njoftimeve dhe Regjistrimi i Subjekteve Kontrollues.
- Evidentimi dhe informimi mbi rastet që përbëjnë cënim të privatësisë dhe i të dhënave personale.

**III. PREZANTIMI I KUADRIT LIGJOR . . . . . 24**

III.I Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore. . . . . 24

- Vendime.

■ Udhëzime.	
III.II Strategji, Udhëzues, Kod dhe dokumente të rëndësishëm. . . . .	28
III.III Përfshirja në dhënien e mendimeve për projekt/aktet ligjore, nënligjore dhe projekte të tjera. . . . .	32
■ Raste praktike nga Udhëzimet e miratuara.	
III.IV Praktika e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale . . . . .	38
III.V Ndërtimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucione të tjera. . . . .	39
■ Marrëveshje bashkëpunimi.	
■ Raportime periodike;	
■ Opinione ligjore;	
■ Kthim Përgjigje;	
■ Ofrimi i asistencës ligjore;	
■ Bashkëpunimi me institucione të tjera publike e private;	
■ Bashkëpunimi me ASPA;	
■ Pjesëmarrje.	
III.VI Marrëdhëniet ndërkombëtare. . . . .	49
■ European Projects Awards IPA 2013.	
■ Bashkëpunimi me Frankofoninë.	
■ Bashkëpunimi me T-PD.	
■ Bashkëpunimi me projektin PHAEDRA.	
■ Pjesëmarrja në aktivitetet ndërkombëtare.	
■ Përkthimi i materialeve.	
III.VII Projekti EU - IPA/2009. . . . .	55
<b>IV. ANKESAT DHE KONTROLLI “EX OFFICIO” . . . . .</b>	<b>58</b>
IV.I Ankesat e paraqitura pranë KMDP-së. . . . .	58
IV.II Kontrolli “ex officio” gjatë vitit 2013 . . . . .	62
■ Problematikat e hasura.	
IV.III Kontrollët sipas fushave . . . . .	63

- Institucione Publike.
- Shëndetësi.
- Arsim.
- Subjekte Private.
- Gjyqësori.

IV.IV Gjjobat e dhëna gjatë vitit 2013 .....70

IV.V Ndjekja e proceseve gjyqësore dhe ekzekutimi i vendimeve nga përmbartimi.....71

## **V. ADMINISTRIMI I BRENDSHËM..** ..... 74

V.I Përmirësimi në Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe administrimin e brendshëm të stafit të autoritetit .....74

- Rekrutimi – Konkurimi.
- Lëvizje paralele.
- Emërime të përkohshme me kontratë, komandime dhe lirim nga detyra.
- Disiplina në punë.
- Bashkëpunime me organe të tjera.
- Motivimi i punonjësve.

V.II Menaxhimi Financiar. .... 80

- Përmirësimi në menaxhimin e fondeve publike nëpërmjet planifikimit, zbatimit, përdorimit të tyre me efikasitet, dobi, efektivitet dhe monitorim.
- Planifikimi.
- Zbatimi i buxhetit.
- Shërbime të përgjithshme.
- Monitorimi.
- Të ardhurat e institucionit.

V.III Synimet për të ardhmen. .... 89

- Përmirësimi i burimeve njerëzore, teknike dhe organizative.
- Menaxhim sa më efektiv të burimeve financiare.

## **VI. PËRMBAJTJA E TABELAVE DHE GRAFIKËVE.** .....91

# Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale

## Znj. Flora Çabej



Në 5 vjetorin e krijimit të autoritetit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale sigurisht disa fjalë më shumë në këtë Raport vjetor do të ishin me vend.

Me kalimin e viteve, Komisioneri dhe gjykatat kanë zgjeruar dhe përmirësuar kuptimin e informacionit personal duke përfshirë shumë elemente, nga më të zakonshmet si (emri, adresa, etj) tek më të çuditshmet si (tabulatet telefonike dhe informacionet e shoqërimit të mbledhura nga GPS).

**Në shoqërinë demokratike të informacionit, mbrojtja e së drejtës për të përcaktuar përdorimin e të dhënave personale të dikujt, meriton saktësimin e gjendjes kushtetuese** Njerëzit nuk mund të lihen të vetëm pa mbrojtje në një ambient të tillë si ai i Internetit, i cili ofron mundësi të mëdha rritjeje dhe forma të reja qytetarie. **Ekzistojnë parime të përgjithshme mbi mbrojtjen e të dhënave personale e cila kalon transversalisht në të gjithë sektorët të cilët janë shtrirë edhe në Internet. Do të jetë një rrugë e gjatë, por këtu do të kalojë krijimi i një trupi modern të drejtash për qytetarin.**

Mbrojtja e privatësisë nuk është një pengesë për qarkullimin e të dhënave dhe e përparimit teknologjik, por ne shpresojmë të inkurajojmë njerëzit e përfshirë në secilën nga çështjet tona prioritare për të menduar mbi privatësinë. Qytetarët shqiptarë po përdorin gjithmonë e më shumë internetin ndaj kërkohet një ndërgjegjësimit i përgjithshëm i publikut mbi temën e mbrojtjes së sistemeve kompjuterike dhe të dhënave që ato përpunojnë.

**Siguria dhe mbrojtja e të dhënave personale janë ndër komponentët kryesorë të privatësisë.** Projektuesit e teknologjive të reja, për shembull, mund të përfshijnë përmirësime të ndjeshme lidhur me privatësinë në produktet e tyre.

Ne duam gjithashtu të ndihmojmë njerëzit të kuptojnë vlerën e të dhënave të tyre personale, në mënyrë që ata të jenë të ndërgjegjshëm kur këto të dhëna vihen në rrezik. Të pajisur me mjetet dhe njohuritë e duhura, individët do të mund të ndërmarrin hapa mbrojtës kundër ndërhyrjeve në privatësinë e tyre duke u shndërruar në pjesë aktive duke kontrolluar lëvizjen e informacioneve që ju përkasin.

Sot ndërtimi i një sfere korrekte private është kufiri maksimal i demokracisë.

Puna jonë është inspiruar nga shumë këndvështrime për vetë faktin se në një shoqëri demokratike, mbrojtja e të drejtave themelore të njeriut dhe në veçanti mbrojtja e jetës private dhe e të dhënave personale është në interesin publik dhe detyrë thelbësore për të gjitha institucionet, qofshin ato shtetërore ose jo. Më duhet të them se gjatë këtij viti por edhe pesë viteve në tërësi është bërë shumë që të arrihen standardet e vendeve të BE-së në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, mbështetur fort nga ekspertet evropiane të fushës si në aspektin e miratimit të akteve nënligjore, ndihmën juridike në hartimin e projekt-ligjeve, projekt-akteve të ndryshme në gjithë legjislacionin shqiptar, duke u vlerësuar dhe nga Akademia Evropiane e Projekteve ne Bruksel me çmimin e dytë si përfitues për projektet e përfunduara të EU – IPA/2009.

Fushata të gjëra ndërgjegjësuese janë kryer në lidhje me detyrimet e kontrolluesve të të dhënave për njoftim pranë Komisionerit, për të drejtën e mbrojtjes së jetës private si dhe janë realizuar hetime rigorozë në bazë ankese ose *ex officio* në një numër të madh kontrolluesish publik ose privat. Edhe pse deri më sot janë hedhur hapa të rëndësishëm në forcimin e këtij institucioni, ende më shumë mbetet për t'u bërë, sepse sfida të reja që rrezikojnë jetën private të qytetarëve shfaqen çdo ditë. Sot ashtu si dhe dje sfida më e madhe për mua si Komisionere tek e cila kam ngulmuar fort dhe tek e cila impenjohem me të gjithë forcat në punën time çdo ditë është synimi që çdo qytetar shqiptar të jetë i vetëdijshëm se gëzon të drejtën t'i respektohet jeta e tij private, se gëzon të drejtën t'i mbrohen të dhënat e tij personale, se gëzon të drejtën të ankohet pranë Komisionerit në rast se kjo e drejtë i cënohet.

Faleminderit.



## I. POLITIKAT DHE ZHVILLIMET E MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE GJATË VITIT 2013.

Gjatë vitit 2013 Autoriteti i Komisionerit është angazhuar maksimalisht në sensibilizimin e subjekteve me qëllim respektimin e Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Autoriteti i Komisionerit ka organizuar disa seminarë me përfaqësuesit e Institucioneve Arsimore në rrethe të ndryshme të Shqipërisë në lidhje me ndërgjegjësimin e stafit pedagogjik dhe drejtuesve të institucioneve arsimore për të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Komisioneri ka qenë shumë aktiv në takimet me të rinjtë, në kuadër të sensibilizimit të kësaj grupmoshe dhe ka organizuar aktivitete ndërgjegjësuese për dëmet që mund të shkaktohen nga përhapja e të dhënave personale në internet dhe të drejtën e tyre për të mbrojtur jetën private. Gjithashtu KMDP ka intensifikuar marrëdhëniet me Median duke marrë pjesë në disa talk-show televiziv, intervista si dhe deklarata për median.

Në vazhden e fushatës sensibilizuese, në lidhje me detyrimin për njoftim pranë Autoritetit të Komisionerit ka vazhduar procesi i dërgimit të shkresave informuese, me anë të të cilave i kërkojmë subjekteve kontrollues që të zbatojnë detyrim ligjor për të njoftuar, po ashtu janë organizuar seminarë në rrethe të ndryshme për këtë qëllim. Në shërbim të procesit të njoftimit janë asistuar subjektet kontrolluese që njoftojnë, është kryer komunikimi telefonik si dhe janë pritur për sqarim dhe asistencë një numër i konsiderueshëm subjektesh kontrolluese, për rrjedhojë janë hedhur në sistem njoftimet e ardhura me anën e formularit të plotësuar.

Në zbatim të kompetencave që ligji i atribuon, KMDP ka hartuar dhe miratuar një sërë aktesh nënligjore në fusha të ndryshme, akte të brendshme administrative, dokumente të tjerë të rëndësishëm që orientojnë kontrolluesit në punën e tyre gjatë përpunimit të të dhënave personale, etj. Tashmë numri i udhëzimeve të miratuara ka arritur në 39 udhëzime. Kryesisht udhëzimet synojnë një zbatim rigoroz të ligjit për përpunimin e drejtë e të ligjshëm të të dhënave personale si dhe marrjen dhe përdorimin e masave të sigurisë për mbrojtjen e të dhënave si për sektorin publik dhe për atë privat. Gjithashtu, janë miratuar 6 Vendime, janë dhënë disa rekomandime, janë hartuar e miratuar manuale, udhërrëfyes, është përgatitur, publikuar e botuar historiku 5 vjeçar si dhe është miratuar dokumenti mjaft i rëndësishëm për evidentimin e objektivëve në të ardhmen dhe hapat e ndërmarrë për përmbushjen e tyre, strategjia institucionale, etj. Është punuar intensivisht në dhënien e mendimeve për projekt/aktet ligjore dhe nënligjore të adresuara pranë KMDP-së. Megjithatë, përsëri numri i dhënies së mendimeve për projektligje për vitin 2013 mbetet ende i vogël dhe padyshim kërkon nxitje të kontrolluesve me qëllim disiplinimin e tyre për dërgim të çdo akti që prek fushën e të dhënave personale për mendim pranë KMDP-së. Janë dhënë opinione, është ofruar asistencë ligjore si dhe është raportuar në kuadër të Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (2012-2015) dhe jo vetëm.

Janë nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me kontrollues publik dhe privat duke i dhënë rëndësi bashkëpunimit ndër-institucional për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi dhe për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale në veçanti.

KMDP gjatë 2013 është angazhuar në organizimin efikas të pritjes së ankesave të subjekteve të të dhënave, verifikimeve të tyre nëpërmjet hetimit administrativ dhe marrjes së vendimeve të bazuara në ligj për zgjidhjen e tyre. Gjithashtu KMDP ka ushtruar kontrolle dhe inspektime administrative **ex officio në 213** kontrollues të ndryshëm publik dhe privatë.

KMDP bashkëpunoi ngushtësisht me projektin EU - IPA/2009 edhe në periudhën e zgjatjes së tij që pikërisht i takoi këtij viti, në kuadër të përgatitjes së moduleve për të trajnuar personat e ngarkuar, për të trajnuar trajnerët si dhe në arritjen e trajnimit të thelluar të një grupi rreth 34 persona të ngarkuar nga kontrolluesit publik të cilët në mbyllje të projektit u certifikuan nga ky i fundit.

Po ashtu autoriteti ka bashkëpunuar edhe me autoritetet homologe për të shkëmbyer praktikat më të mira apo ka dhënë mendime për projekte të ndryshme kryesisht në T - PD, komitet konsultativ në të cilin jemi anëtarë me të drejtë vote.

KMDP, në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit është mbështetur në nevojat më të domosdoshme institucionale në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji organik mbi të cilat ushtron veprimtarinë e tij, si dhe mbi parimet e menaxhimit të fondeve publike me efektivitet, transparencë, ekonomi dhe efikasitet.

Për të gjitha këto raporti detajon më poshtë pritshmëritë konkrete në fusha, zëra e shifra.



## II. NDËRGJEGJËSIMI DHE ECURIA E REGJISTRIMIT TË KONTROLLUESVE.

### II.I 28 Janari 2013 “Dita Evropiane e Mbrojtjes së të Dhënave Personale”.

Në datën 28 Janar 2013 me rastin e Ditës Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Komisioneri ka organizuar si çdo vit disa aktivitete për të kremtuar këtë Ditë si dhe për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve në lidhje me të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Në lidhje me këtë datë të shënuar, janë organizuar:

- Dita e Hapur për qytetarët ku u ftuan të merrnin pjesë qytetarë të interesuar në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale;
- Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Rektoratin e Universitetit të Tiranës;
- Konkursi i fotografisë me temë “Mbroni Privatësinë” me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Edith Durham”.

Me qëllim pasqyrimin e aktiviteteve të zhvilluara në të gjitha shtetet anëtare në faqen zyrtare të Këshillit të Evropës, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka dërguar në një format të përcaktuar më parë nga Këshilli i Evropës të gjitha aktivitetet e zhvilluara prej tij me rastin e 28 janarit 2013.

#### [Foto 28 janar 2013](#)



## II.II Aktivitete sensibilizuese për ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale.

### ■ Seminare/Aktivitete.

Gjatë vitit 2013, **Autoriteti i Komisionerit Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka organizuar disa seminarë me përfaqësuesit e Institucioneve Arsimore në rrethe të ndryshme të Shqipërisë** në lidhje me ndërgjegjësimin e stafit pedagogjik dhe drejtuesve të institucioneve arsimore për të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Këto seminare janë zhvilluar në Drejtorinë Arsimore të Rrethit Berat, të Rrethit Lezhë, të Rrethit Përmet dhe të Rrethit Tiranë.

**Në datat 21, 22 Shkurt si dhe 4, 5, 18, 19 mars 2013 janë organizuar seminare pranë Prefekturës së Qarkut të Tiranës** me qëllim ndërgjegjësimin e përfaqësuesve të njëjësive vendore të rrethit Tiranë mbi përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale dhe detyrimin e tyre ligjor, sipas nenit 21 të Ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” për të njoftuar pranë Komisionerit.

**Në vazhden e ngritjes profesionale edhe të vetë stafit të autoritetit,** paralelisht kjo me zhvillimet e vrullshme të teknologjisë së informacionit dhe kërkesave që sa vijnë e rriten për njohuri të thella në këtë fushë, në datë 29 Prill, **Autoriteti i Komisionerit zhvilloi një ËëbKonferencë me përfaqësuesit e rrjetit social Facebook** me seli në Irlandë e cila është edhe selia e kompanisë që mbulon Shqipërinë. Ëëbkonferenca që drejtohej nga dy menaxhere të Kompanisë u ndoq nga i gjithë stafi i Komisionerit.

Me datë 07 Qershor përfaqësues të Administratës Publike qëndrore dhe të institucioneve të varësisë përfunduan trajnimin dy mujor të organizuar dhe financuar nga projekti i BE “Mbështetje ndaj Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale lidhur me trajnimin e personave të kontaktit për mbrojtjen e të dhënave në sektorin publik shqiptar”. Me këtë rast pranë Autoritetit të Komisionerit u organizua dhe ceremonia e ndarjes së çertifikatave.

### ■ Me të rinjtë.

Në vazhden e takimeve të shumta me të rinjtë, në datë 15 shkurt, në ambientet e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Znj. Çabej priti grupin e studentëve të Masterit në Shkenca Politike të Universitetit të Tiranës mbi kërkesën e këtyre të fundit, të cilët i njohu gjerësisht me të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Në 26 Prill, **Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale së bashku me Fakultetin e Drejtësisë dhe me asistencën e Projektit projektit të BE-së “Mbështetje ndaj Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KMDP) lidhur me trajnimin e personave te kontaktit/të ngarkuar për mbrojtjen e te dhënave ne sektorin publik shqiptar” organizuan Konferencën “Dimensionet e reja në Ligjin për Privatësinë”** me pjesëmarrjen e rreth 240 studentëve të fakultetit të Drejtësisë. Në konferencë mbajtën fjalën e tyre Znj. Flora Çabej

(Pogaçe), Komisionerja për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Z. Altin Shegani Dekan i fakultetit të Drejtësisë së Universitetit të Tiranës, Z. Andras Jori – ekspert evropian dhe Ish Komisioneri Hungarez për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale, Znj. Dorota Skolimowska Team Leader i Projektit në Shqipëri, Z. Stefan Sysko – ekspert evropian në fushën e Teknologjisë së Informacionit si dhe Znj. Evisa Kambellari pedagoge në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës. Për studentët u shpërndanë edhe çertifikata pjesëmarrje. **Në 23 Maj përfaqësues të Autoritetit të Komisionerit në bashkëpunim me Drejtorinë e shkollës nëntëvjeçare “Dora d’Istria” në Tiranë organizuan një takim ndërgjegjësues me nxënësit e kësaj shkolle me qëllim sensibilizimin e tyre mbi fushën tepër të rëndësishme të mbrojtjes së të dhënave personale. Gjatë këtij takimi u plotësua dhe një pyetësor në lidhje me përdorimin e rrjeteve sociale nga kjo grupmoshë, rezultatet e të cilës janë publikuar në faqen zyrtare të Komisionerit. Nga ky pyetësor rezultoi se, **95.8%** e tyre kanë një profil në rrjete sociale dhe se **vetëm 4.2 %** e tyre nuk kanë. **54%** e tyre kanë mbi 200 miq virtual, ndërsa 30 % e tyre kanë takuar miqtë virtualë që nuk i njihnin më parë.**

**Po në këtë muaj në shkollën nëntëvjeçare “Nonda Bulka” në Përmet përfaqësues të Komisionerit organizuan disa takime me nxënësit dhe mësuesit e kësaj shkolle me qëllim ndërgjegjësimi e tyre për mbrojtjen e jetës private.**

**Në kuadër të sensibilizimit të kësaj grupmoshe gjatë muajit nëntor me rastin e 20 Nëntorit, Ditës Botërore të Konventës së të Drejtave të Njeriut, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka organizuar një aktivitet ndërgjegjësues me nxënësit e shkollë 9 vjeçare Faik Konica në Tiranë me qëllimin e ndërgjegjësimi të fëmijëve për dëmet që mund të shkaktohen nga përhapje e të dhënave personale ne internet dhe të drejtën e tyre për të mbrojtur jetën private. Në kuadër të implementimit të marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar në këtë vit me Rektoratin e Universitetit, 12 studentë të Masterit Shkencor në Drejtësi kanë zhvilluar praktikën mësimore pranë Autoritetit të Komisionerit.**

[Foto të aktiviteteve me të rinjtë.](#)



Duke qenë se në ligj është parashikuar bashkëpunimi me kontrolluesit, vërehet dukshëm që autoriteti ka synuar me të gjithë mjetet dhe mënyrat ligjore të nxisë këtë bashkëpunim me forma të ndryshme, ndër të cilët marrëveshjet e bashkëpunimit. Këto të fundit kanë rezultuar aktive dhe kanë bërë të mundur ndërgjegjësimin e një kategorie të ndjeshme subjektsh siç është ajo e studentëve në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale si dhe veçanërisht informimin e tyre të vazhdueshëm nëpërmjet takimeve në zyrën e Komisionerit.

#### ■ Komunikimi me Median.

Gjatë vitin 2013, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka intensifikuar marrëdhëniet me Median duke marrë pjesë në disa talk-show televiziv, intervista si dhe deklarata për median. Konkretisht, Komisioneri :

- **ka marrë pjesë në disa talk show televiziv**, në Top Channel, Albanian Screen, UTV dhe SCAN TV;
- **ka dhënë disa intervista** të pasqyruara kryesisht në edicionet e lajmeve mbi inspektimet e fundit të tij apo prononcime mbi çështjet më të ndjeshme të mbrojtjes së të dhënave personale;
- **ka dhënë një deklaratë** për media në lidhje me publikimin e të dhënave personale të denoncuesve të korrupsionit (qytetarëve) në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.
- **Një kronikë e veçantë është transmetuar nga Brukseli në televizionin Top News në të cilën u pasqyrua marrja e çmimit të dytë nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për Projektin më të mirë IPA 2012**, të akorduar nga Shoqata e Projekteve Evropiane.

**Autoriteti i Komisionerit ka dhënë disa rekomandime** për të përditshmet shqiptare në lidhje me respektimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe jetës private të qytetarëve, nga ana e gazetarëve të medias së shkruar dhe asaj elektronike dhe veçanërisht:

- për fshirjen e të dhënave të një nëne të re në lajmet e kronikës të të përditshmeve shqiptare,
- në lidhje me publikimet e të dhënave personale të shtetas F.P.
- për mos publikimin e të dhënave personale të të miturve viktimë të krimit për arsye të viktimizimit për herë të dytë si dhe të të miturve të përfshirë në një ngjarje krimi për aq kohë sa ekziston e drejta e prezumimit të pafajsisë.

#### ■ Të tjera.

**Në bashkëpunim me Facebook Ireland është bërë e mundur fshirja e profileve fallco Facebook** të dy qytetarëve shqiptarë që iu drejtuan për ndihmë Komisionerit për të bërë të mundur fshirjen sa më të shpejtë të këtyre llogarive fallco.

**Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale** për të ardhur më pranë të rinjve dhe përdoruesve të rrjeteve sociale gjatë vitit 2013, **ka hapur një profil zyrtar të Autoritetit në rrjetin social Facebook** nëpërmjet të cilit pasqyron informacionet më të fundit mbi mbrojtjen e të dhënave personale

**Për të ardhur sa më pranë publikut dhe nëpërmjet komunikimit online**, gjatë muajit dhjetor është ngritur grupi i punës së Autoritetit të Komisionerit për realizimin e faqes së re zyrtare të Komisionerit për të arritur një përfaqësim sa më efikas dhe bashkëkohor tek lexuesi.

**Gjithashtu shikueshmëria e faqes zyrtare të Internetit ka pasur rritje të ndjeshme në krahasim** me vitin e kaluar sipas tabelës së paraqitur në **pjesën VI**.

Për menaxhimin sa më të sigurtë të informacionit elektronik, Sektori i IT-së ka realizuar dy seminare të brendshëm ku është shpjeguar për të gjithë stafin e KMDP-së “Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Informacionit të Brendshëm. (Menaxhim dokumentash dhe protokollit, kërkim deklarimesh)” si dhe “Masat praktike të sigurisë për sistemet dhe të dhënat”.

## **II.III Publikime.**

### ■ Historiku “5 VJET KMPD”

Është përgatitur Historiku i veprimtarisë së punës së Komisionerit për vitin 2008-2013. Ky historik paraqet themelet e krijimit të Autoritetit, vështirësitë dhe hapat e ndërmarrë për organizimin dhe funksionimin e institucionit, angazhimet për të kryer detyrat e ngarkuara me ligj dhe sfidat që na prisnin për vitet në vazhdim.

Përformanca e përdorimit të fondeve buxhetore me efektivitet, ekonomi dhe efikasësi, konstatohet në këtë tekst dhe në realizimin e shpenzimeve buxhetore duke përmendur se nga viti i parë i ushtrimit të veprimtarisë ekonomiko-financiare kurba e realizimit ka ardhur gjithnjë në rritje.

Gjithashtu është evidentuar puna intensive e bërë për hartimin dhe miratimin e disa prej akteve të para por tepër të rëndësishëm në zbatimin rigoroz të ligjit, si p.sh hartimi dhe miratimi i Formularit të Njoftimit, krijimi i Regjistrimit online të hapur për publikun, i gjithë kuadri ligjor i miratuar nga Komisioneri në këto 5 vite si dhe hartimi i dokumenteve të rëndësishëm në shërbim të autoritetit dhe jo vetëm..

Në të trajtohet gjerë mbikëqyrja dhe hetimi administrativ, si një nga kompetencat kryesore të Komisionerit. Trajtohet gjithashtu angazhimi maksimal i treguar në çdo fazë të hetimit administrativ duke prodhuar rezultate pozitive dhe duke influencuar direkt në minimizimin e riskut të cënimit të privatësisë dhe të dhënave personale të mbledhura dhe përpunuara nga kontrolluesit. Rastet e inspektimeve janë paraqitur të ndarë sipas fushave, ankesave të individëve apo dhe hetimit ex officio.

Në këtë historik sipas kronologjisë në vite, janë radhitur marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim shkëmbimin e ndërsjellë të eksperiencave e praktikave më të mira si dhe zbatimin e legjislacioneve respektive.

Është vlerësuar të përmendet në këtë historik Projekti IPA 2009, i financuar nga BE-ja: “Për Konsolidimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri në Përputhje me Standartet e Bashkimit Evropian” i cili asistoi KMDP në pothuajse 3 vite si dhe për rezultatet e arrira. Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare dhe anëtarësimi në organizma ndërkombëtarë janë rezultat i punës 5 vjeçare.

E gjithë sa parashtruar më lart por dhe të tjera ilustrohen dhe me foto në këtë botim duke e bërë këtë tekst gjithëpërfshirës dhe interesant për këdo që e lexon po ashtu dhe një standart që ka pasuruar bibliotekën tonë institucionale.

### ■ Revista “Ligj dhe Privatësi”

Autoriteti i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka themeluar dhe botuar gjatë vitit 2013 Revistën periodike juridike “Ligj dhe Privatësi”. Revista është organ i autoritetit të Komisionerit i cili shoqërohet edhe me rregulloren përkatëse, bordin i cili njihet, vlerëson dhe konsideron artikujt që publikohen si dhe ndjek monitorimin e kësaj veprimtarie për të rezultuar sa më e suksesshme. Kjo revistë synon të plotësojë literaturën juridike me njohuri praktike dhe teorike në ndihmë të qytetarëve, studentëve, pedagogëve, punonjësve të administratës, personave të ngarkuar si dhe të gjithë të interesuarve në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, të jetë një kënd i informacionit juridik, debateve bashkëkohore, të ofrojë njohuri mbi autoritetet ndërkombëtare të mbrojtjes së të dhënave personale, bashkëpunimet ndërkombëtare, të përcjellë informacionin më të fundit nga të rejtat e fushës nën një vështrim krahasues, si dhe të japë një informacion për veprimtaritë e Autoritetit të Komisionerit.

**Numri i parë i revistës “Ligj dhe Privatësi”,** i cili është shpërndarë dhe pranë institucioneve publike dhe ndërkombëtare më të rëndësishmet në vend më, pasqyron një editorial nga Komisionerja, artikuj mbi ndryshimet e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe risitë që solli, mbi zhvillimin e teknologjisë së komunikimit dhe mbrojtjen e jetës private, intervista nga ekspertë ndërkombëtarë të mirënjohur në fushën e të dhënave personale, kazuse nga inspektimet e autoritetit si dhe fotografi nga aktivitetet e fundit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në muajin dhjetor ka përfunduar **numri i dytë të Revistës “Ligj dhe Privatësi”.** Ky numër përmban një editorial nga Komisionerja, artikuj mbi të drejtën e informimit, mbi limitet në mbledhjen e të dhënave personale, mbi cloud computing, mbi procesin e njoftimit në funksion të qytetarit, kazuse nga inspektimi, si dhe foto nga veprimtaria e Komisionerit për periudhën korrik-dhjetor 2013.



■ Të tjera.

- Këtë vit është realizuar një *flyer* me titull “Mbrot të dhënat e tua kur përdor telefonin smarphone ose tablet”. Ky *flyer* është publikuar dhe në profilin zyrtar në Facebook për të sensibilizuar pikërisht përdoruesit e shërbimeve të internetit për rreziqet e privatësisë së tyre nëpërmjet përdorimit të smartphoneve dhe tableteve.
- Është përkthyer dhe publikuar në faqen tonë zyrtare informacioni mbi 10 çështjet e mbrojtjes së të dhënave personale në facebook. Ky informacion është përgatitur nga *Facebook Ireland Data Protection Authority Casework Team*.

**II.IV Formularët e njoftimeve dhe ecuria e regjistrimit të subjekteve kontrollues.**

■ Politika dhe Strategjia në lidhje me regjistrimin e kontrolluesve.

KMDP për periudhën Janar-Dhjetor 2013 vijoi punën në përmbushje të detyrimit ligjor që përcakton neni 21, i Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i

ndryshuar i cili detyron të gjithë subjektet kontrollues si përpunues të dhënash të individëve, të njoftojnë pranë autoritetit të Komisionerit.

**Në këtë kuadër, kemi vazhduar procesin e sensibilizimit të subjekteve kontrolluese** si nëpërmjet dërgimit të shkresave informuese, me anë të të cilave i kërkojmë këtyre subjekteve që të zbatojnë detyrim ligjor për të njoftuar, po ashtu edhe me seminare të organizuara në rrethe të ndryshme për këtë qëllim.

**Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr. 5048 Prot dhe Nr. 100 Prot, Dt. 29.04.2010 të lidhur ndërmjet KMDP-së dhe QKR-së është mbajtur komunikim i vazhdueshëm** me Specialistin e IT-së së QKR-së për të bërë të mundur sigurimin e listës me subjektet kontrolluese që janë regjistruar rishtazi pranë kësaj qendre. Në fund të muajit Shkurt u dërgua pranë nesh lista me subjekte të reja të regjistruara pranë QKR-së për periudhën Janar 2012- Janar 2013 dhe në muajin shtator lista me subjekte të regjistruara deri në shtator 2013. Duke u bazuar në këto lista vijoi sensibilizimi i subjekteve kontrolluese.

**Kemi bashkëpunuar me personin e kontaktit/të ngarkuar të ISKSH-së, prej nga na u vu në dispozicion lista me adresat elektronike të subjekteve kontrolluese “farmaci”.** Këtyre subjekteve kontrolluese, i kemi dërguar nëpërmjet postës elektronike 773 shkresa sensibilizuese me qëllim njohjen me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe detyrimin për të njoftuar pranë autoritetit të Komisionerit.

Ky sensibilizim nuk pati rezultatin e pritshëm, pasi vetëm një pjesë e këtyre subjekteve kontrolluese iu përgjigjën shkresës tonë duke realizuar detyrimin për njoftim nëpërmjet plotësimit të Formularit të Njoftimit. Kjo erdhi për shkak të pasaktësive që kishin adresat elektronike në pjesën më të madhe të tyre por edhe sepse disa prej subjekteve që morën dijeni nuk e zbatuan detyrimin ligjor për njoftim, duke ju shtuar listës së gjatë të subjekteve ndaj të cilëve mund të vendoset gjobë, por Komisioneri nëpërmjet Drejtorisë së Hetim-Inspektimit nëpërmjet inspektimeve direkt pranë kontrolluesve ka ndjekur strategjinë e vendosjes së afatit 48 orësh në mbi 30 raste. Kjo strategji ka bërë të mundur që për aq kontrolle sa janë ushtruar të plotësohej detyrimi për të njoftuar dhe vetëm një një rast është marrë masa administrative me gjobë pasi subjekti kontrollues nuk njoftoi brenda këtij afati.

Në vazhden e fushatës sensibilizuese, në lidhje me detyrimin për njoftim pranë autoritetit të Komisionerit, ju kemi dërguar **shkresa sensibilizuese të gjitha Gjykatave të rretheve**, të cilat kanë reaguar menjëherë dhe zbatuan detyrimin ligjor për njoftim.

Prioritet dhe objektiv tjetër i arrirë mund të përmendet edhe asistenca e vazhdueshme që i është ofruar kontrolluesve që njoftojnë, me qëllim plotësimin në mënyrë sa më të saktë të formularit të njoftimit. Kjo asistencë ju është ofruar nëpërmjet komunikimeve telefonike, postës elektronike dhe duke i pritur përfaqësuesit e këtyre kontrolluesve pranë Zyrave të KMDP-së.

**Tashmë, vihet re një përqindje më e lartë saktësie në deklaram nga ata kontrollues që e kanë marrë këtë asistencë.**

Gjithashtu, ushtrimi i kësaj kompetence për të bërë të mundur përmbushjen e këtij detyrimi është përfshirë intensivisht edhe në strategjinë e përgjithshme sensibilizuese të autoritetit të Komisionerit. Në të gjithë seminarët e organizuara si nga vetë KMDP ashtu dhe nga ITAP-i, (sot ASPA/Shkolla e Administratës Shqiptare), është prezantuar e shpjeguar në praktikë nëpërmjet power-point *“Detyrimi ligjor që kanë kontrolluesit për të njoftuar, si dhe mënyra se si duhet plotësuar Formulari i Njoftimit”*.

Në këtë kuadër, gjatë muajve Shkurt-Mars 2013, kemi marrë pjesë *në një tur seminaresh të organizuara pranë Prefekturës së Këshillit të Qarkut Tiranë*, me përfaqësuesit e pushtetit lokal si dhe në seminarët e organizuara nga ITAP-i, me personat e ngarkuar të subjekteve kontrollues publik.

**Të gjithë pjesëmarrësve në këto aktivitete i janë shpërndarë materiale të ndryshme si fletëpalosje dhe broshura, qëllimi i të cilave është pasqyrimi i veprimtarisë së autoritetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë Autoritetit të Komisionerit si dhe njohja e subjekteve të të dhënave me të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe të jetës private.**

Gjithashtu, në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit Nr. 396 Prot, datë 24.01.2011, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Institucionit tonë, është vazhduar puna për zhvillimin e aktiviteteve në sektorin e arsimit.

Në këtë kuadër, është bashkëpunuar ngushtë me Drejtoritë Arsimore Berat, Lezhë, Përmet si dhe me Drejtorinë Arsimore të Këshillit Qarkut Tiranë për realizimin e seminareve pranë këtyre qendrave, si më poshtë:

Në *muajin Prill* në ambientet e Drejtorisë Rajonale Arsimore Berat, u zhvillua seminari me përfaqësuesit e Institucioneve Arsimore të këtij qyteti. Në këtë aktivitet morën pjesë rreth 80 subjekte kontrollues *“shkolla”* publik dhe privat.

Në *muajin Maj*, në ambientet e Shkollës *“Besëlidhja”*, u zhvillua seminari me përfaqësuesit e Institucioneve Arsimore Lezhë. Në këtë aktivitet morën pjesë rreth 80 subjekte kontrollues *“shkolla”* publik dhe privat.

Po *në muajin Maj*, në ambientet e Shkollës 9-vjeçare *“Nonda Bulka”*, u zhvillua seminari me përfaqësues të sektorit arsimor dhe atij të pushtetit lokal. Në këtë aktivitet morën pjesë rreth 40 subjekte kontrollues publik dhe privat.

Në *muajin Qershor*, në ambientet e Drejtorisë Arsimore të Qarkut Tiranë, u zhvillua seminari me përfaqësuesit e këtij institucioni. Në këtë aktivitet morën pjesë rreth 80 subjekte kontrollues *“shkolla”* publike dhe private.

**Qëllimi i këtyre aktiviteteve ishte** njohja e kontrolluesve të të dhënave personale me ligjin nr. 9887 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të ndryshuar, me **“Detyrimin për Njoftim”** pranë Autoritetit së Komisionerit, si dhe njohja e subjekteve të të dhënave me të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe të jetës private.

**Të gjithë pjesëmarrësve në këto aktivitete iu dha asistenca e duhur për plotësimin e Formularit të Njoftimit si dhe iu shpërndanë materiale të ndryshme** si fletëpalosje dhe broshura, qëllimi i të cilave është pasqyrimi i veprimtarisë së autoritetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe njohja e subjekteve të të dhënave me ushtrimin e të drejtës së tyre.

Gjithashtu, nisur nga bisedat konstruktive që morën nxitje në momente të ndryshme të seminarit, problematika të ndryshme të ngritura apo ankesa të ndryshme nga ana e këtyre subjekteve herë si përfaqësues të kontrolluesve por më tepër si vetë subjekt i të dhënave personale, u përcollën në strukturat përkatëse të Autoritetit të Komisionerit sipas rastit apo problematikës.

Produkti final dhe shumë i rëndësishëm i këtyre seminareve ka qenë formulari i njoftimit, për të cilin subjektet u trajnuan se si ti kuptojnë drejt kërkesat e tij dhe u asistuan se si ta plotësojnë atë në mënyrën më të mirë të mundshme me qëllim dhënien e informacioneve që kërkon ky detyrim ligjor.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, *Drejtorive Arsimore dhe Zyrave Arsimore* iu dërgua nga ana jonë **p/rregullorja tip “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”**, të cilën këto institucione arsimore mund ta përshtatin sipas nevojave të aktivitetit të tyre.

Janë bërë përpjekje për të vendosur një bashkëpunim ndërmjet Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe KMDP-së, me qëllim sensibilizimin e subjekteve kontrolluese në sektorin e punësimit, pasi Shërbimi Kombëtar i Punësimit është institucion kombëtar përgjegjës për zbatimin e politikave shtetërore të punësimit, shtrin veprimtarinë e tij përmes 36 zyrave të punësimit në të gjithë Republikën e Shqipërisë dhe ndër të tjera ka si partner kryesor biznesin.

Në këtë kuadër, bashkëpunimi do të konsistonte në mundësimin dhe vënien në dispozicion të listës së subjekteve që disponojnë, shoqëruar me adresat postare gjithashtu dhe ato elektronike për lehtësi komunikimi. Ky regjistër, do të na vinte në ndihmë dhe do të na shërbente si një platformë efektive me qëllim vijimin e sensibilizimeve tona të vazhdueshme. Ka ardhur përgjigje pozitive në lidhje me këtë angazhim nga ana e SHKP dhe tashmë jemi në pritje të nënshkrimit të saj.

#### ■ Menaxhimi i Njoftimeve dhe Regjistrimi i Subjekteve Kontrollues.

Ndër objektivat tonë në vite përveç menaxhimit me efikasitet të procesit të deklarimit nga ana e kontrolluesve, ka qenë rritja e numrit të njoftimeve. Kjo rritje është e lidhur ngushtë dhe shkon paralelisht me procesin e sensibilizimit të subjekteve kontrollues publik dhe privatë. Pavarësisht

shfrytëzimit maksimal të burimeve dhe kapaciteteve të Autoritetit të Komisionerit, njoftimet për përpunimin e të dhënave për vitin 2013 kanë vazhduar por jo me një ritëm të pëlqyeshëm. Kjo për arsye se në vitet e kaluara kemi pasur në dispozicion bazuar edhe në marrëveshjen me QKR-në por jo vetëm, më shumë burime ku të mbështeteshim për kryerjen e sensibilizimeve të shumta në numër. Në këtë ecuri vlerësojmë se ka ndikuar edhe fakti i ndodhjes në një vit elektorale edhe se Drejtori dhe një specialist i kësaj drejtorie (Drejtorisë së Rregjistrimit) nuk kanë punuar me efikasitet deri në neglizhim të detyrës, për të cilën janë marrë edhe masat disiplinore respektive.

Sensibilizimet gjatë vitit 2013 nëpërmjet shkresave nuk kanë qenë të mjaftueshme megjithë ezaurimin maksimal, pasi **listat e siguruara nga QKR-ja të subjekteve që regjistrohen rishtas janë të pakta në numër si dhe jo plotësisht të shfrytëzueshme për shkak se shumë subjekte nuk japin adresat e plotë** dhe për rrjedhojë posta kthen një numër të konsiderueshëm shkresash nga totali i dërguar pavarësisht se ne bëjmë një seleksionim paraprak. Në këto kushte u gjetën dhe vazhdojmë të eksplorojmë mënyra alternative për të rritur ndërgjegjësimin dhe numrin e njoftimeve. Janë zhvilluar seminare në shumë rrethe të vendit me bashkëpunimin e Drejtorive Arsimore dhe për këtë arsye në shifrën totale të njoftimeve sektori publik zë 50 % të njoftimeve.

Përsa informohet më sipër, për identifikimin e subjekteve kontrolluese private nëpërmjet Listës së Personave Juridik dhe Fizik të Regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), si dhe listës së ardhur nga ISKSH-ja me adresat elektronike të subjekteve kontrollueses "*farmaci*", KMDP për periudhën Janar-Dhjetor 2013, ka dërguar rreth **2011** (e-mail **773**) shkresa zyrtare sensibilizuese drejtuar subjekteve kontrolluese private dhe publike, duke i kërkuar plotësimin e detyrimit për njoftim, bazuar në Nenin 21-26 të Ligjit. Numri i përgjithshëm i shkresave sensibilizuese ka arritur në **17265**.

Gjithashtu, në sajë të politikës dhe strategjisë së autoritetit për të ndihmuar e asistuar subjektet kontrolluese që njoftojnë, është kryer në vazhdimësi komunikimi telefonik si dhe janë pritur për sqarim dhe asistencë një numër i konsiderueshëm subjektesh kontrolluese.

Bazuar në Nenin 23 të Ligjit, kemi trajtuar nëpërmjet kërkesës për informacion plotësues çdo deklaram që ka rezultuar i paplotë, i paqartë, si dhe për të verifikuar më tej ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave nga kontrolluesi deklarues, si dhe në kuadrin e paraqitjes së kërkesave për autorizimin e Komisionerit për përpunimin e të dhënave sensitive dhe transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale.

Procedurat më tej kanë vijuar me hedhjen në sistem të të gjitha njoftimeve të ardhura me anën e formularit të plotësuar manualisht dhe dërguar apo dorëzuar me postë pranë autoritetit të Komisionerit. Numri i njoftimeve të ardhura nga subjektet kontrolluese për këtë periudhë ka qënë **582** duke e çuar numrin e përgjithshëm të njoftimeve në **4086**.

Gjithashtu, në përfundim të këtij procesi, kemi vijuar me regjistrimin për njoftimet që rezultojnë dhe deklarojnë se respektojnë përpunimin e të dhënave personale konformë kërkesave të neneve 5

dhe 6 të Ligjit, pra publikimin online në Regjistrin e Hapur për Publikun. Numri i subjekteve kontrolluese të regjistruara për këtë periudhë është **667, një pjesë e të cilave ishin njoftime të fund vitit 2012**, duke e çuar numrin e përgjithshëm të subjekteve të regjistruara në **4043**.

■ Evidentimi dhe informimi mbi rastet që përbëjnë cënim të privatësisë dhe të të dhënave personale.


Në zbatim të dispozitave të përgjithshme, bazuar në njoftimet e ardhura, është informuar Drejtoria përkatëse e Hetim-Inspektimit mbi përpunime të cilat mund të paraqesin risk për cënimin e parimeve të përgjithshme të privatësisë.

Gjithashtu, nëpërmjet shqyrtimit të formularëve të njoftimit janë iniciuar disa praktika për të cilat janë kryer inspektime me qëllim verifikimin e gjendjes reale pranë kontrolluesve. Këto raste të evidentuara si të paqarta, te paplota ose me qëllim verifikimin e ligshmërisë të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave kanë çuar në plotësimin e informacionit nga ana e kontrolluesve si dhe iniciimin nga ana e tyre e procedurave për kërkesën për marrjen e Autorizimit të Komisionerit për transferim ndërkombëtar të të dhënave në vende pa nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave. Saktësimet, plotësimet apo dhënia e autorizimeve është pasqyruar në Regjistrin Elektronik të Subjekteve Kontrollues.

Gjithashtu është përgatitur informacion në lidhje me Njoftimin për të gjitha subjektet që kanë qenë në proces inspektimi si dhe është plotësuar gjithë informacioni i ardhur nga subjektet kontrolluese për të cilat Drejtoria e Hetim Inspektimit kishte lënë detyra konkrete dhe afate në lidhje me plotësimin apo saktësimin e Formularit të Njoftimit.

KMDP ka shqyrtuar njoftimet, kërkesat për informacion plotësues, informacione shtesë të ardhur nga subjektet kontrolluese, deklarata ndryshimi apo kthim përgjigje të shkresave sensibilizuese dhe informacione të ndryshme rast pas rasti, të cilat kemi mundur ti menaxhojmë me efektivitet.

Pajisu me Autorizim  
të Komisionerit përpara  
instalimit të sistemit biometrik !



### III. PREZANTIMI I KUADRIT LIGJOR

#### III.I Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore

##### ■ Vendime.

Është miratuar **Vendimi nr. 6**, datë 05.08.2013 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale” dhe është botuar në fletore zyrtare. Në mbështetje të ndryshimeve të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të miratuara me ligjin nr. 48/2012, të miratimit të dy udhëzimeve të veçanta të cilat përcaktojnë të mënyrë të detajuar masat e sigurisë që duhet të ndërmerren kontrolluesit e mëdhenj dhe të vegjël, është parë e arsyeshme shfuqizimi i vendimit nr. 1, datë 04.03.2010 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale” dhe miratimi i Vendimit nr. 6.

##### ■ Udhëzime.

Është miratuar **Udhëzimi Nr. 33**, datë 21.01.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 21, datë 24.09.2012 për “Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e mëdhenj””.

Udhëzimi nr. 21, datë 24.09.2012 ka si qëllim përcaktimin e masave *teknike, organizative lidhur me personelin* për mbrojtjen e të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e mëdhenj, ose përpunuesit, si dhe rregullat e bashkëpunimit të tyre me Komisionerin. Vlen të theksohet se ky udhëzim bën të detyrueshëm krijimin dhe mirëmbajtjen e SMSI-së për mbrojtjen e të dhënave personale për të gjithë subjektet përpunuese. Subjektet përpunuese të mëdha sipas këtij akti duhet të caktojnë edhe Personin e Ngarkuar i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e brendshme, të përmbushjes së detyrimeve për mbrojtjen e të dhënave personale. Sa i përket ndryshimeve, ato kanë konsistuar në saktësimin e termave të përdorura në Udhëzimin nr.21, datë 24.09.2012.

Është miratuar **Udhëzimi nr.34**, datë 21.01.2013 për “Disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 22, datë 24.09.2012 për “Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e vegjël””.

Udhëzimi nr.22, datë 24.09.2012 (ashtu sikurse udhëzimi nr.21)parashikon marrjen e masave themelore *teknike, organizative lidhur me personelin*, për mbrojtjen e të dhënave personale të përpunuara nga Kontrolluesit(subjekte përpunuese) e vegjël të të dhënave, ose Përpunuesit, dhe rregullat e bashkëpunimit të tyre me Komisionerin.

Udhëzimi parashikon përgjegjësitë e kontrolluesit në arritjen e sigurisë së të dhënave personale duke i mbrojtur ato nga dëmtimet aksidentale apo të paligjshme ose nga shkatërrimi, humbja aksidentale, ndryshimi, aksesit i paautorizuar dhe vënia në dispozicion personave të paautorizuar, si dhe kundër çdo forme tjetër të paautorizuar të përpunimit. Udhëzimi parashikon mbajtjen në

konsideratë të standarteve minimale duke përfshirë: Analizën e riskut; Sigurinë fizike dhe të ambientit; Sigurinë logjike të pajisjeve TIK të përpunimit të të dhënave personale si dhe Sigurinë e personelit.

Ndryshimet nuk kanë sjellë ndryshime thelbësore të tij, përveç disa saktësimeve dhe shtesave të terminologjisë së huaj të përdorur në udhëzim me qëllim bërjen e tij më të qartë për zbatuesit.

**Është miratuar Udhëzimi nr.35, datë 07.05.2013 për “Përpunimin e të dhënave personale për qëllime të fushatës zgjedhore”.**

Gjatë zhvillimit të fushatës zgjedhore, kandidatët mbledhin dhe përdorin të dhëna personale të individëve(zgjedhësve). Shumë shpesh, kandidatët dhe / apo palë të treta të autorizuar, bëjnë fushatë zgjedhore duke lobuar nëpërmjet mënyrave të ndryshme si mesazhe faksi, SMS ose E-mail. Lidhur me dërgimin nga kandidatët të mesazheve telefonike apo email zgjedhësve, Autoriteti i Komisionerit ka marrë disa ankesa nga këto të fundit. Ky fenomen nxorri në pah domosdoshmërinë e hartimit të këtij udhëzimi me qëllim disiplinimin ligjor të tij.

Kështu, udhëzimi i miratuar nga Autoriteti i Komisionerit, ka për qëllim përcaktimin e rregullave për përpunimin e të dhënave personale nga kandidatët gjatë zhvillimit të fushatës zgjedhore.

Udhëzimi nuk e shtrin fushën e veprimit për fletëpalosjet, posterat apo ndonjë material tjetër që shpërndahet për qëllime të fushatës zgjedhore dhe që nuk përmban të dhëna personale të zgjedhësve. Si një detyrim primar në këtë udhëzim parashikohet detyrimi i kandidatit për të njoftuar Komisionerin për mbrojtjen e të dhënave personale nëse ai vetë apo ndonjë palë e tretë përpunon në emër të tij të dhëna personale për qëllime të fushatës zgjedhore duke përdorur pajisje elektronike të tilla si, kompjuter, e-mail, telefon, faks, sms si dhe kur mbledhja e të dhënave realizohet në mënyrë manuale. Kandidati fitues sipas udhëzimit do të vazhdojë të jetë i regjistruar në Regjistrin Elektronik të subjekteve kontrollues për aq kohë sa ai gëzon mandatin. Kandidatët të cilët humbasin zgjedhjet sipas udhëzimit ç’regjistrohen.

Ndër të tjera, me rëndësi për t’u përmendur është edhe rasti kur kandidati përdor të dhëna personale të përpunuara, për qëllime të tregtimit të drejtpërdrejtë për të cilën duhet të marrë paraprakisht pëlqimin e dhënë me shkrim nga zgjedhësi. Për ta konkretizuar, mund të përmendim rastin kur kandidati kontakton me zgjedhësit nëpërmjet mesazheve telefonike, e-mail, me postë, për të cilën duhet që më parë të ketë marrë pëlqimin e zgjedhësit.

Gjithashtu, zgjedhësve i jepet e drejta për të tërhequr pëlqimin e dhënë për tregtim të drejtpërdrejtë, në çdo kohë.

Është miratuar **Udhëzimi nr.36** datë 05.07.2013 për “Disa rregulla për përpunimin e të dhënave personale në Statistika Zyrtare”. Udhëzimi rregullon disa të drejta dhe detyrime të kontrolluesve që ushtrojnë veprimtari statistikore në kuadrin e ligjit Nr .9180, date 5.2.2004 “Për statistikat Zyrtare”. Nevoja për miratimin e këtij udhëzimi ka lindur si rezultat i zhvillimeve dhe ndikimit të

shpesh të përpunimit të të dhënave personale në sferat e aktivitetit të statistikave në Republikën e Shqipërisë.

Është miratuar **Udhëzimi nr. 37**, datë 10.07.2013 “Për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë përpunimit të shenjave të gishtave nga institucionet publike”. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave të detyrueshme nga institucionet publike për mbledhjen dhe përpunimin e shenjave të gishtave të punonjësve për vërtetimin e prezencës në punë (hyrjen apo daljen nga institucioni). Në udhëzim parashikohet që titullari i institucionit i cili ka vendosur për të përdorur këtë sistem, pra të përpunojë shenjat e gishtave të të punësuarve, duhet të arsyetojë këtë vendim duke përcaktuar qëllimin e mbledhjes dhe duke hartuar dhe miratuar rregulla në të cilën të përcaktohen masat e sigurisë që do të ndërmerren për përpunimin e tyre, kohën që i nevojitet për ruajtjen e të dhënave, mënyrën e shkatërrimit, etj. Gjithashtu në të parashikohet detyrimi për të kryer Njoftimin përkatës pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe për të marrë autorizimin nga Autoriteti.

Është miratuar **Udhëzimi nr. 38**, datë 05.08.2013 “Për veprime të Komitetit Shqiptar të Birësimit, përpara fillimit të përpunimit të të dhënave personale”. Në kuadër të ndryshimeve që ka pësuar ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” është vlerësuar shfuqizimi i Udhëzimit nr. 8, datë 31/08/2010 “Për veprime të kontrolluesit, Komiteti Shqiptar i Birësimit, përpara fillimit të përpunimit të të dhënave personale” dhe miratimi i një akti të ri.

Është miratuar **Udhëzimi Nr. 39**, datë 05.08.2013 “Për përpunimin e të dhënave personale në regjistrat publikë”. Qëllimi i këtij Udhëzimi është përcaktimi i rregullave të detyrueshme për zbatim nga institucionet publike në lidhje me mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale që përmbajnë regjistrat publikë.

Informacioni që përmbajnë regjistrat publikë shpesh mblidhet në mënyrë të detyrueshme dhe bëhet publik në bazë të ligjeve specifike dhe për një qëllim specifik.

Por, informacioni i mbledhur në këto regjistra mund të ketë përdorime të tjera të mundshme për qëllime të tjera që nuk lidhen dhe nuk justifikohen me mbledhjen e detyrueshme të tij dhe bërjen publike në bazë të ligjit. Kjo solli domosdoshmërinë e parashikimit të rregullave në lidhje me mbrojtjen e privatësisë në këtë drejtim.

Hartimi i një Udhëzimi të tillë ishte gjithashtu, domosdoshmëri e lindur edhe si nevojë e praktikës së punës të Komisionerit dhe problemeve të hasura në këtë drejtim. Një sërë inspektimesh të realizuara nga Komisioneri në kontrollues të ndryshëm kanë nxjerrë në pah domosdoshmërinë e trajtimit të mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë të informacionit, sidomos në drejtim të mjaftueshmërisë dhe kohës së mbajtjes së të dhënave personale të cilat janë të hapura ndaj publikut nëpërmjet një regjistri publik.

Është punuar dhe është në proces përfundimi i amendimit të **Udhëzimit Nr. 1**, datë 19.02.2010 “Për lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”.

Monitorimi i kontrolluesve mbi transferimin e të dhënave personale që ata realizojnë dhe e drejta e dhënies së Autorizimeve për transferim është një nga detyrat kryesore të Komisionerit. Në këto kushte rregulla të hollësishme duhen parashikuar në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale për shkak edhe të rrezikut të ekspozimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave në rastin e realizimit të transferimeve sidomos në vende me nivel jo të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave. Për këtë shkak dhe në kuadër të përafrimit të legjislacionit vendas me atë ndërkombëtar do të realizohet edhe parashikimi i rregullave më të detajuara me qëllim zbatimin e drejtë të ligjit nga subjektet e të dhënave personale dhe kontrolluesit në rastet e transferimeve ndërkombëtare të të dhënave.

#### ■ Raste praktike për Udhëzimet e miratuara

Në kuadër të ilustrimit me shembuj konkretë të Udhëzimeve të miratuara nga Komisioneri, me qëllim zbatimin lehtësisht të tyre nga kontrolluesit, janë përgatitur disa shembuj marrë nga praktikat ndërkombëtare apo edhe nga inspektimet e kryera në kontrollues të ndryshëm, për Udhëzime të miratuara dhe njëkohësisht janë publikuar në faqen zyrtare të autoritetit bri udhëzimit konkret, e më konkretisht:

- 2 (dy) shembuj për Udhëzimin nr. 3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “*Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme*” i ndryshuar.
- 1 (një) shembull për Udhëzimin Nr. 5, datë 26.10.2010 “*Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në sistemin e kujdesit shëndetësor*”.
- 1 (një) shembull për Udhëzimin nr. 9, datë 15.09.2010 “*Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive*”, i ndryshuar;
- 1 (një) shembull për Udhëzimin nr. 10, datë 06.09.2011 Për “*Përpunimin e të dhënave personale në kuadër të shërbimeve hoteliere*”, i ndryshuar.
- 1 (një) shembull për Udhëzimin nr. 16, datë 26.12.2011 për “*Mbrojtjen e të dhënave personale në tregtimin e drejtpërdrejtë dhe masat e sigurisë*”;
- 1 (një) shembull për Udhëzimin Nr. 20, datë 03.08.2012 “*Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin bankar*”.

- 1 (një) shembull për Udhëzimin nr. 22, datë 24.09.2012 për "*Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë të të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të vogla*", ndryshuar me udhëzimin nr. 34, datë 21.01.2013.
- 1 (një) shembull për Udhëzimin nr. 24 datë 27.12.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "*Për detyrimet e kontrolluesve dhe përpunuesve përpara se të përpunojnë të dhënat personale*".
- 1 (një) shembull për Udhëzimin nr.35, datë 07.05.2013 për "*Përpunimin e të dhënave personale për qëllime të fushatës zgjedhore*".
- 1(një) shembull për Udhëzimin nr. 36, datë 05.07.2013 "*Disa rregulla mbi përpunimin e të dhënave personale në statistika zyrtare*".
- 1 (një) shembull për Udhëzimin nr. 37, datë 10.07.2013 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë përpunimit të shenjave të gishtave nga institucionet publike*".
- 1(një) shembull për Udhëzimin Nr. 39, datë 05.08.2013 "*Për përpunimin e të dhënave personale në regjistrat publikë*".

### **III.II Strategji, Udhëzues, Kod dhe dokumente të rëndësishëm.**

#### **▪ Strategjia 2014-2017.**

Është përgatitur në grup pune dhe është miratuar Strategjia institucionale e KMDP-së së bashku me plan veprimin përkatës për periudhën 2014-2017 mbi veprimtarinë e Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale. Ajo synon të kristalizojë vizionin e Autoritetit të Komisionerit për 4 vitet në vijim në bazë të një progresi të evidentuar në mënyrë transparente me anë të prioritetëve të përkthyer në objektiva konkrete. Gjithashtu Plani i veprimit bashkëlidhur kësaj Strategjie nënvizon angazhimet kyçe të parashikuara sipas afateve të përcaktuara. Kështu, synohet zhvillimi i kuadrit ligjor nëpërmjet amendimeve që do të vijnë si rrjedhojë e miratimit të p/Rregullores së BE-së mbi përpunimin e të dhënave personale, e modernizimit që do të pësojë konventa nr.108 "*Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale*", e praktikave më të mira ndërkombëtare në zhvillim si dhe ato të rezultuara gjatë monitorimeve e kontrolleve nga vetë autoriteti apo edhe e zhvillimeve të vullshme të teknologjisë së informacionit. Strategjia synon bashkëpunim të ngushtë me kontrolluesit në vend me qëllim vazhdimësinë e kërkesave për të përmbushur detyrimet ligjore, synon intensitet më të lartë në ndërgjegjësimin e publikimit me metodologji të reja si dhe bashkëpunimin e ngushtë me ndërkombëtarët për të finalizuar madje edhe dy organizime të rëndësishme në vend e më konkretisht një konferencë të përvjetshme të frankonisë në të cilën jemi edhe anëtarë të kësaj shoqate e po ashtu edhe atë që organizohet përvjet, konferencën e Evropës Qëndrore e Lindore me pjesëmarrje të gjerë. Këto objektiva të rëndësishëm do të identifikojnë në arenën kombëtare e ndërkombëtare autoritetin dhe rolin e tij të rëndësishëm pa anashkaluar treguesit e konsolidimit të

tij në pak vite. Strategjia synon rol të ngushtë bashkëpunues kryesisht me aktorët që ndikojnë në sigurinë e informacionit në rrjetet kompjuterike si një ndër zhvillimet më të vrullshme në kohët e sotme.



- **Udhëzues për përdorimin e CCTV.**

Është përgatitur Udhëzuesi mbi Përdorimin e Sistemeve të Video-survejitimit (CCTV), bazuar në praktikat e Autoriteteve të Mbrojtjes së të dhënave Personale në Francë dhe Angli. Qëllimi i këtij Udhëzuesi është për ti ofruar kontrolluesve publik dhe privat këshilla se si të përdorin sistemet e video-survejitimit, në kuadër të garantimit të sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

▪ **Udhëzues për përpunimin e të dhënave personale në administratën publike.**

Është miratuar “Udhëzuesi për përpunimin e të dhënave personale në administratën publike”. Udhëzuesi i drejtohet të gjithë kontrolluesve të administratës publike. Në të prezantohen parimet e mbrojtjes së të dhënave të cilat duhen respektuar nga ana e administratës publike, ashtu si edhe çështjet të cilat ata duhet të mbajnë në vëmendje përpara se të nisë mbledhja, përpunimi apo transmetimi i të dhënave.

▪ **Udhëzues mbi njohjen me të dhënat biometrike (shtojcë: të dhënat biometrike në vendin e punës).**

Është miratuar Udhëzuesi mbi njohjen me të dhënat biometrike (shtojcë: të dhënat biometrike në vendin e punës). Ky Udhëzues shpjegon rregullat përkatëse se në çfarë kushtesh kontrolluesit mund të përpunojnë të dhëna personale biometrike, si dhe çfarë janë të detyruar të mbajnë në vëmendje gjatë përpunimit të tyre. Dokumenti është standard ndërkombëtar i marrë pikërisht nga praktika të tilla.

▪ **Udhëzues praktik për personat e kontaktit/personat e ngarkuar.**

Është punuar në bashkëpunim me projektin IPA 2009 “Udhëzuesi praktik për personat e kontaktit”. Dokumenti është miratuar nga komisioneri, përkthyer nga projekti dhe gjithashtu, botuar nga ky i fundit. Ai ka si qëllim të qartësojë punën e personave të ngarkuar në institucionet publike dhe organizmat privatë.

▪ **Ndryshime në manualin “Për vlerësimin e kërkesave për miratimin e transferimit të të dhënave në shtete të huaja”.**

Me Urdhërin nr.101, datë 14.06.2013 Komisioneri ka miratuar disa ndryshime në manualin “Për vlerësimin e kërkesave për miratimin e transferimit të të dhënave në shtete të huaja”. Këto ndryshime janë bërë në kuadër të ndryshimeve ligjore që ka pësuar ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

▪ **Kodi i Shkëmbimit të të dhënave.**

Është përgatitur dhe miratuar kodi i praktikës së shkëmbimit të të dhënave. Ky kod shpjegon se si Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar, aplikohet për shkëmbimin e të dhënave personale. Ai gjithashtu parashikon këshilla të mira që do të jenë të rëndësishme për të gjithë kontrolluesit që shkëmbejnë të dhëna personale. Dokumenti është ndikuar në hartimin e tij nga standarde të ICO (autoriteti homolog në Britaninë e Madhe) dhe pas miratimit është standardizuar në një lidhje për të qenë lehtësisht i përdorur.

▪ **Kanali i komunikimit ndërmjet Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Personave të Kontaktit.**

Me Urdhërin nr. 144, datë 15.07.2013 Komisioneri ka miratuar “Kanalin e Komunikimit ndërmjet Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Personave të Kontaktit” me shtojcat përkatëse Nr. 1 “Formular Kërkese, shembull me anë të të cilit Personat e Kontaktit mund t’i drejtohen KMDP-së” dhe Nr.2 “Formular për Dhënien e Përgjigjes”(dokument i përgatitur nga

projekti në bashkëpunim me DR dhe DÇPLMJashtë). Qëllimi kryesor i kanalit është të sigurojë një kontakt të veçantë dhe të qëndrueshëm brenda KMDP-së për tu konsultuar me Personat e Kontaktit/të ngarkuar në lidhje me probleme që kërkojnë interpretimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave, me të cilat ata përballen gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

▪ **Pyetësor.**

Është hartuar **Pyetësori** për subjektet përpunuese të mëdha dhe të vogla, në kuadër të zbatimit të udhëzimeve nr. 21 dhe nr. 22 të miratuara nga Komisioneri (bazuar në materialin e përgatitur nga ekspertët të projektit, i publikuar për plotësim të ndryshuar). Pyetësori është publikuar në faqe për plotësim dhe është dërguar edhe elektronikisht. Qëllimi i tij ka qenë jo vetëm të njiheshin me detyrimet që ofrojnë udhëzimet përkatëse (pasi aktet janë të botuara në fletore zyrtare) por edhe për të mbajtur gjithnjë kontrolluesit nën efektin e vëmendjes që duhet treguar në këtë fushë apo edhe për ti ndërgjegjësuar në vazhdimësi.

▪ **Pyetësor.**

Është hartuar **Pyetësori** për subjektet përpunuese, në kuadër të transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale. Edhe ky pyetësor është publikuar për tu plotësuar. Nndërkohë dokumentet e vlerësuar apo pyetësorët komunikohet edhe përmes kanalit të komunikimit, nëpërmjet personit tonë të ngarkuar.

▪ **Dokumenti “Njoftim mbi ruajtjen e privatësisë”.**

Me Urdhërin Nr. 282 Prot. datë 23.12.2013, është miratuar dokumenti “Njoftim mbi ruajtjen e privatësisë” si aneks i Rregullores së autoritetit tonë “Për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurinë e tyre”. Ky dokument jep informacion për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale nga Autoriteti i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për informacionin e mbledhur nga ankuesit, individët e tjerë të cilët paraqesin kërkesa të ndryshme për marrje informacioni, vizitorët e faqes së KMDP-së, etj (aktualisht është publikuar edhe në faqen zyrtare).

▪ **Manual për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në fushën e Medias.**

Është miratuar “Manuali mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale në fushën e Medias”. Manuali synon të nxisë trajtimin e drejtë të jetës private të figurave publike, si dhe të personave të zakonshëm nga ana e medias, shtypit, medias elektronike dhe mediat e reja (sidomos blogjet). Është një standart i marrë nga praktika ndërkombëtare dhe i shtohet numrit të udhëzimeve të miratuara nga komisioneri në këtë fushë, trajnimeve të bëra nga projekti që asistoi KMDP, etj.

▪ **Përmbledhësja ligjore e Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale.**

Është përditësuar “Përmbledhësja ligjore e Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” me ndryshimet e fundit të miratuara në Kodin Penal, ligjet “Për Nëpunësit civil”, “Për gjendjen civile”, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, “Për të huajt”, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve

publike”, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” si dhe me aktet nënligjore të reja të miratuara nga komisionari, etj. Përmbledhësja mban numrin II dhe është botuar në disa kopje të cilat janë shpërndarë në shumë sektorë të rëndësishëm.

▪ **Deklarata tip e Konfidencialitetit.**

Janë bërë disa shtesa dhe ndryshime në “Deklaratën tip të Konfidencialitetit” e cila është publikuar edhe në faqen zyrtare të KMDP-së. Kjo deklaratë nënshkruhet ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit. Ajo përcakton kërkesat dhe përgjegjësitë e atyre që kanë akses në informacione personale dhe siguron që të gjitha palët e interesuara të kuptojnë detyrimet e tyre të konfidencialitetit.

- ✚ Është e rëndësishme të theksohet se të gjithë dokumentet janë lehtësisht të lexueshëm në faqen zyrtare të autoritetit e në të njëjtën kohë një pjesë e mirë e tyre edhe janë botuar për shpërndarje. Gjithashtu ka funksionuar marrëdhënia me personat e ngarkuar në institucionet publike nëpërmjet të cilëve autoriteti transmeton informacione, publikime, opinione, etj, të cilat i shërbejnë ecurisë me efektivitet të punës së kontrolluesit në këtë fushë. Një set i vlerësuar gjithashtu për të identifikuar punën e autoritetit i është dërguar edhe Kuvendit të Shqipërisë, kryesisht edhe për faktin e raportimit të përmuajshëm (mbi detyrat e realizuara) në këtë organ e më konkretisht pranë Shërbimit të Monitorimit por edhe si pjesë e pasurimit të bibliotekës.

▪ **Mbi aktet komunitare.**

Mbi kërkesën e MIE, është përgatitur dhe dërguar shkresë me evidentimin e **akteve komunitare** që Komisioneri i konsideron si prioritare për tu përkthyer në gjuhën shqipe gjatë vitit 2013, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 07.03.2007 “Për procedurat e përkthimit të legjislacionit të Bashkimit Europian në gjuhën shqipe dhe të përkthimit të legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e Bashkimit Europian”. Në fakt derimë tani kjo kërkesë nuk është realizuar.

### **III.III Përfshirja në dhënien e mendimeve për projekt/aktet ligjore, nënligjore dhe projekte të tjera.**

Në zbatim të përgjegjësive që ligji për mbrojtjen e të dhënave personale parashikon për dhënien e mendimeve për p/akte ligjore e nënligjore si dhe projekte të tjera;

- Është dhënë mendim mbi projektligjin “**Për njoftimin dhe konsultimin publik**” dhe më konkretisht nuk jemi shprehur dakort mbi propozimin e parashikuar në një nen në të cilin shprehimisht thuhej:

*“Ministri përgjegjës për shoqërinë e informacionit dhe Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale përcaktojnë me udhëzim të përbashkët kushtet e veçanta dhe mënyrën e mbrojtjes së privatësisë dhe të dhënave personale”.*

- Është dhënë mendim për 2 projektligje të ardhura nga Ministria e Drejtësisë. Më konkretisht për:
  1. Projektligjin **“Për të drejtën e Informimit”**; dhe
  2. Projektligjin **“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”i ndryshuar.**

Në projektligjin “Për të drejtën e Informimit”, komentet kanë konsistuar vetëm në korigjimin e disa referencave të përdorura gabim, ndërsa në projekt/ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, ndryshimet janë sugjeruar si rrjedhojë e parashikimeve të propozuara që zbatimi i të dy ligjeve do të mbikqyret e monitorohet nga Komisioneri për Mbrojtjen e të dhënave Personale dhe për të Drejtën e Informimit.
- Është dhënë mendim për Projektligjin **“Për mbikëqyrjen Parlamentare të Shërbimeve Informative dhe të Sigurisë”**, dërguar nga Parlamenti; Në mendimin e Komisionerit synohej parashikimi i rregullave lidhur me ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale dhe konfidencialitetit.
- Është dhënë mendim mbi Projektligjin **“Për Azilin”**, dërguar nga Ministria e Brendshme
- Është dhënë mendim për projektligjin **“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”**, dërguar nga Ministria e Drejtësisë. Mendimi i dhënë nga Autoriteti i Komisionerit konsistoi në unifikimin e terminologjisë, përfshirjen e dispozitave lidhur me konfidencialitetin, të drejtën për njohjen me dosjen e procedimit administrativ si dhe marrjen e pëlqimit të individit në rastet kur të dhënat personale përdoren nga të tretët gjatë një procedimi administrativ.
- Është dhënë mendim për **Projektvendimin** “Për kriteret dhe dokumentacionin për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë” të dërguar nga Ministria e Brendshme. Në përgjithësi projektvendimi ka rezultuar në përputhje me ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale por është propozuar vetëm riformulimi i deklaratës së pëlqimit në aneksin bashkëlidhur këtij projektvendimi, konkretisht në “Formularin e aplikimit për vizë Shqiptare”, në pikën 44 të saj, me qëllim që të përcaktohet qartë:
  - afati kohor maksimal për ruajtjen e këtyre të dhënave në sistem,
  - lloji i sistemit që përpunon të dhënat,
  - cilat janë organet përkatëse shqiptare që do të përdorin këto të dhëna;
  - qëllimin e përdorimit të të dhënave në sistem nga organet përkatëse shqiptare.

- **Është dhënë mendim mbi projektvendimin** e dërguar nga MITIK “Për krijimin e Sistemit Unik të regjistrimit, autentifikimit dhe identifikimit të përdoruesve në marrjen e shërbimeve publike nga sistemet elektronike” në të cilin jemi shprehur dakort, pasi ky projektvendim nuk bie në kundërshtim më Ligjin Nr. 9887, date 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar në asnjë prej pikave të tij.
- **Është dhënë mendim mbi projektvendimin** për “Marrëveshjen e bashkëpunimit për agjencitë e zbatimit të ligjit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë”. Në përgjithësi marrëveshja ka rezultuar në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Autoriteti i Komisionerit ka sugjeruar vetëm shtimin e një paragrafi lidhur me ruajtjen e konfidencialitetit.
- **Është dhënë mendim për “Projekt marrëveshjen** e Bashkëpunimit Operacional dhe Strategjik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/ Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Shërbimit Policor European, EUROPOL”.
- **Është dhënë mendim për projektvendimin** për “Procedurat e ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe rregullat për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”. Projektvendimi ka qenë në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale por në kuadër të përafrimit me aktet nënligjore për mbrojtjen e të dhënave personale janë dhënë edhe disa sugjerime në lidhje me masat e sigurisë që duhet të marrë ky institucion për të gjitha të dhënat që do të përpunohen.
- **Është dhënë mendim për projektvendimin** “Për një shtesë në vendimin nr. 842, datë 06.12.2006 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e institucioneve të autorizuara për verifikimin në mënyrë elektronike të gjendjes gjyqësore si dhe të formularit të vetëdeklarimit”, të ndryshuar”, të dërguar nga Ministria e Drejtësisë.
- **Është dhënë mendim për projektvendimin** “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit dhe regjistrin qendror të personelit në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore”, të dërguar nga Departamenti i Administratës Publike. Dhënia e mendimit konsistoi në përfshirjen e dispozitave lidhur me respektimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, të drejtën për akses në dosjet e personelit dhe të institucioneve të parashikuara me ligj, si dhe në dokumentacionin që përmban të dhëna personale i cili duhet të mbahet për aq kohë sa është i nevojshëm për përmbushjen e qëllimit.
- Jemi dakortësuar me p/udhëzimin që do të miratojë përmbledhësen e cila **evidenton institucionet që mund të aksesojnë të dhënat e regjistrin të gjendjes civile** si dhe të dhënat që lejohen për tu mbledhur në përputhje me qëllimin ligjor të veprimtarisë së punës së këtyre institucioneve. Dokumenti është rrjedhojë e përmbushjes së detyrimit të parashikuar në pikën 3

të nenit 3 të ligjit “Për gjendjen civile” dhe pas nënshkrimit nga Ministri i Brendshëm e Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale do të botohet në fletore zyrtare. Përmbledhësja është punuar prej kohësh në bashkëpunim me KMDP.

- **Është dhënë mendim për “Manualin për të Drejtat e Njeriut të Përdoruesve të Internetit”** të ardhur për mendim nga Ministria e Jashtme dhe në përgjithësi ka rezultuar në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.
- **Është dhënë mendim për “Draft-Marrëveshjen e shkëmbimit/transferimit ndërkombëtar”** të dërguar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Ky transferim do të bëhet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Autoriteti i Tregut Financiar Austriak. Komisioneri me anë të mendimit të tij ka sugjeruar përcaktimin e qartë të qëllimit të transferimit, kategorinë e të dhënave që do të transferohen si dhe ka sugjeruar përcaktimin e mënyrës se si do të bëhet transferimi.
- **Është dhënë mendim Ministrisë së Financave, në lidhje me kërkesën e tyre për interpretim ligjor dhe përshtatje me Ligjin Amerikan FATCA**(Foreign Account Tax Compliance Act). Nga Autoriteti i Komisionerit përveç të tjerash, subjektit kontrollues i është evidentuar se në zbatim të nenit 31, pika 1, shkronja ”a” të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, në rast se vlerësohet nënshkrimi i një marrëveshjeje ndërqeveritare apo çdo mënyrë tjetër e mundshme për implementimin e FATCA, që mund të prodhojë një akt ligjor/nënligjor etj, ky material duhet të dërgohet pranë Komisionerit përpara miratimit, në mënyrë që të vlerësohet përputhshmëria e këtyre akteve me dispozitat e ligjit të sipërcituar.
- ✚ Siç nisëm në krye të prezantimit të pjesës të kuadrit ligjor, në zbatim të shkronjës “a”, të pikës 1 të nenit 31 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, ndër përgjegjësitë e Komisionerit është dhënia e mendimeve për p/akte ligjore dhe nënligjore si dhe për projekte të tjera(për të cilët detajua më sipër) të cilat kanë lidhje me fushën e mbrojtjes së të dhënave. Për tu realizuar kjo, **që prej ngritjes së autoritetit është kërkuar me mjete e mënyra ligjore ndërgjegjësimi i institucioneve që kryesisht kanë nismën ligjore të dërgojnë për mendim këto akte me qëllimin e vetëm përputhshmërinë e legjislacionit kombëtar.** Mbi këtë domosdoshmëri projekti që asistoi KMDP ka mundësuar edhe seminarë vetëm me drejtoritë juridike të kontrolluesve apo edhe është shpërndarë qarkore në të gjithë kontrolluesit për të kaluar çdo projekt akt pranë KMDP kur përmbajtja e tij ka lidhje me fushën e të dhënave. Megjithë gjykimin tonë që nga raporti i kaluar se do të kishim më shumë p/akte për mendim thuajse edhe në këtë vit kemi të njëjtën shifër. Rezulton që përgjegjësia jonë është ushtruar në kohë e ndërsa prurjet mbeten ende në diskutim dhe në reagim të kontrolluesve.

Në vazhdim evidentohet korrespondenca e KMDP-së me KM në lidhje me kërkesën për dërgimin e projektakteve për mendim:

RAPORTI VJETOR 2013  
KMDP



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Drejtoria e Çështjeve Procedurale Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jasthtë

Nr. 56 Prot Tiranë, më 09/03/2011

Lënda: Dërgohet propozim për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.584, datë 28.08.2003 "Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave".

Drejtuar: **Z.Gjergj LEZHJA**  
Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave

Për dijen: Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Enerjetikës

**TIRANË**

I nderuar Z.Lezhja,

Në zbatim të ushtrimit të kompetencave ligjore që KMDP ka lidhur me dhënie e mendimeve për akte ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me të dhënat personale si dhe me qëllim harmonizimin dhe përputhshmërinë e legjislacionit të vendas me Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", bashkëlidhur dërgojmë propozimin për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.584, datë 28.08.2003 "Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave", miratimi i të cilit do të përmbushte realizimin e plotë të njëres prej veprimtarive të rëndësishme të punës sonë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI  
  
FLORA ÇABEJ(POGAÇE)

PROPOZIM

PËR NË SHITESË

NË VENDIMIN NR.584, DATË 28.08.2003 "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË

KËSHILLIT TË MINISTRAVE"

Në Vendimin Nr.584, datë 28.08.2003 "Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave" sugjerojmë që:

**Pas pikës 27** (kreu IV "Dhënia e mendimeve për projektaktin") të shtohet një pikë me këtë përmbajtje:

"Nëse projektakti parashikon dispozita që kanë të bëjnë me të dhënat personale, në të cilat përfshihet përpunimi i tyre, mbrojtja, transferimi, përhapja, etj. i dërgohet për mendim Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale."



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Drejtoria e Çështjeve Procedurale Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jasthtë

Nr. 165 Prot Tiranë, më 09/03/2012

Lënda: Mbi zbatimin e nenit 31/1/a të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale

Drejtuar: **KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Z. Gjergj LEZHJA**  
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

**TIRANË**

I nderuar Z. Lezhja

Në vijim të bashkëpunimit tonë të vazhdueshëm, takimit të zhvilluar midis përfaqësuesve të autoritetit tonë, Projektit IPA - 2009 (i cili që prej një viti asiston KMDP) dhe përfaqësuesve të Drejtorisë Juridike në Këshillin e Ministrave, që prej vitit 2011 kemi dërguar propozime konkrete me qëllim përfshirjen e tyre në Rregulloren e Këshillit të Ministrave, miratuar me Vendimin Nr.584, datë 28.08.2003 në të cilin kemi parashikuar që edhe autoriteti ynë të listohet në institucionet tek të cilin projektligjet apo aktet nënligjore duhen dërguar për mendim përpara miratimit të tyre.

Këtë ndërmarrje e morëm edhe si rezultat i moszbatimit të plotë të dispozitës përkatëse e konkretisht nenit 31/1/a të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, në të cilin është parashikuar si përgjegjësi e autoritetit tonë, dhënia e mendimeve për akte ligjore e nënligjore që prekin fuqinë e mbrojtjes së të dhënave personale. Mox zbatimi ka ardhur si rezultat i mos dërgimit të aktave nga institucionet që i kushtojnë ato, megjithë bëjën me dije në qdo takim, organizim workshopesh, etj. mbi detyrimet që kanë e që duhet të përmbushin.

Deris në tani kemi qenë të detyruar të gjejmë e ndjekim çdo lloj mënyre për të arritur objektivin tonë ligjor duke shërbyer veçmendjen më përparë të dërguara pikërisht Shërbimit të Monitorimit pranë Kuvendit të Shqipërisë si organ nga i cili monitorohemi për ecimin e punës sonë, që ky i fundit të dërgojë për mendim ato projekt akte të cilat janë bërë publike nëpërmjet medias së shkruar apo viaive se po shqyrtohen në komisionet përkatëse apo kanë mbështetur për shqyrtim pranë tyre.

Po ashtu nisur nga kuptja që i bëjmë regullisht fletoreve zyrtare, kemi adresuar mendime ligjore në ato akte që kanë rezultuar të miratuara e botuara por që dukshëm janë parë që prekin fuqinë e mbrojtjes së të dhënave personale dhe që për to është nevojitur dhënia e opinionit ligjor.

Zbatimi i kësaj përgjegjësie siç shihet bëhet i pamundur nëpërmjet kësaj mënyre dhe sigurisht kërkohet zgjidhje sa më të shpejtë të mundur. Po ashtu, ne nuk e shohim të udhës që në çdo prezantim të raportit në Komitetin Drejtues(me përfaqësues të MD, MIE, MITIK dhe MB) të projektit që na asiston evidentohet kjo mangësi e theksuar dhe shprehet interes lidhur me miratimin e rregullores e cila do të ndihmonte punën tonë në këtë drejtim.

Duke marrë shkas nga sa sipër, por edhe nga rasti më i fundit i prezantuar në median e shkruar e viaive për diskutimet që po zhvillohen vullshëm mbi pëligjin "Për shëndetin mendor" në prani edhe të grupeve të interesit, apo edhe ato që do të diskutohen mbi Kodin Penal e atë Civil, për të cilët nuk na është kërkuar mendim, do të kërkonim marrjen në konsideratë të propozimit tonë ligjor në miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave.

Për një zgjidhje adekuate, Lutemi deri në miratimin e rregullores, mundësi të dërgimin e projektakteve për mendim pranë autoritetit tonë përpara kalimit të tyre për miratim e për këtë ne sigurojmë dhënie e mendimeve në kohë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI  
  
FLORA ÇABEJ(POGAÇE)

Nr 165/1 prot  
Dt 17/10/12



100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Këshilli i Ministrave

Nr. 3268 prot.

Tiranë, më 16.10 2012

L E N D A : Për bashkërendimin e projektakteve

MINISTRAVE

Për dijeni:

**KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

**TIRANË**

Të nderuar zotërinj,

Përmes kësaj shkrese dëshiroj të theksoj se, në përmbushje të detyrimit të parashikuar në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 31, të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar dhe me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të praktikës së përgatitjes së projektakteve, të gjitha projektaktet ligjore dhe nënligjore, të propozuara apo miratuara nga Ju, që kanë të bëjnë me të dhënat personale, duhet ti dërgohen për mendim Komisionerit për Mbrojtjen e të dhënave Personale.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin!

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Gjergj LEZHJA

### III.IV Praktika e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale.

- Banka Credit Agricole Shqipëri Sh.a, në datë 26.12.2012, ka njoftuar nëpërmjet një shkrese, për përpunim dhe transferim ndërkombëtar të të dhënave personale të klientëve të saj në kuadër të shërbimit E-banking. Pas shqyrtimit të kërkesës, rezultoi se transferimi kryhej në një nga shtetet anëtare të BE-së, e konkretisht në Slloveni. Në kushte të tilla kontrolluesi u informua mbi mos pasjen nevojë të pajisjes me autorizim në përputhje/bazuar me Vendimin nr. 3, datë 20.11.2012 “Për përcaktimin e shteteve, me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale” dhe Aneksit Nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, të miratuar nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe të publikuar në faqen tonë zyrtare.

Gjithashtu, kontrolluesit iu bë me dije se një nga detyrimet që duhet të mbajë në vëmendje ishte vënia në dijeni e klientëve mbi transferimin e të dhënave të tyre në shtetin përkatës.

Po ashtu, bazuar në këtë njoftim kontrolluesi u informua se nga ana e drejtorisë përkatëse (drejtorisë së Regjistrimit) do të bëhej azhurnimi i të dhënave të deklaruara prej tij, në Regjistrin e Kontrolluesve.

- Është dhënë informacion në lidhje me kuadrin ligjor për subjektin kontrollues Eurofast me seli në Shqipëri, të dërguar nëpërmjet postës elektronike në e-mailin zyrtar të Komisionerit [info@kmdp.al](mailto:info@kmdp.al). Subjekti ka kërkuar informacion mbi kuadrin ligjor specifik që aplikohet në Republikën e Shqipërisë në lidhje me transferimin e të dhënave personale në vende me nivel jo të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave dhe Klauzolat Kontraktuale Standarte për Transferimin e të Dhënave Personale nga Shqipëria drejt vendeve të treta. Subjektit i është dhënë gjithë informacioni i duhur në kuadër të informimit dhe është vënë në dispozicion baza ligjore dhe nënligjore që aplikohen në lidhje me transferimin.
- Është përfunduar trajtimi i dosjes së subjektit kontrollues “**Tema Retail AL**” sh.p.k mbi kërkesën për pajisjen me Autorizim nga Komisioneri për transferimin e të dhënave personale në vende me nivel jo të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, konkretisht në shtetin e Turqisë. Autoriteti i Komisionerit pasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin shkresor të dosjes dhe duke iu referuar edhe korrespondencës së vazhdueshme të mbajtur me kontrolluesin, në përfundim u shpreh me vendimin përkatës “Mbi lejimin e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale” mbi bazën e të cilit subjektit kontrollues iu miratua pjesërisht kërkesa për transferim të dhënash.
- Është në proces trajtimi praktika përkatëse e dosjes të subjektit kontrollues **Gekasmetal sh.p.k**, i cili duhet depozitohet një kërkesë formale pranë Komisionerit dhe të plotësojë Formularin e

Aplikimit për marrjen e Autorizimit nga Komisioneri në lidhje me transferimin e të dhënave personale në vende me nivel jo të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave. Mbi praktikën tanimë është vënë në dijeni edhe Drejtoria e Inspektimit e cila mund të shtrijë rolin e saj në këndvështrimin e një tejkalimi kohor për përmbushjen e detyrimeve të kontrolluesit përsa i është kërkuar.

- Është në proces trajtimi praktika përkatëse e dosjes të subjektit kontrollues Air BP Albania **sh.p.k** i cili është duke plotësuar informacionin e duhur për shqyrtimin e kërkesës për pajisjen me Autorizim nga Komisioneri për transferim të dhënash personale në vende me nivel jo të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave.

### III.V Ndërtimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucione të tjera.

✚ Këtë faktor të rëndësishëm e synojmë përmes nënshkrimit të marrëveshjeve, dhënies së raportimeve në kohë e me cilësi, dhënies së opinioneve, informacioneve, asistencës, etj, për kontrolluesit që të mund të standartizojmë apo edhe disiplinojmë punën e tyre në përpunimin e drejtë e të ligjshëm të të dhënave personale.

#### ■ Marrëveshje bashkëpunimi.

- Është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Universitetit të Tiranës/ Rektoratit. Kjo marrëveshje ka si qëllim bashkëpunimin për zbatimin e legjislacionit respektiv të palëve si dhe në veçanti të sigurohet përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale të studenteve, stafit pedagogjik, dhe punonjësve të Rektoratit, Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës dhe të tjerë fakulteteve. Në këtë event u mundësua edhe shpërndarja e materialeve ndërgjegjësuese. Implementimi i saj gradual është tregues në ndërgjegjësimin e studentëve siç edhe kemi theksuar më sipër në pjesën përkatëse.
- Është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet KMDP dhe DHKPP (Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë). Kjo Marrëveshje ka si qëllim zgjerimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve për të kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në procesin e zbatimit të legjislacionit respektiv të tyre si dhe ekzekutimin nga ana e DHKPP të gjobave të vendosura nga KMDP tek kontrolluesit publik dhe privat. Në këtë këndvështrim kemi zhvilluar seminarë dhe dhënë asistencën tonë mbi kërkesat e tyre për opinione ligjore apo parashikime të ruajtjes së konfidencialitetit në aktet e prodhuara apo të njehsuara. Efektet e këtij nënshkrimi kanë qenë pozitive edhe në ekzekutimin e vendimeve për vjeljen e gjobave të adresuara kontrolluesve, në favor të shtetit, që krahasuar me një vit më parë kurba tregon rritje.

- Është hartuar Projekt-Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet KMDP-së dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Akti i hartuar është dërguar për mendim pranë kontrolluesit dhe pritet mendimi i tij. Zbatimi i saj ndër të tjera është vlerësuar në këndvështrimin e ndërgjegjësimit që mund të bëjë krahas KMDP edhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit pranë kontrolluesve me të cilët ky i fundit ka marrëdhënie pune për të plotësuar ata detyrimin e kryerjes së njoftimit si parashikim ligjor madje dhe i ndëshkueshëm nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Është hartuar Projekt-Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet KMDP-së dhe University of New York Tirana. Tashmë ky projekt/akt është dërguar pranë Universitetit, i cili ka dhënë miratimin për nënshkrimin e tij më 22.01.2014. Kjo, për vetë faktin se për Autoritetin e Komisionerit ndër objektivet kryesorë në fokus ka qenë e do të mbetet ndërgjegjësimi i grup moshës së të rinjve dhe kjo duhet shtrirë edhe në kontrolluesit privatë siç edhe po veprohet në këtë rast.
- Është dhënë mendim për Projekt-Memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet Komisionerit dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive. Ky Projekt-Memorandum ishte përgatitur nga AMA.

#### ■ Raportime

- Është raportuar rregullisht në Ministrinë e Drejtësisë mbi veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, **në kuadër të Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (2012-2015)**, në zbatim të VKM nr 486 datë 25.07.2012 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2012-2015, dhe përcaktimin e përgjegjëseve institucionale për përafrimin në legjislacionin shqiptar të çdo akti të legjislacionit të BE-së”.
- Është raportuar për Ministrinë e Jashtme “**Mbi hartimin e Raportit kombëtar në kuadër të Mekanizmit Universal Periodik (UPR) për të drejtat e njeriut**”.
- Është raportuar në Ministrinë e Jashtme mbi “*Hartimin e Raportit lidhur me Konventën mbi Zhdukjet me Forcë*”, lidhjen e kësaj Konvente me mbrojtjen e të dhënave personale dhe praktikën e Komisionerit në këtë drejtim. Në informacionin e dhënë është bërë një panoramë e përputhshmërisë së Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar i cili është hartuar e miratuar në përputhje të plotë me Konventën Nr. 108 “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”, me protokollin shtesë të saj “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale nga organet mbikëqyrëse dhe fluksi ndërkufitar i të dhënave”, akte këto të ratifikuara nga vendi ynë, me nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilën parashikohet se askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij, si dhe me Direktivën nr. 95/46/EC, datë 24.10.1995 e

Parlamentit Europian dhe e Këshillit si dhe me eksperiencat e shteteve evropiane në këtë fushë dhe janë theksuar dhe relatuar kriteret e përcaktuara qartë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale në përgjithësi dhe të të dhënave shëndetësore në veçanti, në lidhje me “Konventën mbi Zhdukjet me Forcë”.

- Në kuadër të raportimit periodik pranë **Komitetit Konsultativ të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale (T-PD)**, është raportuar mbi hartimin dhe miratimin e akteve ligjore e administrative, dhënien e mendimeve dhe bashkëpunimin institucional të KMDP-së. Është raportuar për periudhën Qershor 2012-Qershor 2013.
- Është raportuar në Ministrinë e Integritimit për Takimin e V të Nënkomitetit të Drejtësisë Lirisë dhe Sigurisë; JFS V, për periudhën Shtator 2012-Mars 2013, lidhur me zhvillimet e veprimtarisë së autoritetit, progresin e bërë në të gjithë sektorët e tij, etj.
- Është raportuar në Ministrinë e Drejtësisë mbi veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në kuadër të hartimit të kontributit të parë të Republikës së Shqipërisë për Raportin e Progresit 2013 të Komisionit Evropian për Shqipërinë.
- Është raportuar periodikisht në Shërbimin e Monitorimit pranë Kuvendit të Shqipërisë, lidhur me detyrat e realizuara nga KMDP.
- Është përgatitur Raporti vjetor, për vitin 2012 dhe është depozituar në Kuvend në afatin e kërkuar me qëllim përmbushjen e pikës 3 të nenit 31 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

#### ■ Opinione ligjore.

- Është dhënë Opinion mbi transparencën e publikimit të të dhënave të subjekteve tregtare abuzuese nga ana e Institucioneve publike. Me anë të këtij opinionit Komisioneri shprehë qëndrimin e tij mbi gjetjen e ekuilibrit të duhur nga institucionet publike ndërmjet të drejtës për informim të publikut dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Ky opinion është reflektuar në edicionet e lajmeve të televizionit Vizion Plus dhe në disa media të shkruara dhe elektronike. Për tu njohur më gjerë nga ana e publikut, opinionin është publikuar edhe në faqen tonë zyrtare [www.kmdp.al](http://www.kmdp.al)
- Është dhënë Opinion ligjor mbi përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet internetit, si për kontrolluesit publik dhe ato privat. Përpunimi i të dhënave personale ka një kuptim shumë të gjerë dhe përfshin çdo gjë që ndodh me të dhënat personale të mbledhura në çdo formë duke përfshirë edhe ato të mbledhura nëpërmjet internetit. Opinioni thekson rëndësinë e marrjes së

pëlqimit të individëve kur i përpunohen të dhënat personale nga interneti si dhe informimin e tyre në përputhje me kërkesat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Së fundi, opinioni tërheq vëmendjen e kontrolluesve publik dhe privat për hartimin dhe publikimin në internet të politikave të privatësisë ku të shpjegohet mënyra e përdorimit të të dhënave të mbledhura nga këto të fundit. (opinionit është publikuar në faqen zyrtare të autoritetit).

- Është dhënë opinion ligjor për Ministrinë e Punëve të Brendshme mbi çështjen e Konfidencialitetit si pjesë e termave të referencës dhe specifikimeve teknike “Mirëmbajtja dhe zhvillimi i mëtejshëm i Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile”. Autoriteti i Komisionerit është shprehur dakort sa i përket çështjes së ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave personale pasi në të ishin përfshirë të gjitha sugjerimet e propozuara më herët nga Autoriteti i Komisionerit sipas korrespondencës së mbajtur në rrugë elektronike. Në këtë korrespondencë Autoriteti i Komisionerit ka riformuluar materialin mbi ruajtjen e konfidencialitetit për të bërë atë sa më të kuptueshëm dhe në përputhje të plotë me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Është dhënë mendim/opinion mbi kërkesën e ISKSH për dhënien e të drejtës së aksesit në të dhënat e “Regjistrat elektronik të Recetave me Rimbursim” për prokurorët e Njësisë të Përbashkëta Hetimore dhe Prokuroria për Krimet e Rënda. Në opinion Autoriteti i Komisionerit është shprehur dakort për dhënien e aksesit por ky akses të jetë i kufizuar vetëm për rastet konkrete për të cilat po kryhen hetimet dhe jo për të dhënë akses të personalizuar. Të pasurit akses të personalizuar nga prokurorët (të cilën e kuptojmë si akses të plotë dhe të përhershëm) në këtë sistem edhe kur sistemi nuk është i nevojshëm për hetimet që po kryejnë, është në kundërshtim me parimin e mbrojtjes së të dhënave personale e cila lidhet me mjaftueshmërinë e të dhënave.
- Është dhënë mendim/opinion mbi kërkesën e paraqitur nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar. Në kuadër të nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit për shkëmbimin e të dhënave ndërmjet Ministrisë së Brendshme në Shqipëri dhe Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar, Ambasada paraqiti kërkesën e cila konsistonte në marrjen e informacionit nëse ekzistojnë përjashtime në legjislacionin Shqiptar për të drejtën e një subjekti për të mbledhur informacion rreth tij me pëlqimin e tij. Në përgjigje Autoriteti i Komisionerit ka paraqitur rastet kur mund të mos merret pëlqimi i subjektit të të dhënave për përpunimin e të dhënave, në përputhje me shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “dh” të nenit 6, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
- Është dhënë mendim/opinion për “Kartën për Mbrojtjen e Fëmijëve në Media” të dërguar nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit. Në mendimin e dhënë, Komisioneri ka sugjeruar të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

*“E drejta e privatësisë së të miturit, veçanërisht kur kemi të bëjmë me një rast abuzimi është gjithmonë parësore në krahasim me të drejtën e kronikës, dhe kjo vlen edhe në rastin kur identiteti bëhet i ditur nga burime zyrtare apo nga burime pranë familjes.”*

Gjithashtu, Autoriteti i Komisionerit ka sugjeruar që përmbajtja e kartës duhet të jetë në përputhje me detyrimet e përcaktuara në udhëzimin nr. 9, datë 15.09.2010 “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”, i ndryshuar”, i cili në përmbajtjen e të tij ka një kapitull të veçantë në kuadrin e mbrojtjes së fëmijëve.

- Është dhënë opinion ligjor Institucionit të Avokatit të Popullit në lidhje me kërkesën për interpretim ligjor nga Komisioneri, se deri në çfarë detajesh lejon Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, të bëhen publike në kuadër të transparencës, të dhënat e aktiviteteve apo shpenzimet e institucionit. Komisioneri ka dhënë mendimin ligjor në lidhje me rastin, duke i bërë të ditur kontrolluesit, Avokatit të Popullit të gjitha detyrimet që ka ky i fundit në përputhje me mbrojtjen e të dhënave personale të subjekteve të së drejtës, në lidhje me aktivitetet që do të bëhen transparente, kufizimet që parashikon ligji në lidhje me rastin konkret dhe që duhet të respektohen në çdo rast nga subjekti kontrollues.
- Është dhënë mendim/opinion në referim të dispozitave përkatëse të Udhëzimit nr. 11, datë 08/09/2011 mbi “Përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat”, të miratuar nga Komisioneri, mbi kërkesën e AKSHIT në lidhje me përpunimin e shenjave të gishtave, për të kontrolluar hyrje-daljet në një institucion publik apo biznes privat. Në mënyrë të vazhdueshme raste të vlerësuara i janë dërguar për më tej edhe drejtorisë së hetim inspektimit.
- Në vazhden e rekomandimeve të dhëna nga Komisioneri, shpjegueseve, publikimeve, etj, kompetenca këto të parashikuara në ligj për autoritetin tonë, është përgatitur në përshtatje me praktikën më të mira europiane një standart mbi mënyrën e informimit, dhënien e pëlqimit, etj, për/nga pacientët në rastet e marrëdhënieve të tyre me sektorin e shëndetësisë. Ky standart është ofruar për tu konsideruar paraprakisht, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Urdhërit të Mjekut.
- Është dhënë mendim mbi kërkesën e Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit mbi bazën e së cilës kërkohet informacion dhe plotësimi i pyetësorit me qëllim dhënie informacioni për qëllime statistikore. Komisioneri pas analizimit të legjislacionit përkatës mbi çfarë konsiderohet veprimtari në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit dhe mbështetur në një analizë të hollësishme në lidhje me punën e Komisionerit dhe zërat e buxhetit në dispozicion, arriti në përfundimin se Autoriteti i Komisionerit nuk realizon veprimtari që përfshihet në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit dhe si i tillë përjashtohet nga plotësimi i pyetësorit përkatës.

- Është dhënë mendim për “Rregulloren për standartizimin e hartimit të termave të referencës për p/aktet TIK në administratën publike” të dërguar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit. Në përgjithësi p/rregullorja ka rezultuar në përputhje me ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- Është dhënë mendim/opinion ligjor mbi Projekt-Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për afatin e ruajtjes së regjistrimeve në sistemin TIMS”. Konkretisht është synuar saktësimi i afateve të ruajtjes së të dhënave personale të administruara në regjistrimet, shënimet dhe njoftimet kufitare dhe parashikimi i detyrimeve në kuadër të ruajtjes së konfidencialitetit.
- Është dhënë mendim për P/Marrëveshjen e lidhur ndërmjet “Société Générale Albania” me “M – Pay Albania” në lidhje me përputhshmërinë e aktit me Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Është dhënë mendim/opinion ligjor për Projekt-Rregulloren e Brendshme për “Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Bashkinë Lushnje”. Konkretisht është synuar përcaktimi i rregullave mbi transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit.
- Është dhënë mendim/opinion ligjor për Projekt-Rregulloren e Brendshme për “Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Prokurorinë e Përgjithshme”. Dhënia e mendimit përbën dhe përmbushjen e detyrimit ligjor të parashikuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit të nënshkruar në datën 18.05.2012, ndërmjet Autoritetit të Komisionerit dhe Prokurorisë së Përgjithshme.
- Pas një takimi të realizuar me përfaqësues të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve në të cilën kërkohej asistencë në hartimin e projekt-rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, kontrolluesi është orientuar mbi hartimin e projekt aktit dhe i është vënë në dispozicion rregullorja tip “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, e cila gjendet e publikuar në faqen zyrtare të KMDP-së. Pas përgatitjes së projekt-rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” nga ana e AIDA-s dhe dërgimit për mendim pranë KMDP-së, u konstatua se akti në fjalë ishte në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

## ■ Kthim Përgjigje.

Janë trajtuar disa kërkesa me këtë lëndë.

- Është kthyer përgjigje Dhomës Kombëtare të Noterisë lidhur me shqetësimin ndaj kërkesës së Zyrave Tatimore për të marrë të dhëna për personat që lidhin kontrata qiraje si dhe kontrata të tjera lidhur me pasurinë e paluajtshme.  
Në përgjigje, Komisioneri ka sqaruar se në çdo rast kur kërkohen të dhëna personale, për të qenë në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, kërkuesi( në këtë rast “Zyra e tatimeve”) duhet të përcaktojë qartë qëllimin dhe bazën ligjore konkrete në të cilën mbështetet kërkesa.  
Si përfundim Komisioneri është shprehur se në rastin konkret, kontrolluesi duke mos pasur një bazë ligjore konkrete për marrjen e të dhënave për palët në aktet noteriale, e ka të detyrueshme marrjen paraprakisht të pëlqimit me shkrim të subjekteve palë në akte.
- Është kthyer përgjigje shkresës së ardhur nga Ministria e Brendshme në të cilën kërkohet përfundimi i procesit të ndarjes së acquis dhe përcaktimin e përgjegjësisë institucionale për përafrimin në legjislacionin shqiptar të çdo akti të legjislacionit të Bashkimit Evropian, për kapitullin 24 “Drejtesia, Liria dhe Siguria”. Në përgjigje KMDP ka sqaruar se masat ligjore për të cilat rezultojnë përgjegjëse KMDP janë plotësuar por nuk janë hedhur në Sistemin Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit pasi KMDP nuk ka akses në këtë sistem. Në këtë kontekst, e njëjta përgjigje i është kthyer edhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
- Është kthyer përgjigje kompanisë AMC lidhur me kërkesën e saj për t’u informuar mbi procedurat që duhet të ndiqen me qëllim përmbushjen e kuadrit ligjor duke qenë se po konsideron mundësinë e shitjes së detyrimeve të papaguara nga abonentët dhe mbledhjen e borxheve të këqija. Në përgjigje, Autoriteti i Komisionerit e ka informuar se në këtë rast po kryhet një përpunim i ri i të dhënave dhe në përputhje me Ligjin për “Mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar nuk duhet të fillohet ky përpunim pa kryer njoftimin përkatës pranë Drejtorisë së Regjistrimit të Autoritetit të Komisionerit. Pasi të plotësojnë ndryshimet e formularit të njoftimit, rasti në fjalë plotëson një nga kriteret e nenit 6 të Ligjit për përpunimin e të dhënave si dhe nëse është rasti, kompania AMC duhet të lidhë një kontratë për përpunimin e të dhënave në përputhje me Udhëzim nr. 19, datë 03.08.2012 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”, i ndryshuar.
- Është dhënë përgjigje në kuadër të informacionit plotësues lidhur me projektin “Loyalty program” të Shoqërisë CCBS. Autoriteti i Komisionerit ka analizuar kontratën nëpërmjet të cilës Shoqëria Coca Cola Bottling Shqipëria sh.p.k ka deleguar përpunimin e të dhënave

personale të klientëve, në dy kompani të tjera (Përpunues). Si përfundim është kërkuar që në kontratë të përfshihen elementë të rëndësishëm për një përpunim të sigurt dhe të ligjshëm.

- Është dhënë përgjigje kërkesës për prononcim, të paraqitur nga Shoqata Shqiptare e Bankave lidhur me Projektin FATCA “Foreign Account Tax Compliance Act. Në numrin 7 të revistës Bankieri (Prill 2013), e cila botohet periodikisht nga Shoqata Shqiptare e Bankave, është publikuar edhe qëndrimi i Komisionerit lidhur me FATCA-n “Ligjin për përputhshmërinë e pagimit të taksave për llogaritë e çelura në vendet e huaja”. Në këtë kuadër janë trajtuar argumentat ligjorë të cilët e bëjnë ose jo të realizueshëm transferimin e të dhënave personale të klientëve të bankave në zbatim të FATCA.
- Është dhënë përgjigje mbi kërkesën e tij kontrolluesit Societe Generale Albania Sha, nëpërmjet të cilës informon mbi shërbimin e ri që do të ofrojë të quajtur M-RAY, duke bashkëlidhur edhe dokumente të tillë si Marrëveshjen e bashkëpunimit, kopje të kontratës etj. Autoriteti i Komisionerit pasi u njoh me të gjithë dokumentacionin bashkëlidhur informoi kontrolluesin Societe Generale Albania Sha. se nuk duhet të nisë përpunimin e ri të të dhënave përpara kryerjes së Njoftimit pranë KMDP-së. Gjithashtu është sugjeruar të evidentohen saktë të dhënat që do të përpunohen me qëllim që të jenë uniformë me aktet e tjera të saj. Po ashtu është sugjeruar heqja e termit “kombësi” pasi është shfuqizuar si i papajftueshëm me Kushtetutën me vendimin nr.52, datë 01.12.2011.
- Është trajtuar kërkesa e paraqitur nga Qendra Kombëtare e Liçencimit. Nga kontrolluesi QKL, kërkohej të merrej informacion nëse të dhënat e publikuara në Regjistrin e QKL përbënin të dhëna personale dhe nëse në regjistër mund të aksesonin lirisht institucionet publike dhe subjektet private. Në përgjigje, Komisioneri ka konstatuar se të dhënat që publikohen në regjistrin elektronik të kontrolluesit përbëjnë të dhëna personale, por gjithashtu ka sugjeruar që nga ana e QKL të përdoret formulari “Kërkesë për marrjen e dokumentave që përmbajnë të dhëna personale nga Regjistri Kombëtar i Liçencave”. Plotësimi i këtij formulari do të bëhet në çdo rast nga ana e subjekteve ose e institucioneve që shfaqin interes për përvetësimin e dokumentacionit dhe vlerësimi i formularit të plotësuar do të bëhet nga QKL në kuadër të kërkesës dhe pretendimeve të kërkuarit
- Ofrimi i asistencës ligjore.
  - Është dhënë asistencë ligjore për një subjekt me anë të postës elektronike lidhur me pyetjen nëse e lejon ligji për mbrojtjen e të dhënave personale hedhjen e të dhënave të pacientit online në të cilin do të kenë akses vetëm mjekët. Në përgjigje subjekti është sqaruar mbi detyrimet dhe rregullat që parashikon ligji lidhur me këtë çështje.

- Është zhvilluar takim në ambientet e KMDP-së me përfaqësuesin ligjor të projektit të Telemjekësisë dhe Shëndetit Elektronik në Shqipëri dhe specialistin e tyre të IT-së në kuadër të dhënies së asistencës ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky program përfshinte menaxhimin e të dhënave të pacientëve dhe në takim u dhëna informacionet e duhura lidhur me procedurën që duhet të ndiqte ky Projekt për të qenë në përputhje me LMDHP.
  - Është dhënë asistencë ligjore për Vodafone.al Sh.a, sa i përket kërkesës së tyre për afatin e ruajtjes së të dhënave personale që mbarten në skedarët (tabulatet e komunikimeve telefonike) e pajtimtarëve (klientëve).
  - Në kuadër të bashkëpunimit me Universitetin e Tiranës, janë asistuar praktikantët e ardhur nga Fakulteti i Drejtësisë me qëllim kryerjen e stazhit. Në kohën e qëndrimit në mënyrë të vazhdueshme janë njohur me përgjegjësitë e autoritetit, janë njohur me praktikat e shqyrtuara e të përfunduara, i është shpjeguar gjithçka lidhur me veprimtarinë e autoritetit si dhe vazhdimisht janë referuar për ta tema të ndryshme. Është ofruar për ta literatura e bibliotekës dhe gjithshka e kërkuar dhe e vlerësuar se i shërben në të ardhmen.
- Bashkëpunimi me institucione të tjera publike e private.
- Pas konstatimit se disa kontrollues publik ende në portalet e tyre elektronike pasqyrojnë si bazë ligjore ligjin nr. 8517, datë 22.07.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i është dërguar shkresë sensibilizuese me anë të së cilës është kërkuar përditësimi i referencës ligjore. Pas dërgimit të shkresës sensibilizuese kontrolluesit publik kanë reaguar duke përditësuar bazën e ligjore.
  - Është vlerësuar standardi i kartelës shëndetësore i përgatitur e dërguar në adresë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Qendrës Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit (QK-CSA). Kjo e fundit ka vlerësuar të marrë në konsideratë pikërisht formulimin e bërë lidhur me të drejtën e informimit për pacientin si dhe dhënien e pëlqimit të tij për të përpunuar të dhëna personale të nevojshme në kryerjen dhe dhënien e shërbimeve.
  - Në kuadër të pajisjes me çertifikatat që nevojiten për kryerjen e shërbimeve nëpërmjet nënshkrimit elektronik, është dërguar pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit lista e personave dhe pozicionet që ata mbulojnë në autoritet, të cilët duhet të pajisen me këto çertifikata.

## ■ Bashkëpunimi me ASPA

Autoriteti i Komisionerit, nëpërmjet punonjësve të tij të kualifikuar si trajnerë, ka ofruar trajnimet e organizuara (trajnim i thelluar) nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), për trajnimin e Personave të Kontaktit/të Ngarkuar të përcaktuar nga institucionet publike, me temë: “Hyrje dhe baza ligjore për përpunimin e të dhënave personale”. Trajnimet në fjalë janë vazhdim i kurrikulave të zhvilluara më parë nga Projekti EU- IPA/2009 “Mbështetje ndaj Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave në Sektorin Publik Shqiptar”, që asistoi institucionin tonë. Këto trajnime synojnë sigurimin e mbikëqyrjes së brendshme të mbrojtjes së të dhënave personale në institucionet publike. Përveç trajnimeve të thelluara jemi angazhuar tërësisht edhe në trajnimet bazë të nëpunësve të administratës.

## ■ Pjesëmarrje

- Është marrë pjesë në Konferencën Kombëtare me temë “Trajtimi njerëzor i grupeve të margjinalizuara brenda vendeve të privimit të Lirisë-Sfidat për parandalimin e torturës në Shqipëri”. Konferenca u organizua nga Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe në fokus të saj kishte zhvillimet dhe vështirësitë me të cilat përballen aktorët e interesit për zbatueshmërinë e standardeve në parandalimin e torturës dhe keqtrajtimeve të tjera.
- Është marrë pjesë në takimin e organizuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Ky takim kishte si qëllim lançimin e Programit të Përfshirjes Sociale; Iniciativë e përbashkët e Qeverisë Shqiptare dhe Kombeve të Bashkuara. Programi synon përmirësimin e qeverisjes dhe politikave të përfshirjes sociale në të gjitha nivelet, duke plotësuar më tej reformën e shërbimeve sociale.
- Është marrë pjesë në takimin konsultativ mbi draft-aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin Civil” realizuar në datën 17 Dhjetor 2013, në ambientet e Hotel “Tirana International”. Në këtë takim janë shprehur mendimet e Komisionerit në lidhje me këto projekt akte.
- Është marrë pjesë në takimin e realizuar me Zëvendës/Presidentin e Dhomës Kombëtare të Noterisë Z. F.L, i cili përcolli shqetësim për dy çështje që kishin të bënin me veprimtarinë e punës së noterëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale. Gjithashtu për Dhomën Kombëtare të Noterisë është përgatitur në bashkëpunim një paragraf ligjor në lidhje me zbatimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale i cili u vlerësua i nevojshëm për tu përfshirë në aktet e hartuara nga noterët.

- Është zhvilluar një takim më përfaqësues ligjorë të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, lidhur më përgatitjen e rregullores së brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale për DSIK, përcaktimin e personit të kontaktit bazuar në udhëzimin 21, datë 24.09.2012 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha” si dhe është diskutuar mbi detyrimet në kuadër të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Është marrë pjesë në takimet e zhvilluara në Ministrinë e Drejtësisë në kuadër të përgatitjeve për mundësinë e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Eurojustin.
- Është marrë pjesë në Tryezën e rumbullakët të organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, me temë: "Perceptimet e opinionit publik në Shqipëri: “Siguria Njerëzore, Kombëtare dhe Rajonale” dhe në të tjerë organizime të këtij instituti. Në këtë takim u prezantuan rezultatet e sondazhit të kryer nga IDM-ja, në muajin tetor 2013, si pjesë e iniciativës "Forumi Rajonal për Sigurinë".
- Është marrë pjesë në Konferencën e organizuar nga Meridia Consorzio Coop. Sociale, Zyra për Shqipërinë, në bashkëpunim me Save the Children, me titull "Ri-integrimi i Fëmijëve në Konflikt me Ligjin dhe Përgjegjësia Sociale e Komunitetit të Biznesit në Shqipëri". Gjatë kësaj Konference u trajtuan çështje që kanë të bëjnë me punësimin e fëmijëve në konflikt me ligjin, propozimet e komunitetit të biznesit për lehtësime juridike në lidhje me këtë proces, si dhe u prezantua puna gjatë implementimit të projekteve të Meridia-s në Shqipëri.

### III.VI Marrëdhëniet ndërkombëtare.

- ✚ Kjo marrëdhënie është tepër e rëndësishme. Arritja e saj mundësohet nga përkushtimi, vëmendja apo edhe bashkëpunimi reciprok. Në këtë drejtim evidentojmë rolin tonë në disa pjesëmarrje e bashkëpunime.

#### ■ European Projects Awards IPA 2013.

Më 7 Tetor 2013, në kuadër të të Konferencës "Perspektivat e bashkëpunimit territorial 2014-2020 - Pritshmërisë pas anëtarësimit të Kroacisë", në Parlamentin Evropian, u organizua ndarja e çmimeve European Projects Awards IPA 2013 ku ***Komisioneri Shqiptar për Mbrojtjen e të Dhënave Personale u nderua me çmimin e dytë për projektet e përfunduara.***

Pas një konkursi përzgjedhës, ndërmjet 350 projekteve të ekspozuara nga gjithë Evropa në konkursin e organizuar nga Shoqata e Projekteve Evropiane, projekti IPA-2009 “Për Konsolidimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri në Përputhje me Standardet e Bashkimit Evropian” u përzgjedh Fitues i Çmimit të Dytë, për kategorinë: Projektet më të Mira të Përfunduara.

Një nga qëllimet e konkursit ishte që të shpërblejë projektet e financuara nga Bashkimi Evropian të cilët kanë një ndikim të madh pozitiv, për ndryshimet dhe përmirësimet sociale që ato kanë sjellë. Në këtë ceremoni ishte pjesëmarrëse Znj. Flora Çabej (Pogaçe) Komisioner për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Gjatë marrjes së çmimit, Znj. Çabej bëri dhe një prezantim të shkurtër të projektit fitues. Gjithashtu në fjalën e saj, ajo falënderoi Shoqatën Evropiane për Projektet për çmimin e akorduar, Bashkimin Evropian për financimin e projektit dhe në veçanti Delegacionin e BE-së në Shqipëri për asistencën e pakursyer si dhe drejtuesit e projektit dhe gjithë ekspertët evropianë të cilët ndanë me Autoritetin eksperiencën e tyre të vyer duke e vënë në funksion të të drejtës së mbrojtjes së të dhënave personale në Shqipëri.

Në lidhje me këtë event KMDP publikoi një njoftim për shtyp të cilën ia dërgoi medias së shkruar dhe asaj audiovizive. Këtë shënjim e lançoi edhe autoriteti homolog Çek në faqen e tij zyrtare.




**WINNERS in the category CONCLUDED PROJECTS**

		 <p>Western Balkans Regional Competitiveness Initiative - OECD FRANCE</p> 	 <p>"Strengthening of the Data Protection Commissioner Office in Albania for Alignment with European Standards" The Commissioner for Personal Data Protection ALBANIA</p> 	 <p>Vojvodina Metal Cluster - VMC Vojvodina Metal Cluster SERBIA</p> 
---	---	--	--	---

## ■ Bashkëpunimi me Frankofoninë.

**Autoriteti i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale mori pjesë në punimet e Konferencës së 7-të dhe Asamblesë së 7-të të Përgjithshme të Shoqatës Frankofone të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (AFAPDP) në datat 21-22 Nëntor 2013 në Marakesh të Mbretërisë së Marokut, anëtar me të drejtë vote i së cilës është që prej vitit 2009.**

Përfaqësuesi i Autoritetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Shqipërisë, mori pjesë në atelienë prej 60 minutash, me temë “Menaxhimi i Komunikimit të Autoriteteve”, ku bëri një prezantim të mënyrave të komunikimit të Autoritetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, marrëdhënies me mediat, mjeteve të promovimit dhe ndërgjegjësimin si dhe kuadrit ligjor rregullator të komunikimit të jashtëm në tërësi. Në këtë atelie, iu përgjigj pyetjeve të shumta të përfaqësuesve nga 25 shtete të botës frankofone dhe më gjerë, duke përcjellë eksperiencën e konsiderueshme të Autoritetit të KMDP-së në këtë fushë dhe gjithashtu një ekspozitë të praktikave të mira e risive që ka adoptuar gjatë punës së tij. Gjithashtu, informacioni në lidhje me pjesëmarrjen në këtë Konferencë, u publikua në faqen zyrtare të Autoritetit të Komisionerit.

Në kuadër të vendosjes së bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit të Komisionerit dhe **Ambasadës së Francës**, është dërguar letër informuese, lidhur me marrëdhëniet e Autoritetit tonë me hapësirën frankofone dhe zhvillimet e fundit që kanë të bëjnë me Konferencën e AFAPDP-së në Marakesh.

Është mbajtur kontakt i vazhdueshëm me Shoqatën e Autoriteteve Frankofone të Mbrojtjes së të Dhënave Personale në lidhje me praktikat më të mira në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Janë dhënë komente për “Vendimin në lidhje me procedurën e inkuadrimit të transferimit të të dhënave personale në hapësirën frankofone më ndihmën e rregullave të detyrueshme të Korporatës” të ardhura nga Shoqata Frankofone.

**Është raportuar** në lidhje me aktivitetet kryesore të Autoritetit të Komisionerit gjatë vitit 2013, drejtuar Shoqatës së Autoriteteve Frankofone për Mbrojtjen e të Dhënave, në kuadër të Konferencës dhe Asamblesë së Përgjithshme të radhës, gjatë së cilave bëhet paraqitja e ndryshimeve legislative, përmirësimeve të rregulloreve, publikimit të udhëzimeve dhe evenimenteve të tjera të rëndësishme të Autoriteteve anëtare të Shoqatës Frankofone AFAPDP gjatë vitit. Në këtë raport janë renditur tre nga pikat kryesore të punës së Autoritetit të KMDP-së për vitin 2013 dhe më konkretisht:

- Çmimi i dytë që mori Autoriteti i KMDP-së nga Shoqata e Projekteve Evropiane (EPA) në shtator 2013, në konkursin Çmimet e Projekteve Evropiane 2013, në kategorinë “Projektet më të Mira të Përfunduara”.
- Publikimi për herë të parë i revistës së Autoritetit të Komisionerit Shqiptar të Mbrojtjes së të Dhënave Personale ashtu si edhe publikimi i Përmbledhëses Juridike të KMDP-së.
- Trajnimi dhe çertifikimi i Oficerëve të parë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të Administratës Publike shqiptare, në kuadër të Projektit të financuar nga Bashkimi

Evropian: “Mbështetje Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Shqipërisë, në lidhje me trajnimin e Oficerëve të Mbrojtjes së të Dhënave në Sektorin Publik”.

#### ■ Bashkëpunimi me T-PD.

Në kuadër të rishikimit të draft/rekomandimin mbi mbrojtjen e të dhënave personale të përdorura për qëllime punësimi, T-PD ka kërkuar mendimin e anëtarëve të saj mbi këtë akt. Në këtë kontekst Komisioneri ka përgatitur në gjuhën angleze propozimet konkrete bazuar dhe në aktet e miratuara më parë nga Autoriteti ynë, të cilat prekin fushën e punësimit.

Më konkretisht, nga ana e Komisionerit është parashikuar të bëhet pozicionimi i qartë që duhet të këtë punëdhënësi kundrejt të dhënave sensitive, kur i kërkohej raportim pranë autoriteteve kompetente shëndetësore në rastet e diagnostikimit të sëmundjeve profesionale. Gjithashtu Komisioneri, ka parashikuar dispozita lidhur me vendosjen e kamerave të vëzhgimit në ambientet e punës si dhe dispozita mbi mbledhjen e të dhënave biometrike.

**Është raportuar** me anë të postës elektronike Sekretariati i T-PD lidhur me pranimin nga ana e KMDP-së për çështjet si më poshtë:

- a) Propozimin për nenin 22 të “modernizimit” të Konventës.
- b) Dhënien e statusit të vëzhguesit para T-PD për Fondacionin Australian për Privatësi.

Është dhënë mendim për pyetësin e përgatitur nga eksperti Joseph Cannataci në lidhje me shqyrtimin e Rekomandimit (97) 5 mbi mbrojtjen e të dhënave mjekësore, pyetësor ky i dërguar nga T-PD mbi konspektin e ekspertit për "Teknologjinë mjekësore dhe çështjet e mbrojtjes së të dhënave".

Është dhënë mendim për projekt-opinionin mbi rishikimin e rekomandimit (2006) 4 të KE-së, “Kërkime mbi materialet Biologjike me prejardhje njerëzore” të dërguar nga T-PD. Komisioneri është shprehur dakort me propozimet e T-PD.

#### ■ Bashkëpunimi me projektin PHAEDRA

Me anë të ftesës për bashkëpunim nga projekti PHAEDRA (projekt 2 vjeçar i financuar nga Bashkimi Evropian në bazë të programit të saj për të Drejtat Themelore dhe të Shtetësisë), autoriteti i Komisionerit **ka raportuar** mbi marrëveshjet e bashkëpunimit të hartuara ndër vite me autoritetet homologe, si dhe ka bërë një panoramë të zbatimit të legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale. Projekti PHAEDRA synon mbështetjen për të përmirësuar

bashkëpunimin dhe bashkërendimin ndërmjet Komisionerëve të Privatësisë dhe të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale kudo në botë.

#### ■ Pjesëmarrja në aktivitetet ndërkombëtare

- Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale mori pjesë në takimin e 15-të të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Evropës Qendrore dhe Lindore i cili u mbajt në Beograd (Serbi), nga data 10 deri në 12 Prill 2013. Takimi adresoi tre grupe çështjesh, për të cilat përfaqësuesit e autoriteteve për mbrojtjen e të dhënave personale prezantuan përvojat e tyre. Këto përfshinë: sigurinë e të dhënave, përpunimin e të dhënave në fushën e punësimit dhe pavarësisë së autoriteteve për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sfidat me të cilat ata ballafaqohen.
- TAIEX në bashkëpunim me Autoritetin Kroat të mbrojtjes së të dhënave personale, organizoi takimin e radhës i cili u mbajt në Zagreb (Kroaci) më 20-21 Qershor 2013. Në këtë takim morën pjesë përfaqësuesit e Autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave personale duke përfshirë: Serbinë, Bosnje-Hercegovinën, Malin e Zi, Ukrainën, Kroacinë, Shqipërinë dhe Maqedoninë. Qëllimi i këtij takimi ishte shkëmbimi, njohja dhe prezantimi i përvojave të përfaqësuesve të Autoriteteve pjesëmarrëse, lidhur me zhvillimin e teknologjisë dhe rolin e saj në praktikën e këtyre të fundit, duke i kushtuar një vëmendje të lartë zhvillimit të internetit dhe sfidave të reja lidhur me të. Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale paraqiti eksperiencën e tij lidhur me depërtimin e internetit dhe pasojat që vijnë nga një keqpërdorim i tij, duke përmendur gjithashtu masat që ndërmerren në rast shkeljesh të të dhënave personale.
- Komisionerja mori pjesë në Konferencën e 35-të të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe Komisionerëve të Privatësisë e cila u mbajt në Varshavë të Polonisë prej datë 23 deri në 26 shtator 2013. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është anëtarësuar në Konferencë Ndërkombëtare të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale në vitin 2010 gjatë Konferencës së 32-të të organizuar në Izrael. Kjo konferencë ishte një mundësi për Autoritetet e mbrojtjes së të dhënave për të diskutuar çështje të ndryshme, duke përfshirë dhe çështjet lidhur me përdorimin e teknologjisë së re dhe konkretisht mbi aplikacionet e fundit të telefonisë celulare. Pikërisht në Konferencën e 35-të Ndërkombëtare të Komisionerëve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale u miratuan deklarata si dhe **8 rezoluta të cilat i përkëmbin** “Profilizimit”, “Drejtimin Strategjik”, “Dyerve të Hapura”, “Edukimit Digjital” dhe “Gjurmimit në ueb”. Gjithashtu, në këtë konferencë u miratua anëtarësimi i Autoritetit të Kosovës, Mauritius dhe të Buenos Aires si dhe morën statusin e Autoritetit vëzhgues Korea e Jugut, Rusia, Drejtoria e Sigurisë së Industrisë Ndërkombëtare të Kanadasë, Singapori, Bremani (Gjermani), Ekuadori.
- Workshopi i 25-të “Mbi trajtimin e rasteve praktike në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale”, i mbajtur në Sarajevë (Bosnje-Hercegovinë) në datat 2-3 Tetor 2013. Workshopi i 25-të “Mbi trajtimin e rasteve praktike në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale”, i mbajtur në Sarajevë (Bosnje-Hercegovinë) në datat 2-3 Tetor, u zhvillua në kuadër të

shkëmbimit të eksperiencave të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale përsa i përket inspektimeve të kryera në fusha të ndryshme, specifikat, problemet e hasura në praktikë dhe zgjidhjet e ofruara.

Në këtë organizim morën pjesë përfaqësues të 27 shteteve: Shqipëria, Belgjika, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Republika Çeke, Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermania, Gjibraltari, Hungaria, Irlanda, Luksemburgu, Maqedonia, Malta, Monako, Mali i Zi, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, Serbia, Sllovakia, Sllovenia, Suedia dhe Britania e Madhe.

Qëllimi i këtij evenimenti ishte shkëmbimi i eksperiencave në fushën e kontrollit dhe inspektimit të kontrolluesve, njohja e rasteve specifike të trajtuara nga Autoritetet e Mbrojtjes së të Dhënave (risitë) dhe rritja e bashkëpunimit midis tyre në trajtimin e rasteve dhe kontroleve të përbashkëta. Më konkretisht u zhvilluan katër sesione diskutimesh ku u diskutua për “Median, mbrojtja e të dhënave personale në internet- Rrjetet sociale interneti dhe fëmijët”; Sfidat e reja për mbrojtjen e të dhënave në komunikimin telefonik dhe informatik – revolucionin e prezantimit të teknologjive elektronike moderne”; “Video survejimi në sektorin publik dhe privat” si dhe “Konfidencialiteti në përpunimin e të dhënave personale në sektorin e policisë” dhe “Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale”.

**Prezantimi i Autoritetit Shqiptar për Mbrojtjen e të Dhënave Personale u mbajt gjatë sesionit për Vidjosurvejimin** ku u paraqit eksperiencia e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri në këtë fushë, veçantitë e konstatuara gjatë inspektimeve në sektorin publik dhe atë privat, kuadri ligjor, problematikat e hasura gjatë inspektimeve si dhe rekomandimet e dhëna nga Komisioneri.

## ■ Përkthimi i materialeve

Janë përkthyer dokumente të cilat në fokus synojnë mbrojtjen e të dhënave personale. Dokumentet sjellin ndryshime të shumta të kuadrit ligjor në vende të tjera apo vendimmarrje në këtë fushë. Për autoritetin tonë ato kanë një shërbim të veçantë jo vetëm për hartimin e akteve që miratojmë apo janë si udhërrëfyes në inspektimet që kryejmë, apo për mënyrën e ndjekur në arritjen e ndërgjegjësimit, por janë vlerë e shtuar në bibliotekën e autoritetit. Ndërsa ne ndjekim vazhdimësinë e përgatitjes së tyre në përmbledhje lehtësuese. Ndër materialet e përkthyer si më të rëndësishme vlerësojmë të përmendim:

- Tetë rezolutat e miratuara gjatë Konferencës së 35-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë, që u zhvillua në Varshavë, të Polonisë, në datat 23 – 26 shtator 2013, si edhe Deklarata e Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informacion zhvilluar në Berlin, nga data 18 deri 20 shtator 2013, mbi Përforcimin e Transparencës në Nivel Kombëtar dhe Ndërkombëtar (gjenden të publikuar në faqen tonë zyrtare).

- Draft-raporti Shpjegues i modernizimit të Konventës 108 (bazuar në propozimet e miratuara nga mbledhja e 29 Plenare e T-PD-së).
- Gjashtë artikuj të Revistës “Privacy Laws and Business”.
- Rezoluta e Konferencës së Marakeshit të AFAPDP-së, Nëntor 2013, mbi Transparencën e Praktikave të Qeverive.
- Vendimi i Gjykatës britanike të Shkallës së Parë në lidhje me gjobën e vendosur nga autoriteti homolog Britanik ndaj një subjekti.
- “Vendim i Komisionit dt. 5 shkurt 2010 mbi Klauzolat kontraktuale standarde për transferimin e të dhënave personale drejt përpunuesve të vendosur në shtete të treta sipas Direktivës 95/46/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit”.
- Marrëveshje ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara në lidhje me përpunimin dhe transferimin e të dhënave të Regjistrit të Emrave të pasagjerëve (PNR) nga transporti ajror tek Departamenti i Sigurisë Kombëtare të Shteteve të Bashkuara (DHS).
- Vendim i Këshillit të BE-së për nënshkrimin, në emër të BE-së, të Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit evropian dhe Shteteve të Bashkuara në lidhje me përpunimin dhe transferimin e të dhënave të Regjistrit të Emrave të pasagjerëve (PNR) nga transporti ajror tek Departamenti i Sigurisë Kombëtare të Shteteve të Bashkuara (DHS).

Në kuadër të bashkëpunimit **me Shoqatën e Autoriteteve Frankofone të Mbrojtjes së të Dhënave Personale**, janë përkthyer një sërë dokumentesh të rëndësishme, në lidhje me:

- Legjislacionin e të dhënave biometrike (dispozitat në lidhje me mbledhjen të dhënave, përpunimin e tyre, etj);
- Anketimin mbi konsolidimin e dosjeve të gjendjes civile dhe listave zgjedhore.

Të gjithë përkthimet e vlerësuara (deri në momentin e kryerjes së tyre) janë pasqyruar edhe në një lidhje të parë. Përgatitja e këtij dokumenti është vënë në dispozicion të të gjithë drejtorive të Autoritetit të Komisionerit dhe sigurisht siç treguam më sipër, shërben për rritjen e efektivitetit dhe profesionalizmit në kryerjen e detyrave. Nga ana tjetër shpesh publikojmë përkthime të rëndësishme që sensibilizojnë vizitorët në faqe.

Janë përgatitur dhe dërguar pranë Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave të Gjermanisë dhe Republikës Çeke, letrat e interesit, me qëllim organizimin e vizitave studimore, të financuara nëpërmjet projekteve të TAIEX-it me qëllim më pas informimin e Ministrisë së Integritimit.

### **III.VII Projekti EU-IPA/2009.**

**Projekti i financuar nga BE dhe zbatuar nga FIIAPP “Mbështetje ndaj Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale lidhur me trajnimin e personave të kontaktit për mbrojtjen e të dhënave në sektorin publik shqiptar”.**

Projekti i parë EU IPA-2009 “Për Konsolidimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri në Përputhje me Standartet e Bashkimit Evropian”, i cili u zbatua gjatë periudhës 8 nëntor 2010 – 8 dhjetor 2012, në komponentin e Kuadrit Ligjor, i dha mbështetje të specializuar personelit ligjor të autoritetit të KMDP-së në zhvillimin e kuadrit të tij rregullator. Këshillimi dhe mbështetja u dhanë, me qëllim garantimin e zbatueshmërisë me *acquis-në* e BE-së në fushën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Gjithashtu, u hartuan udhëzime formale lidhur me çështje të caktuara sektoriale dhe mbrojtjen e të dhënave.

Pa dyshim që përfundimi me sukses i këtij projekti, i solli një tjetër përfitim Autoritetit të Komisionerit. Me financimin e Komisionit të Bashkimit Evropian **në datë 7 Janar 2013 filloi implementimin Projekti i ri IPA - 2009 “Mbështetje Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KMDP) për trajnimin e Personave të Kontaktit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Sektorin Publik Shqiptar”**. Projekti synoi që, nëpërmjet ofrimit të asistencës teknike ndaj Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KMDP), të trajnojë Personat e Kontaktit për Mbrojtjen e të Dhënave të sektorit publik në përputhje me udhëzimin e KMDP-së Nr. 21, datë 24.09.2012 “Për Përcaktimin e Rregullave për Ruajtjen e Sigurisë së të Dhënave Personale të Përpunuara nga Kontrolluesit e Mëdhenj”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 136 e datës 18 tetor 2012. Kohëzgjatja e projektit ishte 6 muaj dhe KMDP ishte Përfituesi kryesor i projektit.

Gjatë muajit mars 2013, përfundoi procesi i trajnimit të trajnerëve të Autoritetit të Komisionerit për të trajnuar më pas personat e kontaktit/të ngarkuar. Në këtë trajnim i cili zgjati tre ditë dhe u zhvillua nga ekspertë evropian u trajnuan dhe certifikuan si trajnerë disa punonjës të Autoritetit të Komisionerit për të zhvilluar më tej trajnime në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Në këtë kuadër janë kryer trajnimet përkatëse sipas kurrikulave të përcaktuara nga Projekti dhe miratuar nga komisioneri, janë certifikuar **38 Persona të Ngarkuar** në Institucionet publike. Rezultat i projektit ishte hartimi i udhëzuesit për personat e ngarkuar, kanali i komunikimit si edhe disa seminarë ndër të cilët përmendim atë mbi përpunimin e të dhënave biometrike (On-the-job Training on Biometric Data) referuar nga eksperti spanjoll, Z. Jose Lopez Calvo, Zv. Komisioneri Spanjoll për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.



**KUJDES !  
MOS LINI KARTËN LARG SYVE TUAJ !**

## IV. ANKESAT DHE KONTROLLI “EX OFFICIO”.

### IV.I ANKESAT E PARAQITURA PRANË KMDP-SË.

Pranë Autoritetit të Komisionerit përgjatë vitit 2013, janë paraqitur një numër i konsiderueshëm kërkesash për informacion dhe shqetësime për shkelje të mundshme, por vetëm 26 prej tyre kanë qenë ankesa të mirëfillta me shkrim nga subjekte të ndryshëm të të dhënave, për të cilat në të gjitha rastet është ushtruar inspektim administrativ për të verifikuar në terren situatën e parashtruar në ankesë, verifikimin e shkeljes, marrjen e provave dhe shqyrtimin e tyre, si dhe daljen në konkluzion për gjetjet dhe dhënien e përgjigjes për subjektin/tet që janë ankuar.

Përsa i përket ankesave të tjera, ato janë shqyrtuar nga inspektorët dhe subjekteve ju është dhënë orientimi i duhur për të ezauruar të drejtat e tyre, fillimisht pranë kontrolluesit përkatës dhe më pas ti drejtohen Autoritetit të Komisionerit. Në këto raste ju është dhënë asistencë e duhur subjekteve dhe në të gjitha rastet ata nuk i janë drejtuar sërish Komisionerit çka do të thotë se kontrolluesi ka përmbyshur kërkesat e tyre legjitime.

**Në rastet e shqyrtuara dhe hetuara nga ana e Komisionerit në thelb të ankesave ka qenë:**

- Saktësia dhe informimi mbi të dhënat që përpunohen si dhe marrja e pëlqimit për marketingun direkt;
- Lidhur me publikimin dhe përhapjen e të dhënave e të dhënave personale në faqen zyrtare të gjykatave dhe mediave;
- Lidhur me përpunim e të dhënave imazhe nëpërmjet CCTV;
- Lidhur me përhapjen e të dhënave nga disa institucione publike;
- Lidhur me përdorimin e të dhënave biometrike (*gjurmën e gishtit*);
- Lidhur me aksesin në të dhënat personale.

Duke i dhënë prioritet ankesave, është kushtuar rëndësi e veçantë, ankesës së zj.V.H. Ankesa ka të bëjë me përhapjen e të dhënave personale të shtetases tek punëdhënësi i saj, për shkak të mos shlyerjes së kredisë tek Banka Pro-Credit. Këto të dhëna janë përhapur pa marrë pëlqimin e saj dhe pa u parashikuar kjo gjë në kontratën e marrjes së kredisë. Në lidhje me këtë ankesë janë zhvilluar inspektimet pranë Pro-Credit Bank Dega Shkodër dhe Pro-Credit Bank sh.a. Pas inspektimit të zhvilluar në Pro-Credit Bank Shkodër, nga grupi i inspektimit u konstatua që për zgjidhjen e drejtë të çështjes duhej zhvilluar një inspektim administrativ të Pro-Credit Bank Qëndrore, për shkak se u informuam gjatë inspektimit në Shkodër se ka një varësi hierarkike që kushtëzon veprimet e ndërmarra nga Degët.

Në përfundim të hetimeve Autoriteti i Komisionerit i kërkoi me rekomandim kontrolluesit që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij përsa i përket procedurës së vjeljes së kësteve të kredive nga debitorët në vonesë duhet të respektojë dispozitat e Ligjit nr. Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, në mënyrë specifike dispozitat që kanë lidhje me të drejtën e informimit të subjekteve dhe dhënien e pëlqimit nga ana e tyre. Gjithashtu, Kontrolluesi, Pro-Credit Bank sh.a në veprimet e mëtejshme bankare duhet të respektojë në çdo rast dispozitat e Ligjit nr. Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe

Udhëzimit Nr 20, datë 03.08.2012 “Mbi përpunimin e të dhënave personale në sektorin bankar” të Komisionerit.

Procedurat paraprake, për vënien në dijeni të kredimarrësit ose përhapjen e të dhënave të tij apo çdo informacioni në lidhje me kredinë dhe vonesat në shlyerjen e saj, që mendohen të aplikohen përpara kalimit të subjektit në “Regjistrin e Kredive të Këqija”, të parashikohen në mënyrë eksplicite në Rregulloren e Brendshme, si dhe në kontratën e lidhur me kredimarrësin;

**Është trajtuar ankesa e shtetases V.H. Akesa kishte si objekt ndërhyrjen e Komisionerit për heqjen nga website (forume online) të një artikulli që ka të bëjë me “abuzimin e detyrës” të pozicionit e ankueses si pedagoge. Kontrolluesit që kishin publikuar artikuj rreth saj, si <http://api.shqiperia.com/> <http://www.kohajone.com/> <http://www.forumishqiptar.com> <http://www.gazeta-shqip.com/> <http://tiranaweb.activeboard.com/> <http://www.studentet.info/>**

Pasi u studjua e gjithë dosja dhe u morën të gjitha masat nga Komisioneri për rastin në fjalë, u mundësua respektimi nga kontrolluesit e sipërpërmendur i të dhënave personale të shtetases, duke bërë anonimizimin ose fshirjen e artikujve në fjalë.

Si një rast tjetër të veçantë mund të përmendim **Inspektimin administrativ pranë kontrolluesit Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë, bazuar në ankesën e shtetases N.M, lidhur me përdorimin e të dhënave biometrike (gjurmën e gishtit)** për identifikimin e prezencës në punë të punonjësve. Pas përfundimit të hetimeve, Komisioneri ka urdhëruar kontrolluesin që të pezullojë menjëherë përdorimin e sistemit të vendosur për përpunimin e të dhënave biometrike “gjurma e gishtit” për vërtetimin e prezencës në punë të punonjësve; të informojë në mënyrë të qartë punonjësit në lidhje me qëllimin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave biometrike “gjurma e gishtit”, si dhe të kërkojë opinionin dhe mendimin e punonjësve dhe të sindikatës së punonjësve.

Në kuadrin e sigurisë, këtij kontrolluesi iu kërkua të hartohet rregullore lidhur me mbledhjen, përdorimin, procedurat, aksesin, masat për mbrojtjen e sistemit, sigurinë edhe konfidencialitetin për përpunimin e të dhënave biometrike “gjurma e gishtit”, si dhe të lidhet kontratë me subjektin i cili mirëmban nga ana teknike sistemin e përdorimit të të dhënave biometrike “gjurma e gishtit”, ku të jenë përshkruar rregulla lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve dhe të jenë përshkruar detyrime lidhur me konfidencialitetin e të dhënave personale.

U trajtua **ankesa e subjektit të të dhënave D. D. ndaj kontrolluesit “Ministria e Drejtësisë” në lidhje me “publikimin e të dhënave personale të denoncuesve kundër korrupsionit në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë”**. Në rekomandim kontrolluesit i janë lënë disa detyra që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, publikimi në faqen zyrtare në internet i të dhënave personale të subjekteve denoncues/ankues si dhe i palëve të treta të realizohen në mënyrë të tillë që ata të mos jenë të identifikueshëm. Kontrolluesi Ministria e Drejtësisë të hartojë rregulla për mënyrën e mbledhjes, përdorimit, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale të mbledhura nëpërmjet këtij portali. Për hartimin e këtyre rregullave, Autoriteti i Komisionerit ofroi asistencën e tij duke dërguar edhe standardin që mund të publikohet në faqe. Në kuadrin e sigurisë së të dhënave u rekomandua marrja e të gjitha masave të duhura teknike dhe organizative për mënyrën e

përdorimit dhe të menaxhimit të këtij portali si dhe Politikat e Privatësisë të miratuara të publikohen në faqen zyrtare të internetit.

Është realizuar **trajtimi i ankeses së shtetasit A. K duke inspektuar kontrolluesit “Gazeta Koha Jonë”, “Gazeta Shqip”, “Gazeta Telegraf”, “Panorama” dhe disa gazeta dhe forume të tjera online, që kanë lidhje me mos-heqjen nga artikujt e publikuar online të të dhënave ose mos anonimizimin e tyre çka e identifikonte këtë shtetas.** Nga inspektimet e ushtruara pranë kontrolluesve “Gazeta Standard”, “Gazeta Shqip” dhe “Gazeta Panorama”, nga këta të fundit u morën masa të menjëhershme duke i hequr ose anonimizuar artikujt përkatës, sipas Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Komisionerit nr. 9 datë 15/09/2009 “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”.

“Gazeta Shqiptare” dhe “Koha Jonë” nuk reagueshan pas ushtrimit të kontrolleve administrative përkatëse dhe për këtë arsye, Komisioneri ka marrë masa të mëtejshme administrative duke nxjerrë Urdhërat për këta kontrollues duke i kërkuar që brenda një afati kohor prej 5 (pesë) ditësh të realizonin fshirjen dhe anonimizimin e të dhënave identifikuese në artikujt e publikuar online. Pas kalimit të afateve të përcaktuara në këto Urdhëra, Komisioneri verifikoi detyrat e lëna kontrolluesve të mësipërm dhe në përfundim rezultoi se këto kontrollues [www.kohajonë.com](http://www.kohajonë.com) dhe gazeta Shqiptare [www.balkanweb.com](http://www.balkanweb.com) përsëri nuk i morën parasysh zbatimin e akteve administrative. Në këto kushte Komisioneri doli me Vendim duke vendosur masën administrative me gjobë për të dy kontrolluesit.

Është realizuar **trajtimi i ankeses se shtetases polake, D.S, per kompaninë “Velur & Spa”.** Ndaj këtij kontrolluesi Autoriteti i Komisioneri ushtroi inspektimin administrativ dhe në përfundim urdhëroi të mos vijonte më tej me përpunimin e të dhënave të shtetases dhe të klientëve të tjerë pa marrë pëlqimin paraprak të informuar të tyre. Ky pëlqim duhej parashikuar në formularin “skedë klienti”, sipas neneve 6/1/a dhe 18 të ligjit nr.9887, date 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Pas verifikimit të Autoritetit për marrjen e masave të parashtruar në Urdhër, u vërejt se njëra nga pikat e tij nuk ishte zbatuar dhe pikërisht pjesa informuese në këtë formular nuk ishte realizuar. Në këto kushte Komisioneri vendosi masë administrative/ gjobë.

**Trajtimi i ankesës së Znj. A. V, ndaj kontrolluesve Gjykata e Rrethit Tiranë, Gjykata e Apelit Tiranë dhe mediat elektronike si;**

[http://www.ikub.al/LAJME\\_CATEGORY/1009160052/Article-Korrupsioni-termet-tek-Inxhinieria-e-Ndertimit.aspx](http://www.ikub.al/LAJME_CATEGORY/1009160052/Article-Korrupsioni-termet-tek-Inxhinieria-e-Ndertimit.aspx), [www.shqiperia.com](http://www.shqiperia.com), [www.infoarkiv.com](http://www.infoarkiv.com)

Përveç kontakteve në rrugë elektronike me përfaqësuesit e mediave elektronike, u kryen hetimet administrative të plota pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Tiranë. Pas urdhërave respektive për këto gjykata u realizua anonimizimi i të dhënave. Në përfundim të këtij hetimi, ankueses ju anonimizuan ose ju fshinë të dhënat e saj personale, sipas kërkesës së saj të ligjshme, nga portalet e kontrolluesve të lartpërmendur.

Në bashkëpunim edhe me ekspertin e AKEP, u ushtroi inspektim administrativ bazuar në ankesën e shtetasve PN, KI, si dhe televizionit Top Channel, pranë kontrolluesve “Albanian Mobile Communications” sh.a (AMC) dhe “Vodafone Albania” sh.a, lidhur me “përdorimin e SMS-ve pa kërkesë në fushatën elektorale”. Në përfundim të inspektimit Komisioneri ka dalë me një Opinion

ligjor i cili i është dërguar operatoreve Vodafon, AMC, Plus, Albtelecom-Eagle dhe AKEP ku është kërkuar: marrja e masave teknike dhe organizative për të shmangur apo minimizuar dërgimin e mesazheve (sms) të pa kërkuara nëpërmjet telefonave celularë, drejt subjekteve të të dhënave personale për qëllime elektorale. Gjithashtu, lidhur me këtë problem autoritetit të AKEP i është kërkuar vazhdimi i mëtejshëm dhe forcimi i bashkepunimit midis dy institucioneve, me qëllim mbrojtjen e privatësisë të shtetasve shqiptarë gjatë fushatave të ardhshme zgjedhore.

**Inspektim administrativ për ankesën e subjektit A. B në lidhje me publikimin e fotove në media.** Trajtimi i kësaj anese përfundoi me nxjerrjen e Urdhërit nga Komisioneri ndaj kontrolluesit *gazeta online* [www.korcanews.com](http://www.korcanews.com), si dhe përcjelljen e një shkrese Unionit të Gazetarëve Shqiptarë. Në zbatim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 9, datë 15/09/2010 “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në mediane dhe shkruar, vizive dhe audiovizive” dhe Udhëzimin nr.31, datë 27/12/2012 “Për caktimin e kushteve dhe kritereve për përjashtim nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike”, kontrolluesit *gazeta online* [www.korcanews.com](http://www.korcanews.com) ju kërkua të realizojë menjëherë fshirjen e fotografisë së subjektit të të dhënave personale Z. A. B nga artikulli i publikuar.

Kontrolluesit *gazeta online* [www.korcanews.com](http://www.korcanews.com), ju kërkua që në vijim në aktivitetin e tij të respektojë ligjin nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 9 datë 15/09/2010 “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në media dhe shkruar, vizive dhe audiovizive”, si dhe Udhëzimin nr.31 datë 27/12/2012 “Përcaktimi i kushteve dhe kritereve për përjashtim nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike”.

- ✚ Siç vihet re në raport kontrollet kanë prekur ndjeshëm fushën e medias. Mbi to janë dhënë rekomandime e janë vendosur edhe gjopa për mos zbatim të rekomandimeve. Megjithë ushtrimin e përgjegjësive tona, megjithë miratimin e udhëzimeve në këtë fushë *kërkohet domosdoshmërisht rregullimi dhe forcimi i këtij profesioni nëpërmjet hartimit dhe miratimit të urdhërit të gazetarit.*

Ky është një standart që në vendet e zhvilluara i ka paraprirë miratimit dhe krijimit të autoritetit të mbrojtjes së të dhënave personale. Nuk është komisioneri parësor në disiplinimin e këtij kontrolluesi por do të ishte urdhëri i këtij profesioni të cilit do ti dërgoheshin rekomandimet, konstatimet apo dënimet administrative përveç kontrolluesit media që është monitoruar edhe urdhërit i cili ligjërisht gëzon gjithë të drejtat të ushtrisë kompetencën deri në heqjen e të drejtës së ushtrimit të profesionit. Në këtë këndvështrim e shohim me vend që në këtë raport të evidentojmë domosdoshmërinë e plotësimit të këtij detyrimi duke e sjellë këtë kërkesë në vëmendje të Kuvendit.

## IV.II KONTROLLI “EX OFFICIO” GJATË VITIT 2013.

**KDMP, për vitin 2013, ka ushtruar kontrole dhe inspektive administrative në 213 kontrollues të ndryshëm.** Kjo veprimtari është shtrirë në disa rrethe të vendit si Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Fier, Korçë, Peshkopi, Lezhë, Sarandë, Gjirokastrë etj. Fushat ku ky kontroll është fokusuar janë: një pjesë e sistemit bankar, sistemi shëndetësor privat dhe publik, disa institucione shtetërore që ofrojnë shërbime publike, disa të tjera që kanë një përqëndrim dhe një përpunim masiv të të dhënave personale për shkak të veçantisë së legjislacionit mbi bazën e të cilit operojnë, si dhe media e shkruar.

Për të gjitha këto shkelje Komisioneri ka dalë me Rekomandime, me qëllim shuarjen e shkeljes, krijimin e hapsirës ligjore nga vetë kontrolluesi për të garantuar mbrojtjen e të dhënave që përpunon, përputhshmërinë e veprimeve të përpunimit me parimet e Ligjit dhe akteve të Komisionerit. Kryesisht, këto kontrole janë përqëndruar në përpunimin e të dhënave personale nga kontrollues të mëdhenj dhe objektet e këtyre kontrolleve kanë qenë tematik dhe kanë synuar të monitorojnë dhe mbikëqyrin përpunimin bazuar në akte specifike të Komisionerit, sipas fushave. Kështu, në këtë kuadër janë inspektuar disa kontrollues publik si **Ministria e Drejtësisë, Gjykata, Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Avokati i Popullit Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, QSUT**, etj. Këto inspektive u realizuan me iniciativën e Komisionerit, dhe synonin në verifikim e gjendjes dhe në dhënien e rekomandimeve për marrjen e masave konkrete nga kontrolluesit e mëdhenj.

**Gjithashtu, janë ushtruar kontrole edhe në subjekte private me qëllim verifikimin e përpunimit dhe marrjen e pëlqimit, për verifikimin e procesit të transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale të mbledhura, për verifikimin e përpunimit të të dhënave me qëllim zhvillimin e anketimeve të ndryshme ku subjektet e të dhënave janë identifikuar, për verifikimin e përpunimit të të dhënave me qëllim zhvillimin e marketingut direkt dhe mesazheve promocionale, si dhe publikimin e të dhënave nëpër media, kryesisht të fotove dhe të dhënave sensitive.**

**Përsa i përket inspektiveve për verifikimin e plotësimit të detyrimit për njoftim në këtë kuadër janë verifikuar mbi 30 kontrollues.** Për këtë lloj mbikëqyrje është ndjekur strategjia që nëse kontrolluesi brenda 48 orëve të fillimit të inspektimit plotëson këtë detyrim ndaj tij nuk do të merret masa administrative gjorbë. Kjo praktikë ka funksionuar dhe në shumicën e rasteve subjekti ka njoftuar dhe vetëm në 1 rast është aplikuar masa gjorbë.

Për të gjitha këto shkelje Komisioneri ka dalë me Rekomandime, me qëllim shuarjen e shkeljes, krijimin e hapësirës ligjore nga vetë kontrolluesi për të garantuar mbrojtjen e të dhënave që përpunon, përputhshmërinë e veprimeve të përpunimit me parimet e Ligjit dhe akteve të Komisionerit. **Në disa kontrollues u gjetën shkelje të rënda dhe për disa u lëshuan Urdhëra të menjëhershëm nga Komisioneri për shuarjen e shkeljeve dhe në 7 (shtatë) raste ka dhënë vendim me masën administrative Gjorbë.**

### ■ Problematikat e hasura.

- Lidhur me publikimin e vendimeve gjyqësore me të dhëna personale të subjekteve të cilët marrin pjesë në proceset gjyqësore (të paanonimizuara);

- Lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale në lidhje me transferimin ndërkombëtar të të dhënave;
- Lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale në lidhje me marrjen e pëlqimit të subjekteve të të dhënave;
- Lidhur me hartimin e rregulloreve të veçanta ku të përcaktohen qartë rregulla për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale;
- Lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale gjatë realizimit të “Anketimit mbi nevojën për trajnime në personelin shëndetësor”;
- Lidhur me masat e sigurisë dhe kohën e ruajtjes të të dhënave personale.

#### IV.III KONTROLLET SIPAS FUSHAVE.

##### ■ Institucione Publike

Institucionet shtetërore nga viti në vit kanë qenë në fokusin e Autoritetit të Komisionerit. **Kështu për vitin 2013 u përzgjedhën disa institucione të cilat kanë përpunim të madh të të dhënave, sikurse i listuam më sipër, duke synuar kontrole tematike të përcaktuara dhe që do të ishte në interes të individit si subjekt i të dhënave, pikërisht për të shmangur rrisqet më të larta të cënimit të privatësisë dhe të të dhënave personale.**

Në këtë kuadër vlen të përmendet rasti i kontrollit të Ministrisë së Drejtësisë përsa i përket administrimit të publikimit të vendimeve gjyqësore nëpërmjet portalit [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al). Pranë kontrolluesit Ministria e Drejtësisë u konstatuan shkelje të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr.15 datë 23.12.2011 “Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor” të cilat lidhen me publikimin në portalin [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al) të të dhënave të subjekteve personale pjesëmarrëse në procese gjyqësore.

Këtij kontrolluesi të rëndësishëm i është kërkuar marrja e disa masave të rëndësishme për të qenë në përputhje me parimet e ligjit dhe akteve nënligjore për mbrojtjen e të dhënave personale të subjekteve në fushën e sistemit gjyqësor. Me anën e Rekomandimit, Ministrisë së Drejtësisë i është kërkuar që të marrë masat e nevojshme që publikimi i vendimeve gjyqësore në portalin [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al), të bëhet duke bërë anonime të dhënat personale të subjekteve që marrin pjesë në procese gjyqësore; vendimet gjyqësore që do të publikohen në portalin [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al) pas këtij Rekomandimi, duhet të respektojnë kërkesat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale të subjekteve pjesëmarrës në procese gjyqësore.

Gjithashtu, ju kërkua të ndërtohet një strategji lidhur me anonimizimin e të dhënave personale për vendimet e vjetra të cilat aktualisht ndodhen të publikuar në portal; të hartohet një Rregullore e veçantë referuar ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, për “Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”. Në kontratën e lidhur me subjektin që realizon shërbimet teknike për mirëmbajtjen e “Sistemit Informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore” (ICMIC), të përfshihen rregulla lidhur me mbrojtjen dhe kofidencialitetin e të dhënave personale.

Në institucione publike që mbulojnë fushën e shëndetësisë është kërkuar që në kontratën tip që lidhet me të gjitha farmacitë dhe depot e farmacive të parashikohen rregulla të detyrueshme për palët për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave personale që ato mbledhin dhe përpunojnë, si dhe të merren të gjitha masat e nevojshme për të përfshirë në udhëzimet, rregullat dhe procedurat lidhur me “Regjistrin e dhënësve privat të shërbimit”, mbrojtjen e të dhënave personale.

Përmendim rastin e kontrollit pranë “Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave” Tiranë me objekt: “Zbatimi i udhëzimit nr 3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”. Në përfundim të këtij kontrolli, kontrolluesit i është Rekomanduar që në zbatim të kërkesave ligjore të Udhëzimit nr.2 datë 14.02.2013 “Për monitorimin, regjistrimin dhe administrimin e të dhënave të sistemit të kamerave”, në të gjitha Degët Doganore ku është vendosur ky sistem; të vendosen tabela për informimin e subjekteve të të dhënave personale për përdorimin e sistemit të “Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi”; të respektohet koha për ruajtjen e regjistrimeve; të respektohet e drejta për akses; të ruhet konfidencialiteti dhe siguria për të dhënat që mbledhen nga ky sistem; të respektohen të drejtat e subjekteve të të dhënave personale të cilëve u përpunohen të dhënat nga përdorimi i këtij sistemi. Lidhur me administrimin e të dhënave personale të regjistruara është kërkuar zbatimi i procedurave ligjore për përdorimin e materialeve të regjistruara në rastet kur kërkohen nga organet e përcaktuara me ligj.

Institucioneve publike ju është kërkuar që në faqen zyrtare në internet duhet të publikohen “politikat e privatësisë” (paketë rregullash) me qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale/sensitive, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, për të drejtat e subjekteve të të dhënave (p.sh në rastin e Qendrës Kombëtare të Liçencimit, Regjistri i Barreve Siguruese apo Ministrisë së Drejtësisë) dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. Në këtë kuadër, si dhe për të mbikqyrur sistemet e reja të aplikuar nga disa institucione (p.sh. rastet e Zyrës Rajonale të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë) në zbatim të nenit 5 pika 1 germa ‘c’ të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” është kërkuar të përcaktohet në mënyrë të qartë se cila është kategoria (sasia) e të dhënave tek të cilat duhet të ketë akses çdo palë e tretë në sistem, duke përfshirë këtu subjektet e të dhënave personale, Institucione të tjera si ILDKP, avokatët, noterët etj, duke reflektuar edhe parashikimet e ligjeve specifike me të cilat këto institucione veprojnë sipas pjesës arsyetuese të këtij rekomandimi. Për fat të mirë tanimë këtij rekomandimi i vjen në ndihmë edhe opinioni i dhënë nga komisioneri i cili është i publikuar edhe në faqe.

### ■ Shëndetësi.

Edhe për vitin 2013 fusha e shëndetësisë ka qenë në qendër të vëmendjes së Autoritetit të Komisionerit, i cili ka ushtruar kontrole kryesisht në disa institucione private dhe publike që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këtë fushë, si p.sh në klinika private, qendra spitalore, laboratorë mjeksor dhe farmaci, ku vëmendja jonë nga viti në vit është rritur dhe ka qenë maksimale, duke marrë në konsideratë morinë e të dhënave që mbledhen e përpunohen në këtë sektor dhe veçanërisht të dhënat sensitive.

Gjithashtu, për shkak të rëndësisë, në disa prej tyre kemi ushtruar inspektime për të verifikuar zbatueshmërinë e masave të kërkuara nga Autoriteti i Komisionerit me anën e Rekomandimeve dhe Urdhërave të dhëna në vitet paraardhëse. Vlen të thuhet që në shumicën e rasteve masat ishin marrë duke zbatuar rekomandimet e Komisionerit.

Për shkak të problematikave të konstatuara nëpërmjet shkeljeve, sipas kontrolluesve specifik, Komisioneri për këtë sektor rekomandoi që në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të merren masa për sigurinë fizike të kartelave klinike të pacientëve, *(të cilat mbartin të dhëna personale dhe sensitive si dhe informacion konfidencial lidhur me shëndetin e pacientit, analiza, diagnoza etj)*, duke u vendosur në dollapë apo kasaforta të siguruara me çelës në zyrat dhe pavijonet e kontrolluesit dhe se aksesit në keto zyra dhe pavione duhet të lejohet vetëm për persona të percaktuar në rregulloren përkatëse. Të merren masa për sigurimin e kushteve teknike të përshtatshme për ambientin në të cilin janë vendosur serverat në departamentin e arkivë/statistikës, duke krijuar një ambient me akses të kufizuar si dhe ruajtja e temperaturës konstante me anë të kondicionimit të ajrit.

Në momentin e mbledhjes së të dhënave e në vazhdim, të merren masa që të dhënat personale të pacientëve, të cilat regjistrohen dhe përpunohen në sistemin e përdorur në arkivë/statistikë, të ruhen (Backup) në media të jashtme dhe kopje e tyre (Backup) të vendoset në një vend tjetër të sigurt jashtë vendndodhjes së serverit, si dhe të merren masa për sigurinë e ambientit të arshivës fizike në departamentin e arkiv/statistikë sa i përket kushteve të ambientit, lidhur me mirëmbajtjen e kartelave fizike të pacientëve nga agjentët e lagështisë, zjarrit si dhe nga dëmtimet e mundshme mekanike.

Në zbatim të neni 27, 28 të ligjit, si dhe udhëzimit nr.19 datë 03/08/2012 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimit të një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”, është kërkuar që të merren masa që në kontratat e lidhura me ofruesit e shërbimit për pajisjet dhe sistemet kompjuterike, të vendosen, parashikohen klauzola standarte për sigurinë dhe konfidencialitetin.

Në disa raste (p.sh. në rastin e kontrolluesit Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë), kontrolluesit i është kërkuar që në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, të hartojë rregullore për “Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale”; të hartojë rregulla për qëllimin dhe mënyrën e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet përdorimit të sistemit CCTV; të bëjë informimin e subjekteve të të dhënave personale nëpërmjet vendosjes së tabelave informuese sipas standardit të miratuar nga Komisioneri, bazuar kjo në kërkesat e Udhëzimit nr. 3 dhe 13 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”.

Gjithmonë në kuadrin e kushteve dhe masave për të garantuar sigurinë e këtyre të dhënave sensitive, kontrolluesve në këtë fushë ju kërkua që përdoruesit e caktuar të sistemit elektronik për regjistrimin e klientëve të Klinikës, të aksesojnë të dhënat në mënyrë të kufizuar vetëm nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit përkatës të personalizuar. Personat që kanë akses në kartelat e pacientëve dhe në sistemin e të dhënave, të nënshkruajnë një deklaratë konfidencialiteti për mbrojtjen e të dhënave personale.

Përsa i përket proporcionalitetit në mbledhjen dhe në përpunimin e të dhënave Autoriteti i Komisionerit ka urdhëruar në disa raste që të dhënat e klientëve/pacientëve si *fotografia* dhe *shenjat e gishtave* nuk duhet të përpunohen pasi janë të tepërta dhe në tejkallim të qëllimit të përpunimit. Këto kategori të dhënash, që janë mbledhur deri tani, duhet të fshihen ose të shkatërrohen. Të dhënat personale të klientëve/pacientëve të cilët e kanë marrë rezultatin e testeve dhe për të cilët ka përfunduar marrja e shërbimit nga kontrolluesi, të fshihen/shkatërrohen nga dosjet fizike dhe e-maili, pasi mbahen për një afat që e tejkalon qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar. Ato mund të përpunohen vetëm nëse klienti ka dhënë pëlqimin paraprak në formë shkresore.

Kontrolluesi duhet të hartojë një praktikë për të informuar klientët/pacientët për fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për mënyrën e përpunimit, për të drejtën për akses si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tyre, si dhe në formularë duhet të parashikohet mundësia e revokimit të pëlqimit, në çdo moment që klienti/pacienti e gjykon të arsyeshme, duke e bërë të paligjshëm përpunimin e mëtejshëm të të dhënave personale.

Të kryhet informimi i klientëve mbi procedurën e transferimit të të dhënave të tyre, mënyrën e përpunimit, afatet e mbajtjes, masat e sigurisë dhe konfidencialitetit nga marrësi në vende pa nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, dhe parashikimet e detyrimeve të palëve sipas marrëveshjes. Në marrëveshjen që kontrolluesi ka me laboratorë në vende me nivel jo të mjaftueshëm sigurie duhet të parashikohen të dhënat që do transferohen (pavarësisht se parashikohen në formularë), rregullat mbi mënyrën e transferimit të të dhënave personale dhe sensitive, masat e sigurisë gjatë transferimit, mënyrën e përpunimit të të dhënave dhe masat e sigurisë dhe konfidencialitetit gjatë përpunimit, afatet e përpunimit të të dhënave dhe mënyra e shkatërrimit të tyre pas përfundimit të marrëveshjes.

Në faqen zyrtare në internet duhet të publikohen “politikat e privatësisë” me qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale/sensitive, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave (klientëve/pacientëve) dhe detyrimet e kontrolluesit (laboratorit) në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. Politikat e privatësisë synojnë sensibilizimin e publikut mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtat që gëzojnë në këtë fushë.

Përsa i përket kohës së ruajtjes së të dhënave, ato nuk duhet të mbahen më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar. Të respektohen afatet e parashikuara në kreun III “Ruajtja e të dhënave shëndetësore” të Udhëzimit nr. 23, datë 20.11.2012 “Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë”.

#### ■ Arsim.

Edhe në këtë sektor janë ushtruar një numër i konsiderueshëm kontrollesh dhe inspektimesh për të verifikuar nëse janë marrë masa nga kontrolluesit e kësaj fushe, të kërkuara nga Rekomandimet dhe Urdhërat e mëparshëm të Autoritetit të Komisionerit. Bazuar në gjetjet e grupeve të kontrollit/inspektimit, ku në qendër të objekteve të këtyre kontrolleve/inspektimeve ka qenë

verifikimi i ligjshmërisë së mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave sipas parimeve të ligjit dhe udhëzimeve të Komisionerit të miratuara për këtë fushë, janë dhënë rekomandime specifike.

Rekomandimet e Komisionerit kanë konsistuar në zbatim të neneve 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar. Për shembull: kontrolluesit Arsimor Parauniversitar jo publik “Kolegji Preka” Korçë, i është kërkuar të hartohet rregullore e veçantë lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe kofidencialitetin e të dhënave personale; të shprehet në “formularët e aplikimit për regjistrim” dhe në “kontratën e regjistrimit”, në mënyrë të shkruar, qëllimi i saktë, i qartë dhe specifik, për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale për kategorinë “nxënës” (subjekte të të dhënave personale), si dhe të bëjë informimin e këtyre subjekteve të të dhënave personale.

Përsa i përket proporcionalitetit është urdhëruar që në zbatim të nenit 5 pika 1/c të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera” i ndryshuar, të ndalohet menjëherë mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale përmes përdorimit të sistemit të “video survejimit” (CCTV) në sallat e leksioneve dhe korridoret e brendshme të ambienteve të kontrolluesit. Në këtë kuadër të shkatërrohen menjëherë të dhënat personale (imazhe) të mbledhura dhe të përpunuara përmes përdorimit të sistemit të “video survejimit” (CCTV) në sallat e leksioneve dhe korridoret e brendshme të ambienteve të kontrolluesit, si dhe të vendosen menjëherë tabela informimi në vende të dukshme për informim të subjekteve të të dhënave personale për përdorimin e sistemit të “video survejimit” (CCTV).

Për plotësimin e kuadrit të masave për garantimin e sigurisë të të dhënave që mblidhen e përpunohen, është kërkuar nga kontrolluesit që të hartohet rregullore për qëllimin, mënyrat e mbledhjes, ruajtjes dhe përpunimit, të të dhënave personale nëpërmjet përdorimit të sistemit të “video survejimit” (CCTV), duke ju ofruar asistencën tonë, si dhe në faqet në internet duhet të publikohen “politikat e privatësisë” me qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale/sensitive, masat e sigurisë dhe ruajtjes së kofidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. Gjithashtu, personat që kanë akses në të dhënat personale të studentëve, ata që kanë akses në dosjet e dokumenteve të punonjësve dhe që aksesojnë të dhënat e siguruar nga sistemi CCTV, duhet të nënshkruajnë një deklaratë kofidencialiteti për mbrojtjen e të dhënave personale.

### ■ **Subjekte Private.**

Përsa i përket fushave të tjera ku operojnë kontrollues privat të mëdhenj në aktivitetin e tyre si Sistem bankar, Marketing, Agjenci punësimi, Agjenci turistike, Këmbim Valutor, Shërbime, foto, kamera, Siguria Fizike, Telekomunikacion, Tregti-shërbime, Supermarket, Agjenci imobiliare (2), Hoteleri (8), Bar-kafe (4), Kompani sigurimesh, objektet e kontrolleve kanë konsistuar në shumicën e rasteve në sigurinë dhe kofidencialitetin e të dhënave, ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave nëpërmjet kamerave CCTV, transferimin ndërkombëtar të të dhënave, informimin e subjekteve të të dhënave dhe marrjen e pëlqimit për përpunimin e të dhënave të tyre, verifikimin e zbatimit të rekomandimeve, si dhe plotësimin e detyrimit për të njoftuar.

Për këtë kategori kontrolluesish rekomandimet dhe urdhërat e Komisionerit kanë synuar që të merren masa për hartimin e një rregullore të shkruar për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, përdorimit të video-survejjimit, regjistrim me kamera të bëjnë informimin duke u vendosur tabelat informuese në vende të dukshme për përdorimin e video survejimit dhe përpunimin e të dhënave personale, sipas standardit të miratuar nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Të dhënat e klientëve mbi numrin e kartës së identitetit dhe adresës së banimit të fshihen nga sistemi/kompjuteri pasi janë të tepërta dhe në tejkallim të qëllimit të përpunimit. Ato mund të përpunohen vetëm nëse klienti ka dhënë pëlqimin paraprak në formë shkresore. Të dhënat personale të klientëve që u ka mbaruar abonimi për të frekuentuar *qendër argëtimi*, të fshihen nga sistemi/kompjuteri, pasi mbahen për një afat që e tejkalon qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar.

Të dhënat e punonjësve të administruara në dosje, të shkatërrohen pas përfundimit të marrëdhënies së punës (në zbatim të shkronjës d) të nenit 5 të ligjit dhe Udhëzimit nr.11, datë 08/09/2011 mbi “Përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat”).

Të merret në formë shkresore pëlqimi i klientëve, për mbledhjen dhe përpunimit të të dhënave të tyre personale, veçanërisht për fotografitë e tyre. Kontrolluesi duhet të hartojë një praktikë për të informuar klientët për fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për mënyrën e përpunimit, për të drejtën për akses si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tyre.

Në zbatim të nenit 27,28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar, personat që kanë akses në të dhënat personale të klientëve, ata që kanë akses në dosjet e dokumenteve të punonjësve dhe që aksesojnë të dhënat e siguruar nga sistemi CCTV, duhet të nënshkruajnë një deklaratë konfidencialiteti për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithashtu, është kërkuar që të hartohet një rregullore e brendshme lidhur me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara për qëllime të ushtrimit të aktivitetit dhe të dhënat e mbledhura nga sistemi i video survejimit, ku të parashikohen masa konkrete sigurie, detyrimet e kontrolluesit dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave.

Në ambientet e survejuara me kamera (jashtë godinës) të vendosen tabela informuese në pozicione lehtësisht të dukshme (sipas modelit të parashikuar në Udhëzimin nr. 3 të cituar më sipër) lidhur me veprimin e sistemit të video survejimit (bazuar edhe në nenin 18 të ligjit). Të rregullohet këndi i kamerave të jashtme të drejtuara nga trotuari dhe nga rruga, duke shmangur regjistrimin e kalimtarëve. Kamerate duhet të fokusohen vetëm nga fasada e godinës dhe hyrja e kontrolluesit (në kuadër të zbatimit të nenit 5/1/c të ligjit). Për kamerat e vendosura në hyrje të pallateve/godinave (në ambientet e përbashkëta të pallatit, në korridor), kontrolluesi duhet të marrë në formë shkresore pëlqimin e 75 % të banorëve të godinës, në zbatim të shkronjës b), të pikës 5, të Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar dhe neneve 5/1/b dhe 6/1/a të ligjit.

Duke marrë në konsideratë situatat e ngjashme të gjendjes së përpunimit nga kontrolluesit e këtij grupi të gjerë fushash të subjekteve private, që përbëjnë kontrolluesit që u mbikëqyrën më së shumti në vitin 2013 dhe të cilat u parashtruan më sipër, mund të veçojmë disa specifika për disa

nga fushat. Kështu, për agjencitë turistike/udhëtimeve është kërkuar në mënyrë të veçantë me rekomandime dhe urdhëruar që të informohen në mënyrë të qartë subjektet e të dhënave “klientë” për qëllimin e përpunimit “marketing direkt”, përpara se tju kërkohej nëse pranojnë t’u dërgohen mesazhe promociionale në adresat e tyre elektronike. Të dhënat personale të klientëve që nuk pranojnë t’u dërgohen mesazhe promociionale ose nuk i përgjigjen kërkesës të fshihen nga sistemi që funksionon për dërgimin e mesazheve promociionale.

Përsa i përket të dhënave të mbledhura, ruajtura dhe përpunuara nga subjekte që ushtrojnë aktivitetin e tyre nëpërmjet fotove dhe zhvillimit të pamjeve fotografike (larjes dhe stampimit të fotove), Komisioneri urdhëroi fshirjen nga kompjuteri dhe paisjet e tjera të të gjitha fotografive të klientëve, pasi mbahen për një afat që e tejkalon qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar dhe të mbahen vetëm të dhënat personale (fotot) për të cilat është dhënë paraprakisht pëlqimi i shprehur qartë (në formë shkresore) i subjektit të të dhënave (klientit). Për çështje të sigurisë të këtyre të dhënave, në çdo rast kur kontrolluesi kontraktin një palë të tretë për të realizuar shërbime Hardware dhe Software të pajisjeve elektronike që përmbajnë foto, të parashikohet edhe një deklaratë konfidencialiteti dhe sigurie në të cilën të përcaktohen detyrime konkrete (për palën e tretë) në rast të cënimit të privatësisë.

Sikurse edhe në vitet paraardhëse në rastet e përpunimit nga një kompani celulare, Komisioneri, në mbështetje të neneve 5 pika1/d, 27/4 të i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, ka kërkuar duke urdhëruar shkatërrimin e të dhënave personale që ruhen dhe administrohen në mënyrë elektronike (në sisteme) dhe në kaseta (tape), skedarët e klientëve (tabulatet e komunikimit), të cilët kanë plotësuar afatin mbi dy vjet.

### ■ Gjyqësori.

Është një fushë që ka filluar të mbikëqyret me interes të veçantë nga Autoriteti i Komisionerit që në vitin 2012, duke marrë në konsideratë hyrjen të fuqi të Udhëzimit Nr. 15, datë 23.12.2011 "Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor" dhe për shkak të një sërë ankesash të paraqitura pranë Komisionerit që në vitin 2012. Problematika e parashtruar nga ankuesit dhe shpesh e ngritur edhe nga përfaqësuesit e organizmave evropiane (së fundmi edhe duke e paraqitur konkretisht në progres-raportin e fundit të BE-së) ka të bëjë me bërjen publike të të dhënave të individëve palë në proceset gjyqësore në kundërshtim me ligjin dhe udhëzimin përkatës.

Në këto kushte në fillim të këtij viti Komisioneri pasi ushtroi kontroll në Gjykatën e Apelit Durrës, Gjykatën e Apelit Tiranë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatën e Rrethit Vlorë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë gjeti shkelje në përpunimin e të dhënave përsa i përket përhapjes së tyre nëpërmjet publikimit në internet të vendimeve gjyqësore nëpërmjet “Sistemit Informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore” (ICMIC). Gjetjet dhe fakti që sistemi administrohet nga Ministria e Drejtësisë çuan në kontrollin edhe pranë kësaj ministrie në vijim, sikurse e paraqitëm më sipër.

Komisioneri, duke marrë në konsideratë situatën shqetësuese për cënimin e privatësisë dhe të dhënave të palëve në procese (subjekteve të të dhënave) lëshoi urdhëra duke kërkuar nga këto gjykata që të pezullohet publikimi i vendimeve gjyqësore pa realizuar anonimizimin e të dhënave

të subjekteve, në portalin [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al) si dhe marrjen e masave organizative dhe teknike për të garantuar sigurinë e këtyre të dhënave dhe të të gjithë procesit të mbledhjes dhe përpunimit, bazuar në udhëzimin specifik për gjyqësorin.

Pavarësisht masave të marra në rastet konkrete, si reagim ndaj urdhërave të Komisionerit pas shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga qytetarë të ndryshëm, ku është urdhëruar anonimizimi i të dhënave personale të personave ankues, edhe sot vijojnë të publikohen vendime gjyqësore ku të dhënat personale të subjekteve pjesëmarrës në procest gjyqësore vijojnë të publikohen në kundërshtim më ligjin dhe udhëzimin. Komisioneri në përfundim të kontroleve të ushtruara ka konkluduar se: gjykatat në rolin e kontrolluesit hedhin dhe përpunojnë të dhëna personale në sistemin ICMIS (*sistemi informatik i gjykatave për menaxhimin e çështjeve civile dhe penale*) dhe nuk janë përgjegjëse për publikimin e vendimeve, pasi publikimi i vendimeve gjyqësore është kërkuar nga Ministria e Drejtësisë me qëllim të realizimit të transparencës dhe të informimit të publikut për vendimet gjyqësore që merren në gjykatat tona dhe ky publikim realizohet nga kjo Ministri në portalin [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al). Komisioneri ka komunikuar me Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin e Lartë të Drejtësisë, Këshillin e Ministrave dhe Ministrinë e Financave, me qëllim sensibilizimin e tyre për këtë problem kaq të rëndësishëm, si dhe ka kërkuar nga këto Institucione të jenë promotor të iniciativave dhe projekteve në funksion të zbatimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, kërkesa këto të rëndësishme në rrugën e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Komisioneri ka kërkuar që Ministria e Drejtësisë të mbështetet me fondet e duhura për realizimin e kesaj detyre të rëndësishme e kërkuar për këtë Institucion dhe në raportin vjetor të BE-së, me qëllim që publikimi i vendimeve gjyqësore në portalin [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al) të bëhet sipas kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Citojmë:

“PROGRES RAPORTI 2013 PËR SHQIPËRINË” (Progres Raporti 2013 i Komisionit European për Shqipërinë, Bruksel, më 16.10.2013, Kreu 4, “Aftësia për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit”, Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, Nëntitulli “Sistemi gjyqësor”, faqe 47) në kapitullin 23: “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, në të cilin është kërkuar që...“*Publikimi i vendimeve gjyqësore, që nuk është i garantuar plotësisht, duhet të marrë parasysh të gjitha aspektet që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale. Duhet të ndiqen rekomandimet përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Nuk është bërë përparim në përditësimin e databazës elektronike në Qendrën e Dokumentacionit Gjyqësor*”.

#### IV.IV GJOBAT E VITIT 2013.

Në zbatim të kompetencave të Komisionerit, pas mbylljes të procedurave të kontrollit dhe inspektimit administrative, **janë vendosur 7 gjoba; konkretisht për subjektet që ju përkasin fushave të gazetarisë dhe medias (2)** përse i përket publikimit të të dhënave personale pa anonimizimin e tyre si dhe mos fshirjes së tyre pas përfundimit të qëllimit; **fushës së shëndetësisë**

(1) përsa i përket të dhënave të mbledhura në mënyrë joproporcionale përkundrejt qëllimit si dhe mosmarrjes së pëlqimit të informuar; **biznesit të madh** (4) përsa i përket mos informimit të subjekteve sidomos në rastin e marrjes së pëlqimit të informuar në ushtrimin e marketingut direkt, hartimit të akteve që garantojnë sigurinë dhe konfidencialitetin, transferimin ndërkombëtar në një vend pa nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale pa pëlqimin e subjekteve të të dhënave dhe pa përmbushjen e kriterëve ligjore, si dhe për mos plotësimin e detyrimit për njoftim.

Theksojmë, se përkundrejt rritjes së numrit të kontrolleve dhe inspektimeve administrative, si dhe ankesave të ardhura pranë Komisionerit, numri i vendimeve për gjobë është më i ulët nga viti paraardhës 2012. Kjo, për arsyen primare se ka rezultuar dhe është konstatuar reagimi dhe marrja e masave të menjëhershme nga ana e kontrolluesit duke i shuar shkeljet e konstatuara, çka është edhe synimi, strategjia dhe politika e Autoritetit të Komisionerit. Vetëm në rastet e përsëritura, mos marrja e masave pas lëshimit të rekomandimeve dhe urdhërave dhe në vazhdim të cënimit të të drejtave të individëve autoriteti e ka parë të pashmangshëm vendosjen e gjobave.

#### **IV.V NDJEKJA E PROCESIVE GJYQËSORE DHE EKZEKUTIMI I VENDIMEVE NGA PËRMBARIMI.**

Për gjatë vitit 2013 është vijuar me vënien në ekzekutim të detyrueshëm pranë Shërbimit Përmbarimor Privat, të vendimeve administrative me gjobë të dhënë në vitin 2011 nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për kontrollues të ndryshëm, për të cilët janë lëshuar urdhërat e ekzekutimit në vitin 2012 dhe nuk ishin vënë në ekzekutim për shkak të problematikave me ekzekutimin nga Shërbimi Përmbarimor Shtetëror.

Për gjatë vitit 2013 është vijuar me vënien në ekzekutim të detyrueshëm të vendimeve administrative me gjobë të nxjerra në vitin 2011, janë vënë në ekzekutim të detyrueshëm 21 (*njëzet e një*) vendime gjobe administrative të cilat janë në ekzekutim e sipër. Për vitin 2013, janë nxjerrë 7 (*shtatë*) vendime administrative me gjobë, nga të cilët 2 (dy) vendime janë ekzekutuar në mënyrë vullnetare nga kontrolluesi, 2 (dy) vendime janë ankimuar në Gjykatë, për 3 (tre) vendime do vijohet me kërkesat pranë Gjykatës për ekzekutimin e tyre, për 1 (një) nga këto vendime (*vendimi nr.07, dt 31.12.2013*) afati i ankimit ishte deri me 31.01.2014.

Është marrë pjesë në të gjitha seancat gjyqësore për ndjekjen e procesit gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çështjen civile me paditës: Gazeta “Koha Jonë” dhe të paditur: Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me objekt: “Anulim i aktit administrativ, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, me anë të të cilit ky kontrollues është gjobitur. Aktualisht, çështja është në Gjykatën e Apelit Tiranë, në pritje të datës për shqyrtim.

Është marrë pjesë në të gjitha seancat gjyqësore për ndjekjen e procesit gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çështjen civile me paditës: Klinika Gjinekologjike “Gliozheni” dhe të paditur: Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me objekt: “Anulim i aktit administrativ, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, me anë të të cilit ky

kontrollues është gjobitur. Aktualisht, çështja është në Gjykatën e Apelit Tiranë, në pritje të datës për shqyrtim.

Është ndjekur pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë çështja e Cez Shpërndarje me - KMDP lidhur me ankimin e vendimit nr. 15 datë 13.11.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Vendimi nr. 15 datë 13.11.2012 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe çështja është ankimuar nga Cez Shpërndarje pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, e aktualisht jemi ende në proces.



## V. ADMINISTRIMI I BRENDSHËM

Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale e realizon aktivitetin e tij nëpërmjet veprimtarisë së 29 punonjësve, në zbatim të Ligjit nr. 119/2012, datë 17/12/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”.

Kjo Strukturë nuk ka patur ndryshime gjatë vitit 2013 dhe paraqitet sipas Vendimit të Kuvendit Nr. 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimin e pagave të pozicioneve të punës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, me një ndryshim të vetëm të parashikuar në ligjin dhe vendimet përkatëse “Për rregullimin e Shërbimit të Transportit të Funkionarëve politikë”, suprimimin e pozicionit të shoferit.

Referuar vendimit 474, datë 16.06.2011 “Për përcaktimin e standardeve e procedurës që duhet ndjekur gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve” si dhe ligjeve e akteve të tjera financiare, të detyrueshme për zbatim është dhënë mendimi lidhur me ndryshimet në organikën, kategorizimin e pozicioneve të punës, strukturës së KMDP-së.

**Institucionalisht është dërguar për shqyrtim dhe miratim ndryshimi i strukturës dhe organikës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale së bashku me relacionin përkatës në Mars 2013.**

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse është struktura mbështetëse e funksionimit të KMDP-së në realizimin e misionit të tij: *“Garantimi dhe mbrojtja e të dhënave Personale”*.

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse ka si mision të saj:

- Ofrimin e shërbimeve cilësore, efektive, transparente, me anë të një administrate funksionale, të paanshme, profesionale, e aftë dhe përgjegjëse për t’iu përgjigjur sfidave dhe rreziqeve ndaj shkeljeve abuzive të privatësisë, dhënien e një garancie të plotë në mbrojtje të të dhënave personale të shtetasve;
- Ofrimin e standardeve të larta profesionale mbështetëse, nëpërmjet përdorimit me efektivitet dhe efikasitet të burimeve të saj të brendshme financiare, për plotësimin dhe realizimin me sukses të misionit dhe funksionit të KMDP, duke rritur cilësinë e shërbimeve dhe duke ia përshtatur atë ndryshimeve të ndodhura gjatë zbatimit të planifikimit strategjik.

Përmes saj është realizuar menaxhimi i burimeve në përputhje me kërkesat e procedurat e Ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit Civil”, ka programuar dhe zhvilluar kapacitetet njerëzore nëpërmjet trajnimeve duke shfrytëzuar të gjitha burimet e brendshme e të jashtme.

### V.I PËRMIRËSIMI NË MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE DHE ADMINISTRIMIN E BRENDSHËM TË STAFIT TË AUTORITETIT.

Vëmendja e burimeve njerëzore është përqendruar në:

- Rekrutimin e punonjësve gjithnjë e më cilësor;
- Zhvillimi profesional dhe atë të karrierës;

- Nxitjen dhe motivimin e punonjësve.

Janë realizuar me profesionalizëm dhe përgjegjshmëri të plotë detyrat e përcaktuara qartë në Rregulloren e brendshme, të ndryshuar, në lidhje me procedurat e rekrutimit të punonjësve për vendet vakante të evidentuara apo dhe lëvizje të tjera të brendshme në zbatim të ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil”, neni 10 “Për institucionet e pavarura” të cila kalojnë në disa procese të evidentuara më poshtë.

### ■ Rekrutimi – Konkurrimi.

Gjatë vitit 2013, janë ndjekur të gjithë hapat dhe procedurat mbi rekrutimin e punonjësve lidhur me vendet e shpallura vakant në zbatim të ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil”, neni 10 “Për institucione të pavarura” duke filluar nga evidentimi i pozicionit, plotësimi i kërkesave të përgjithshme e të veçanta për të, shpalljen në gazeta me tirazh më të lartë, është realizuar paraseleksionimi i aplikantëve, janë vlerësuar kandidatët dhe menaxhuar sistemi i testimit deri në vlerësimet përfundimtare për shpalljen e fituesit dhe emërimet në periudhën e provës.

Evidentojmë se për vitin 2013, janë ndjekur **tre procedura konkurrimi** dy nga të cilat kanë rezultuar të sukses-shme, ku dhe janë shpallur fituesit, më konkretisht:

- Pozicioni i specialistit të Marrëdhënieve me Jashtë pranë DÇPLMJ, procedurë e cila është shpallur 2 herë radhazi pasi kanë rezultuar shpalljet të pasukses-shme për vlerësim nën nivelin e përshatshëm të pranimit në shërbimin civil. ( vlerësuar nën 50 pikë).
- Pozicioni i specialistit të Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse ku pas ndjekjes së procedurës për rekrutim, respektimit të afateve dhe limiteve kohore u shpall fituesi në zbatim të V.K.M nr.231, datë 11.05.2000 “Për pranimin në shërbimin civil dhe periudhën e provës”, pas lirimit nga detyra dhe shërbimi civil, i punonjësit parardhës si rezultat i mbushjes së moshës për dalje në pension pleqërie.
- Pozicioni i shpallur si vend vakant i Drejtorit të Marrëdhënieve me Publikun, në muajin Dhjetor 2013, procedurë e cila rezultoi e pasukses-shme pasi nuk pati asnjë aplikant, të ofruar nga jashtë dhe asnjë nëpunës civil brenda institucionit, për zbatimin e procedurës së ngritjes në detyrë apo lëvizje paralele.

Aktualisht është ende vakant/pozicioni i Drejtorit të Marrëdhënieve me Publikun, vend i cili duke filluar nga muaji Maj 2013 është menaxhuar dhe marrë përsipër kompetencat dhe përgjegjësitë e parashikuara në legjislacionin përmes procedurës së transferimit (komandimit) në detyrë, deri në zhvillimin dhe përfundimin e procedurave të konkurrimit.

### ■ Lëvizje paralele.

Janë aplikuar dhe ndjekur procedurat e lëvizjeve paralele, kryesisht në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave, përvojave dhe aftësive individuale të punonjësve të cilat synojnë zhvillimin, forcimin e rritjen e efektivitetit të punës, të Drejtorive respektive.

Kjo procedurë, në respektim të legjislacionit në fuqi ka prekur stafin e tre drejtorive; Drejtorinë e Regjistrimit, Drejtorinë e Çështjeve Procedurale Ligjore e Marrëdhënieve me Jashtë si dhe Drejtorinë e Hetim-Inspektimit ( 4 specialistë ).

#### ■ Emërime të përkohshme me kontratë, komandime dhe lirim nga detyra .

Gjatë vitit 2013, në zbatim të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.2003 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, Legjislacionit të Shërbimit Civil, Kodit të Punës, janë ndjekur procedurat e lëvizjeve të stafit, si lirime nga detyra, emërime të përkohëshme dhe komandime në periudha të shkurtra kohore, kundrejt kontratave të lidhura me personat e emëruar.

Rastet dhe arsyet janë të ndryshme të cilat kanë patur motiv, arsyen e mbushjes së moshës për daljen në pension pleqërie, për të cilën janë dhënë aktet e lirimit dhe zëvendësimit me të përzgjedhurin nga ndjekja e procedurave të konkurrimit, emërimet e përkohshme në periudha nga 3- 6 -9 muaj, si pasojë e paaftësisë së përkohshme – leje lindje apo dhe komandimet në detyrë si rezultat i fillimit të procedurave disiplinore dhe përfundimit të tyre me masat ekstreme të Lirimit nga Shërbimi Civil.

#### ■ Disiplina në punë.

Gjatë vitit 2013 është monitoruar vijimësisht respektimi i paraqitjes në punë dhe zbatimi i orarit zyrtar nga ora 8.00 deri në përfundim të tij, ora 16.30. Janë mbajtur evidenca ditore të paraqitjes, lëvizjet e mungesat e arsyeshme ose jo në listë prezencë.

Gjatë vitit 2013, në ndryshimet që parashikoi Rregullorja e Brendshme, u përforëcuan nenet përkatëse të disiplinës në punë, të zbatimit të orarit, afateve të paraqitjes së njoftimeve dhe raporteve të paaftësisë, personave përgjegjës për administrimin e tyre, si dhe u përfshinë përgjegjësi, kompetenca dhe detyrime në zbatim të Ligjit nr.10296, datë 08/07/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Është kryer ndjekja e planifikimit dhe kryerjes së pushimit vjetor të paguar të punonjësve, në zbatim të Vendimit nr. 463, datë 16.06.2011 “Mbi disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.511,datë 24.10.2002 të K.M “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2011 mbi zbatimin e VKM së sipërcituar të Ministrisë së Financave.

#### **Masa disiplinore**

Lidhur me procesin e disiplinës në punë, respektimit të orarit dhe paraqitjes në punë, planifikimit dhe kryerjes së pushimeve apo dhe detyrimeve të tjera për zbatim, parashikuar në Rregulloren e

Brendshme të institucionit dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, evidentojmë rastet e thyerjes së disiplinës për pasojë ndjekjen e dy procedurave “Fillim ecurie disiplinore” konkretisht:

- Në mbështetje të nenit 25, pika 2, të Ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Për Statusin e Nëpunësit Civil”, pikës 2 të VKM nr. 306, datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, në vijim të procedurës së “Njoftimit për fillim procedure për dhënie masë disiplinore” ndaj *një* Specialiste në Drejtorinë e Regjistrimit, u konkludua me dhënien e Vendimit “Largim nga shërbimi Civil” si dhe me daljen e aktit të “Lirimit nga Shërbimi Civil”.
- E njëjta situatë dhe procedurë është ndjekur dhe për nivelin Drejtor në Drejtorinë e Regjistrimit, ku pas konstatimit të shkeljeve, shkaqeve dhe pasojave u ndoq në mënyrë të përshkallëzuar marrja e masave disiplinore deri në dhënien e Vendimit “Largim nga shërbimi Civil” si dhe me daljen e aktit të “Lirimit nga Shërbimi Civil”.

Pas ndjekjes së proceseve të ankimimit në organet kompetente gjyqësore, nga ana e nëpunësve të larguar me masë disiplinore (paditës), vijon procesi i ankimimit për specialistin e regjistrimit në Drejtorinë e Regjistrimit, proces i cili ndiqet nga personat e ngarkuar për ndjekjen e proceseve gjyqësore.

Sa i përket punonjësit të larguar në nivel Drejtor Drejtorie, pas ndjekjes së procesit të ankimimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, pavarësisht se në vëmendjen tonë shkaqet dhe arësyet e largimit nga detyra kanë qenë mëse të argumentuara, në kushtet e zbatimit të Vendimit të dhënë nga gjykata, dhe pas marrjes formë të prerë të tij, nga ana e institucionit tonë u morën masat e menjëhershme të ekzekutimit në mënyrë vullnetare, nëpërmjet miratimit të akteve të KMDP-së për rikthimin në pozicionin e mëparshëm të ish-drejtorit, si dhe ekzekutimin e plotë të të gjithë detyrimeve të parashikuara në vendimin e mësipërm. Megjithë kryerjen e të gjithë njoftimeve për paraqitjen në detyrë siç edhe vendosi gjykata, pasi ankuesja kërkoi rikthimin, ish drejtorja përsëri nuk u paraqit.

#### ■ Bashkëpunime me organe të tjera.

- Gjatë periudhës 12- mujore të vitit 2013, është mbajtur kontakt i rregullt me ILDKP, për axhornimin e regjistrimit të nëpunësve, që mbartin detyrimin për deklaram të interesave private e burimin e krijimit të tyre, me lëvizjet e ndryshimet e ndodhura. Lëvizjet dhe detyrimet për deklaram kanë qenë më të shumta se në vitin 2012, proces i cili është monitoruar me kujdes dhe janë marrë masat për respektim të afateve të mbledhjes së deklaratave dhe dorëzimit të tyre, njoftimeve përkatëse të nëpunësve të larguar komanduar për deklaram individual ose nëpërmjet autoritetit përgjegjës të KMDP-së.
- Janë dërguar periodikisht raportet mbi personat, afatet e plotësimit dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatueshmëria e ligjit mbi deklaramin e interesave personale dhe është vijuar me dërgesat brenda afateve dhe strukturës së miratuar.
- Është dërguar raporti mbi veprimtarinë vjetore të punës së institucionit të vitit 2012 lidhur me ushtrimin e kompetencave ligjore, ndjekjen e hapave të vazhdueshëm për plotësimin dhe

dorëzimin brenda afateve të përcaktuara në ligj të deklaratave të interesave private periodike/vjetore për të gjithë zyrtarët që mbartin detyrimin për deklarimin e tyre, duke përfshirë dhe përditësimin e listës së zyrtarëve që mbartin detyrimin e mësipërm.

- Janë kryer zëvendësimet e Autoritetit përgjegjës dhe për to është vënë në dijeni institucioni përkatës.
- Në vijim të strategjisë mbi burimet njerëzore, vlen të përmendet bashkëpunimi eficient dhe kontakti i vazhdueshëm me institucionet e trajnimeve për hartimin e programeve të trajnimit mbi bazën e kërkesave të stafit, si dhe në zbatim të strategjisë “Për trajnimin e zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave” si dhe “Strategjisë institucionale për vitin 2012-2013”.
- Është hartuar e miratuar plani i trajnimeve për vitin 2013 dhe mbi bazën e tij janë ndjekur dhe çertifikuar nga Instituti i Trajnimeve të Administratës Publike, (ITAP/aktualisht ASPA), një pjesë e stafit. Stafi i KMDP ka marrë pjesë edhe në trajnime e takime të tjera të organizuara nga institucione të tjera shtetërore si AKSHI. Në rastin konkret pranë këtij të fundit është trajnuar stafi i teknologjisë së informacionit. Mund të themi se nga rakordimet me ASPA dhe AKSHI numri i punonjësve të trajnuar është **7, me ditë trajnimi rreth 20 ditë**. Krahasimisht me vitin e kaluar, numri i punonjësve të trajnuar nga këto institucione është me i vogël, pasi mundësitë e institucioneve trajnuese të administratës publike dhe kushtet aktuale të situatës së përgjithshme të vitit 2013, kondicionuan tkurrjen e tyre.
- Në vijim të këtij prioriteti theksojmë bashkëpunimin e frytshëm me Projektin EU/ IPA - 2009, FIIAPP në drejtim të forcimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore. Në kuadër të projektit, Janar-Qershor 2013, një nga komponentet e tij ka qenë dhe trajnimi i stafit, hartimi i kurrikulës për trajnimin e thelluar të personave të kontaktit/të ngarkuar si për kontrolluesit publikë ashtu edhe privatë. Janë trajnuar nëpunës të stafit, çertifikuar në cilësinë e trajnerëve për mbrojtjen e të dhënave personale të cilët më pas kanë vijuar, në 6 mujorin e dytë me trajnimin e personave të kontaktit/të ngarkuar të kontrolluesve publikë, në ambjentet e ASPA.
- Në kuadër të forcimit dhe zhvillimit të bashkëpunimit me dhe midis menaxherëve kryesorë të fondeve publike, është kryer regjistrimi në Forumin në fushën e menaxhimit financiar dhe Kontrollit, ngritur pranë Minsitrisë së Financave, me “target grup” nëpunësit Zbatues.

#### ■ Motivimi i punonjësve.

- Lidhur me motivimin e punonjësve janë ndjekur procedurat për përdorim të fondit të veçantë pranë Ministrisë së Financave, akordimin, transferimin në muajin respektiv, në zbatim të VKM nr.929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” i ndryshuar, pika 7, “Për shpërblimin me rastin e daljes në pension pleqërie dhe ndihmës së menjëhershme financiare për raste fatkeqësish, si dhe kryerja e pagesës në llogaritë personale”.

- **Ndikim në rritjen e efektivitetit në punë ka dhënë edhe procesi i vlerësimit të arritjeve individuale të punonjësve, si pjesë e politikës nxitëse dhe motivuese për ta.**

Vlerësimi i arritjeve individuale të nëpunësve civilë, nga eprorët direkt si dhe të konfirmuara nga zyrtari Autorizues, është kryer në zbatim të udhëzimit nr. 2, datë 7/07/2000, “Per sistemin e vlerësimit të arritjeve vjetore individuale të nëpunësit civil”, i ndryshuar me udhëzimin nr.5 datë 19.12.2007.

Pas përfundimit të procesit, formularët e vlerësimit janë administruar në dosjet e personelit.

Janë vlerësuar 20 punonjës me nivelin shumë mirë -1

Është vlerësuar 1 punonjës me nivelin mirë -2

Janë vlerësuar 2 punonjës me nivelin jo mjaftueshëm -4

Nuk ka patur shpërbllim financiar, në zbatim të VKM nr.591, datë 10.07.2013 “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore , për vitin 2013”.

- Janë zbatuar vendimet e qeverisë, lidhur me rritjen e pagave, me efekte financiare nga 15 Korriku 2013, për nivelin e nëpunësve civilë dhe atyre mbështetës, e konkretisht:

1. Njohja, respektimi dhe zbatimi i VKM nr. 581, datë 17/07/2013 “Për disa ndryshime në VKM nr.1114, datë 30.07.2008 “Për disa çështje në zbatim të Ligjeve nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Njohja, përgatitja dhe reflektimi i VKM nr.598, datë 17.07.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në V.K.M nr.545, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparateve të ministrive të linjës, disa institucioneve të pavarura, institucioneve në varësi të Kryeministrit dhe Ministrive të linjës” i ndryshuar.
3. Njohja, respektimi dhe zbatimi i Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.23, datë 30.07.2013 “Për disa shtesa e ndryshime në Udhëzimin nr.5, datë 30.06.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar.
4. Njohja, përgatitja dhe reflektimi i V.K.M nr.610, datë 24.07.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në V.K.M nr.717, datë 26.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore”, i ndryshuar.

- Është ndjekur procesi i planifikimit dhe kryerjes së pushimit vjetor të paguar të punonjësve, në zbatim të Vendimit nr.463, datë 16.06.2011 “Mbi disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.511, datë 24.10.2002 të K.M “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr.16, datë 20.07.2011 mbi zbatimin e V.K.M së sipërcituar të Ministrisë së Financave.

## V.II MENAXHIMI FINANCIAR.

- Përmirësimi në menaxhimin e fondeve publike nëpërmjet planifikimit, zbatimit, përdorimit të tyre me efikasitet, dobi dhe efektivitet dhe monitorimit.

Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale, në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit është mbështetur në nevojat më të domosdoshme institucionale në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji organik mbi të cilat ushtron veprimtarinë e tij.

KMDP ka krijuar dhe monitoruar një sistem të menaxhimit financiar dhe kontrollit, i cili është mbështetur në legjislacionin në fuqi, konformë dispozitave të Ligjit nr.10296, datë 8/07/2010 “Mbi menaxhimin financiar e kontrollin” si dhe mbi parimet e menaxhimit të fondeve publike me efektivitet, transparencë, ekonomi dhe efikasitet.

Ky sistem ka dhënë garanci të arsyeshme për arritjen e objektivave nëpërmjet:

- Efektivitetit dhe efikasitetit të operacioneve;
- Pajtuëshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Besueshmërisë në raportimet financiare e menaxheriale;
- Mbrojtjes së aktiveve.

Gjatë procesit të planifikimit si dhe të realizimit të buxhetit të akorduar për vitin 2013, KMDP ka ndjekur dhe zbatuar kërkesat e Ligjit organik të saj, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe udhëzimeve në zbatim të tij, Ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligjit nr. 119/2012, datë 17/12/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, i ndryshuar, si dhe udhëzimeve përkatëse për zbatimin e tij.

Gjatë vitit 2013 është vepruar me korrektësi drejt një menaxhimi efikas financiar, proces i cili kalon në disa faza.

### ■ Planifikimi

- Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, në mbështetje të Udhëzimit nr.9, datë 22.02.2013 “Për përgatitjen e programit Buxhetor Afatmesëm 2014-2016”, janë planifikuar, përgatitur dhe dërguar formatet standart të kërkesave buxhetore të Fazës së I dhe të II-të të Projekt-Buxhetit afat-mesëm 2014-2016, për programin “Planifikim, menaxhim, administrim”, fazë e cila përfundoi më 29 Gusht 2013, pranë Ministrisë së Financave.
- Jemi përfaqësuar pranë Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të drejtat e Njeriut, lidhur me vërejtjet mbi planifikimin e Buxhetit të Vitit 2014 ku u parashtruan rezervat lidhur me këtë buxhet, kërkesat shitesë për plotësimin e zhvillimin e aktivitetit ekonomiko-financiar.

Referuar ligjit nr.185, datë 28.12.2013 “Për Buxhetin e vitit 2014” fondet krahasimisht me projekt buxhetin e vitit 2014, janë shtuar në masën 2.000 në mijë lekë, të cilat do të akordohen në zërat më prioritarë, sipas kërkesave me destinacion të përcaktuar.

- Kemi planifikuar dhe realizuar transferimet e fondeve në zërat e kërkuar, për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë, për transferime në buxhetet familjare, për organizime të aktiviteteve social- kulturore, dalje në pension apo shpërblime të tjera financiare.
- Janë rishikuar planet e detajuara në muaj për shpenzimet operative dhe investime për vitin 2013 si dhe është realizuar rishpërndarja e tyre në muajt pasardhës ku ka spikatur angazhimi në përputhje me objektivat për realizimin e aktiviteteve .
- Është zbatuar akti Normativ nr. 6, datë 04/10/2013 “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 119/2012, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2013”, duke detajuar ndryshimet sipas klasifikimit buxhetor deri në nivel artikulli.
- Është bashkëpunuar me Drejtoritë në lidhje me planifikimin e nevojave për mbështetje financiare në funksion të përmbushjes së misionit të njësisë sonë organizative dhe objektivave operacionale, procedurë e cila i parapriu procesit të planifikimit të shpenzimeve, mbi baza objektivash, produktesh, në sasi e vlerë.
- Në fushën e menaxhimit financiar, është respektuar legjislacioni në fuqi, gjë e cila është reflektuar dhe në raportin Vjetor 2012, për vlerësimin e sistemit ekzistues të menaxhimit financiar si dhe cilësisë së sistemeve të kontrollit. Është plotësuar pyetëtori i vetëvlerësimit për vitin 2012, në zbatim të Ligjit nr.10296, datë 8/07/2010 “Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
- Detajimi i shpenzimeve si dhe planit të arkës të vitit 2013, në nivel mujor, ndarë në shpenzime personeli dhe shpenzime të tjera është mbështetur në shpërndarjen sipas përqindjeve të parashikuara nga Ministria e Financave, mbështetur në Ligjin nr. 119/2012, datë 17.12.21012 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2013”, si dhe Udhëzimit të përhershëm nr.2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”.
- Një raport i hollësishëm 12- mujor është dërguar pranë Agjensisë së Prokurimit Publik, mbi prokurimet publike e procedurat e ndjekura nga KMDP, në zbatim të Ligjit nr. 9643 “Për Prokurimet Publike” dhe të dispozitave ligjore financiare në fuqi gjatë vitit 2013.
- Në kuadër të zbatimit të detyrimit Ligjor të parashikuar në Ligjin nr.10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” është hartuar strategjia e riskur për vitin 2013 si dhe regjistri përkatës. Dokumenti është hartuar duke pasur parasysh objektivat kryesorë të se cilës drejtori si dhe risqet e evidentuara të cilat sjellin pasoja në përmbushjen e objektivave si dhe mundësojnë të qënurit aktiv në ndjekjen me rigorozitet për të arritur minimizimin e tyre, qoftë kur janë faktorë ndikues të brendshëm apo dhe të jashtëm. Dokumenti përmban dhe shkallën e

mundësisë së ndodhjes së ndikimit si dhe kontrollet që mund të ndërmerren për të ulur pasojat e tyre.

■ Zbatimi i buxhetit.

- Gjatë zhvillimit të aktivitetit të institucionit, nëpërmjet strukturave drejtuese, deri në vendimmarrje, në zbatim të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2013”, udhëzimeve përkatëse për zbatimin e tij, janë miratuar procedura, janë ngritur komisionet lidhur me zbatimin e procedurave standarde të blerjeve online, janë ndërmarrë veprime të cilat synojnë reduktimin e risqeve me synimin për të arritur objektivat e institucionit si dhe për të nxitur zbatimin e vendimeve të titullarit. Në vendosjen e aktiviteteve të kontrollit, ato janë ingranuar tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme janë krijuar.
- Institucioni ynë, konstaton se ka përmbushur kërkesat ligjore minimale dhe ka vënë në zbatim kontrole të përshtatshme në fushat e mëposhtme: ekzistencën e rregullave/urdhërave të brendshëm për përshkrimin e proceseve kryesore operationale dhe financiare, sistemin e firmës së dyfishtë; ruajtjen e aktiveve dhe ndarjen e detyrave; dokumentimin e të gjitha operacioneve, veprimeve dhe transaksioneve financiare si dhe procedura të tjera të miratuara në aktivitetin kryesor deri në vendimmarrje.
- Janë ndjekur procedurat e prokurimeve në mbështetje të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, udhëzimit nr.2 ”Për procedurën e blerjeve të vogla”.
- Në mbështetje të udhëzimit nr 1/1, datë 19.02.2013 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2013”, për sigurimin e një analize të plotë të zbatimit të buxhetit, janë plotësuar kërkesat e organeve monitoruese, lidhur me procedurat e regjistrimit të shpenzimeve të fondeve publike si dhe janë depozituar brenda afateve kohore informacionet e kërkuara lidhur me shpenzimet e përgjithshme operative (situacion mujor).
- Është ushtruar kontroll i vazhdueshëm i dokumentacionit, bazuar në kontrollet para e pas faktit, për rregullshmërinë ligjore dhe dokumentacion justifikues, dhënia e garancive dhe cilësisë së shërbimeve përmes përdorimit të fondeve me efektivitet, efikasitet e ekonomi, garantimi që të gjithë kreditorët të paguhen në kohë, referuar afateve të përcaktuara në marrëdhëniet kontraktuale.
- Gjithsej janë kryer 15 procedura me blerje të vogël në sistemin online, të cilat kanë rezultuar të suksesshme si dhe 15 procedura me metodën e kuotimit, nëpërmjet testimit të tregut.
- Për vitin 2013, në zbatim të Udhëzimeve të Ministrisë së Financave, janë reflektuar ndryshimet e legjislacionit të prokurimit gjatë hartimit të gjurmëve të auditimit lidhur me procedurat e prokurimeve me vlera të mëdha e të vogla.
- Në përmbushje të objektivave të KMDP-së për periudhën e raportuar, është miratuar fondi i përgjithshëm, referuar Ligjit nr.119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, i

## RAPORTI VJETOR 2013

### KMDP

ndryshuar, sipas tabelës dhe zërave të shpenzimeve si dhe paraqitja e realizimit, referuar planeve vjetore.

KMDP referuar buxhetit për vitin 2013, ka zbatuar politikat e saj ekonomike, për një menaxhim më të mirë dhe me efektivitet të shpenzimeve buxhetore, duke planifikuar shpenzimet e kontraktuara, për llogaritjen e shpenzimeve të konsumit të tonerave për printera dhe fotokopje, përlllogaritja e shpenzimeve operative për shërbimet: internet, telefoni, mirëmbajtja e pajisjeve elektronike, menaxhimi i fondit të pajisjeve për autoritetin e komisionerit, për sigurimin e standardeve në lidhje me to.

### **Tabela e akordimit të buxhetit dhe realizimi për vitin 2013**

Transferimet, ndryshimet e realizimet.

000 / lekë

Nr	EMËRTIMI	PLAN	% kundrejt totalit	Fakt 12 mujor	% realizimi kundrejt pl 6-m.
1	Paga	28.500	68	26.056	91 .
2	Sigurime shoqërore	4.500	11	4.031	90
3	Mallra e shërbime të tjera	7.638	18	7.637	100
4	Investime	1.000	2.3	983	98
5	Transferta të buxhetit familjar	486	1	486	100
6	<b>Kuotizacion</b>	87	0.2	86	99
	<b>Totali</b>	<b>42.211</b>	<b>100</b>	<b>39.281</b>	<b>93</b>

#### Paga dhe sigurime shoqërore (i referohet pikës 1 dhe 2 të tabelës)

Fondi i akorduar nga Buxheti i Shtetit për paga dhe sigurime shoqërore, ishte 33.000 në mijë lekë. Ky fond përputhej me kërkesën dhe ishte i mjaftueshëm për të mbuluar nevojat e institucionit, sipas strukturave dhe organikës, por si rezultat i mosplotësimit në kohë të strukturës, largimit të punonjësve me dorëheqje por dhe me masa disiplinore si dhe dështimit të procedurave të konkurimit, gjatë vitit realizimi është në masën 91 % (paga e sigurime shoqërore), gjë që influencon në realizimin e përgjithshëm të buxhetit të akorduar.

#### Shpenzime operative (i referohet pikës 3 të tabelës më sipër)

Fondi për shpenzime Operative (zëri 602), nga vlera e përgjithshme prej 7638 (në mijë lekë) për periudhën e raportuar, është prokuruar dhe realizuar në masën 7637.6 në mijë leke ose 100 % e fondit të planifikuar vjetor, duke respektuar kërkesat e detajuara në Regjistrin e Prokurimeve Publike, të deklaruar në Agjensinë e Prokurimit Publik.

Regjistri i prokurimeve me ndryshimet, është realizuar në përmbushje të objektivave dhe strategjisë së miratuar për Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2013, e ndarë në produktet, të cilat u mbështetën financiarisht me fondet e alokuara nga Ministria e Financave.

Gjatë vitit 2013 në lidhje me performancën financiare kemi evidentuar nevojat më emergjente si dhe janë rishikuar objektivat dhe aktivitetet e drejtorive, në zbatim të Aktit Normativ nr.6, datë 4/10/2013 i cili kondicionoi rishpërndarjen e fondeve në zëra buxhetore, sipas kërkesave të drejtorive.

Në zbatim të legjislacioneve në fuqi, në fushën financiare e konkretisht në zbatim të Ligjit nr.9477, datë 09/02/2006 “Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” është kryer evidentimi dhe hedhja në sistemin e programit financiar të çdo transaksioni në mënyrë kronologjike gjë që krijon mundësinë e një analize të plotë financiare për çdo zë shpenzimi në raport me shpenzimet e përgjithshme dhe jep një pasqyrim sa më të saktë të çdo tejkalimi apo efektiviteti dhe mundësi për rialokime në zëra të tjerë të domosdoshëm, në përmbushje të realizimit të detyrave dhe objektivave, të parashikuara në strategji.

Janë menaxhuar me kujdes dhe është likuajduar çdo detyrim për shërbimet e përgjithshme siç janë ato te elektricitetit, ujit, telefonisë fikse e celulare.

Janë marrë të gjitha masat për të menaxhuar me kujdes dhe me ekonomi fondet publike, në drejtim të plotësimit të kërkesave për zhvillimin e aktiviteteve që kryen në kuadër të plotësimit dhe zbatimit të strategjisë së miratuar (seminare ndergjegjësuese në rrethe të ndryshme të vendit), si dhe për kryerjen e inspektimeve administrative brenda e jashtë rrethit, si dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Janë marrë masat për përfaqësimin e institucionit tonë në Konferenca e evente ndërkombëtare e rajonale, me burime njerëzore e financiare, të përdorura me efikasitet dhe ekonomi.

Në zbatim të legjislacionit në fushën financiare, janë ndjekur procedurat për inventarizimin e asetëve afat gjata e afat shkurtra, nëpërmjet komisioneve të ngritura, të cilat kanë ndjekur udhëzimet dhe procedurat e miratuara nga titullari, në mbështetje të udhëzimeve të Ministrisë së Financave për menaxhimin e aktiveve.

Fondi për shpenzime të tjera(kuotizacione+transferime në buxhete familjare). (i referohet pikës 5 dhe 6 të tabelës më sipër, zëri 605-606).

Për vitin 2013, është planifikuar në vlerën 450 në mijë lekë. Me ndryshimet e rialokimeve si dhe ndryshimet e rishikimit të buxhetit ky fond është në masën 573 në mijë lekë. Për periudhën 12 mujore, në total është realizuar në masën 573 ose 100 % e fondit të planifikuar dhe likuiduar sipas destinacionit të përdorimit.

**Analiza krahasuese 2012-2013 në lekë (shpenzime operative (602-606))**

Nr	EMËRTIMI	PLAN 2012	FAKT 2012	% realizimi	PLAN 2013	FAKT 2013	% realizimit
1	Mallra shërbime	9.310	9.097	98 %	7.638	7637	100 %
2	Transferta buxhetet familjare	458	458	100 %	486	486	100 %
	<b>Kuotizacion</b>	86	84	97.6%	87	87	<b>100 %</b>
	<b>Totali</b>	<b>9.854</b>	<b>9639</b>	<b>97.8%</b>	<b>8211</b>	<b>8209</b>	<b>100%</b>

Nga tabelat respektive shihet qartë një rritje e realizimit të përdorimit të fondeve publike, gjë që tregon se KMDP, referuar buxhetit të vitit 2013, ka rishikuar politikat e saj ekonomike, për një menaxhim sa më të mirë dhe me efektivitet të shpenzimeve buxhetore, duke planifikuar shpenzimet e kontraktuara si dhe shpenzimet e tjera, më të domosdoshme dhe imediate.

▪ **Shërbime të përgjithshme.**

- Gjatë gjithë vitit janë ndjekur procedurat në lidhje me shërbimet e nevojshme, të përgjithshme të institucionit, siç janë ato të kompanisë ÇEZ, Ujësjellës-Kanalizime Sha. Albtelekom, Shoqërisë Eagle Mobile me shërbimin e ofruar prej tyre, defektet e ndodhura dhe riparimin e tyre në kohë e me cilësi, për garantimin dhe funksionimin normal të veprimtarisë së KMDP.
- Në kuadër të ndihmesës së publikut, lidhur me ankesat që mund ti drejtohen KMDP-së si dhe për trajtimin e tyre me shpejtësi dhe efikasitet, në kuadër të transparencës së aktivitetit të KMDP-së, përmes caktimit të numrit pa pagesë për publikun ( numër jeshil ), pas ndjekjes së procedurave me Autoritetet përkatëse, është monitoruar funksionimi i tij (numrit) si dhe janë shlyer detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i kontratës së lidhur me institucionin përkatës.
- Vlen të theksohet bashkëpunimi dhe mirëkuptimi midis Drejtorive lidhur me menaxhimin e mjetit në dispozicion sipas një grafiku të lëvizjeve dhe përbushjes së shërbimeve, si dhe është ndjekur periodikisht menaxhimi i karburantit.
- Janë ndërmarrë masat dhe janë kryer të gjitha procedurat e kalimit në pronësi të automjetit tip Benz Mercedes, në zbatim të Urdhërit nr.377, datë 12.12.2012 të Ministrit të Brendshëm “Për transferim pa pagesë automjeti”. Pas kalimit në pronësi të automjetit, është realizuar rivlerësimi i tij me koston e përcaktuar nga deklaratat doganore, mbi bazën e së cilës llogaritet amortizimi i tij vjetor.

- Mbi bazën e kërkesës dhe miratimit të fondeve janë kryer pagesat e zhdoganimit të tij si dhe procedurat për pajisjen me leje qarkullimi, taksa vjetore, siguracionin e detyrueshëm vjetor (TPL). Mjeti tashmë është në pronësi të KMDP-së dhe plotëson nevojat për lëvizje të stafit, brenda e jashtë qytetit të Tiranës.

Investimet (i referohet pikës 4 të tabelës së akordimit dhe realizimit të buxhetit)

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave personale, në bazë dhe për zbatim të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike të vitit 2013, për periudhën 12 mujore ka prokuruar:

**Fondi për shpenzime për investime (zëri 231), nga vlera e përgjithshme prej 1,000 (në mijë lekë) për periudhën e raportuar, është prokuruar dhe realizuar në masën 983.422 lekë, në mijë lekë ose 98 % e fondit të planifikuar vjetor.**

Gjatë vitit 2013, një nga detyrat parësore dhe prioritare ka qenë ndjekja e realizimit të procedurave të prokurimeve në mbështetje të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, udhëzimit nr.2, datë 28/03/2013 “Për procedurën e blerjeve të vogla” i ndryshuar, në mënyrë elektronike, mbi bazën e kërkesave dhe fondeve të alokuara sipas projekteve të miratuara për investime e konkretisht janë realizuar investimet e mëposhtme:

- Ndjekja dhe përfundimi i procedurave “**Blerje orendi zyre**”, për plotësimin e kushteve optimale të përshtatshme të punës së punonjësve, mobileri të ambienteve të arkivës, me rafte komode për ruajtjen dhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore si dhe të plotësimit të kërkesave të nëpunësve me orendi ( karrige ekologjike ), pajisje me kondicioner të zyrave. Janë planifikuar **457** (në mijë lekë) me TVSH dhe janë realizuar nga ky fond shuma prej **447** (në mijë lekë) ose rreth 98 % e fondit të planifikuar.
- Ndjekja dhe përfundimi i procedurave “**Blerje pajisje kompjuterike**” është realizuar me procedurën e blerjeve të vogla - blerja e aktiveve më të domosdoshme për punonjësit. Fondi i alokuar nga Ministria e Financave në Projektin M890010(**480 në mijë lekë**) është realizuar në shumën **474 (në mijë lekë)** ose rreth 99 % e fondit të planifikuar. Diferencat janë për shkak të proceduarve të prokurimit.
- Ndjekja dhe përfundimi i procedurave “**Zhdoganim mjeti**” në projektin M890009 i cili mundësoi kalimin në pronësi të mjetit TIP Benz, të marrë nga Drejtoria e Rezervave të Shtetit me procedurën e Kalimit Kapital Fondi i alokuar nga Ministria e Financave në shumën **63 (në mijë lekë)** është realizuar në shumën 62 (në mijë lekë) pra rreth 98 % e fondit të planifikuar.

**Analiza krahasuese e zërit investime.**

## RAPORTI VJETOR 2013

### KMDP

Nr	EMËRTIMI	PLAN 2012	FAKT 2012	% realizimi	PLAN 2013	FAKT 2013	% realizimit
1	Investime	3000	1972	65 %	1000	983	98 % .
	<b>Totali</b>	<b>3000</b>	<b>1972</b>	<b>65%</b>	<b>1000</b>	<b>983</b>	<b>98 %</b>

Siç shihet në tabelën krahasuese realizmi në zërin investime, për vitin 2013, është në masën 98 %. Po kaq është edhe në vitin 2012, pasi pjesa tjetër është kursim nga procedurat e prokurimit publik, nëpërmjet organizmit të tenderit online, fond i cili u derdh në buxhetin e shtetit.

#### ■ Monitorimi.

- Në kuadër të transparencës së përdorimit të fondeve publike si dhe të detyrimit ligjor të publikimit në faqen e Web-it, në postin Raportime, është dërguar dhe publikuar informacioni mbi monitorimin e shpenzimeve publike për periudhën 12-mujore, pranë Ministrisë së Financave, në zbatim të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në mënyrë periodike, çdo 3-mujor, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga organet monitoruese.
- Është hartuar dhe dërguar Raporti i hollësishëm 12- mujor pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, mbi prokurimet publike e procedurat e ndjekura nga KMDP, në zbatim të Ligjit nr. 9643 “Për Prokurimet Publike” dhe të dispozitave ligjore financiare në fuqi .
- Janë dërguar raporte periodike pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, mbi realizimin e fondeve dhe procedurave publike të ndjekura gjatë vitin 2013.
- Janë përgatitur, rakorduar llogaritë vjetore si dhe janë plotësuar pasqyrat financiare, me anekset përkatëse, mbi gjendjen e aseteve fikse e qarkulluese si dhe gjendjen financiare në fund të vitit 2012, në zbatim të Ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi, brenda afateve kohore të përcaktuara në to(28 shkurt).
- Në zbatim të Legjislacionit në fushën financiare, janë miratuar ndryshimet e gjurmëve të auditimit të procedurave me blerje të vogla, në mbështetje të udhëzimeve të reja për procedurat e prokurimit online.

#### **Analiza e Buxhetit në vite 2010-2013**

Vitet	Plan Vjetor	Buxheti i rishikuar me ndryshime	Fakt vjetor	% realizimit
2010	51.000	48.140	43.384	90%
2011	45.900	44.100	41.972	95 %

## RAPORTI VJETOR 2013

### KMDP

2012	45.177	43.750	42.468	97 %
2013	44.111	42.211	39.281	93 %

Nga sa shihet në tabelën e mësipërme, realizimi i buxhetit ka pësuar rritje nga viti në vit, çka tregon se janë përbushur nevojat institucionale, ndërsa për vitin 2013, krahasimisht me vitin paraardhës 2012, realizimi i buxhetit në tërësinë e tij rezulton në rënie. Nga tabela respektive, shihet në vlerë absolute, se mosrealizimi në krahasim me vitin paraardhës 2012, kap shifrën e 4 % ose krahasuar me planin vjetor, realizimi është në masën 93 %.

Nga sa kemi analizuar çdo zë të shpenzimeve buxhetore për vitin 2013, referuar tabelave të mësipërme, mosrealizimi ka ardhur si pasojë e ndikimit të mosrealizimit të fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore, për të cilat janë dhënë dhe arsyet përkatëse.

#### ■ Të ardhurat e institucionit.

Për vitin 2013, të ardhurat nga veprimtaria e KMDP-se janë kryesisht nga :

**Gjobat e kamatat e vendosura në rastet e shkeljeve të zbatimit të detyrimeve ligjore, nga kontrolluesit, në shumën 949.00 lekë e konkretisht:**

- Gjobë e vendosur dhe e ekzekutuar vullnetarisht, për kontrolluesin Team Real Albania – WIKIKI , në shumën **500.000 lekë**
- Gjobë e vendosur dhe e ekzekutuar vullnetarisht, për kontrolluesin Mësonjëtorja, në shumën **30.000 lekë**
- Gjobë e vendosur dhe ekzekutuar nga Shoqëria Përmbartimore “Qarri” për kontrolluesin Medi Care, në shumën **48.000 lekë**
- Gjobë e vendosur dhe ekzekutuar nga Shoqëria përmbartimore “Qarri” për kontrolluesin, Posta Shqiptare sh.a, në shumën **48.000 lekë.**
- Gjobë e vendosur dhe ekzekutuar nga Shoqëria Përmbartimore “ZIG” për kontrolluesin, Hotel Grand, në shumën **48.000 lekë.**
- Gjobë e vendosur dhe ekzekutuar nga Shoqëria Përmbartimore “ZIG” për kontrolluesin “Vitrina “, në shumën **32.000 lekë.**
- Gjobë e vendosur dhe ekzekutuar nga Shoqëria Përmbartimore “ZIG” për kontrolluesin, Rreze Drite, në shumën **48.000 lekë.**
- Gjobë e vendosur dhe ekzekutuar nga Shoqëria përmbartimore “ZIG” për kontrolluesin “Qendra shëndetësore nr.1” , në shumën **24.000 lekë**
- Kamata e derdhur në favor të shtetit nga Shoqëria Përmbartimore “ZIG” është në shumën **96.000 lekë .**
- Gjobë e vendosur dhe ekzekutuar nga Shoqëria Përmbartimore “STRATI ” për kontrolluesin, XH @ L Konstruksion, në shumën **30.000 lekë**
- Gjobë e vendosur dhe ekzekutuar nga Shoqëria Përmbartimore “STRATI” për kontrolluesin Dhoma e Tregëtisë, në shumën **30.000 lekë.**
- Gjobë e vendosur dhe ekzekutuar nga Shoqëria Përmbartimore “STRATI” për kontrolluesin Hotel de Paris, në shumën **15.000 lekë.**

Të ardhura të tjera të krijuara në vitin 2013, por të trashëguara për vitin 2014, janë në shumën **187.287.50 lekë** konkretisht:

- Sponsorizim nga Shoqata Frankofone AFADP, në shumën 187.287.50 lekë

Gjithsej shuma e të ardhurave të lartpërmendura arrin në vlerën 1.136.287.50 lekë, të cilat në mbështetje të dispozitave në fuqi derdhen :

- 949.000 mijë lekë - derdhen 100 % në buxhetin e shtetit.
- 187.287.50 mijë lekë – trashëgohen për vitin 2014.

### **V.III SYNIMET PËR TË ARDHMEN.**

#### **■ Përmirësimi i burimeve njerëzore, teknike dhe organizative.**

Bazuar në synimet që do të realizohen duke filluar nga viti 2014 e në vazhdim kemi detyrimin të investojmë vazhdimisht në rritjen e kapaciteteve njerëzore, teknike dhe organizative. Kjo do të arrihet nëpërmjet:

- Zbatimit të një politike efektive të trajnimit për të përmirësuar performancën dhe zhvilluar aftësitë profesionale të punonjësve të KMDP në fusha të përgjithshme, për t'i përmbushur në mënyrë efikase detyrat e tyre dhe të institucionit.
- Promovimit dhe zhvillimit të trajnimit afatshkurtër dhe afatgjatë në Shkollën e Trajnimit të Administratës Publike dhe ofruesve të tjerë të trajnimit si një mjet strategjik për zhvillimin e kapaciteteve të punonjësve të administratës së KMDP-së.
- Sigurimit të një sistemi të drejtë, transparent dhe të barabartë për menaxhimin e karrierës lidhur me emërimin, vlerësimin dhe ecurinë.
- Mbikëqyrjes së vazhdueshme të zbatimit të politikave të shërbimit civil (për rekrutimin e një stafi civil jo-politik, profesional, bazuar në merita dhe i menaxhuar mirë).
- Zbatimit rigoroz të ndryshimeve në legjislacionin për shërbimin civil, për të mundësuar reduktimin e subjektivizmit në procesin e konkurrimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve të kualifikuar, gjatë procesit të konkurrimit.


■ Menaxhimi sa më efektiv i burimeve financiare.

Ky do të arrihet nëpërmjet :

- Forcimit, bashkëpunimit dhe përfshirjes së të gjithë menaxherëve në lidhjen logjike planifikim, buxhetim, monitorim, raportim.
- Përmirësimit të planifikimit dhe administrimit të mirë të burimeve financiare publike përmes zbatimit dhe konsolidimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me standardet e miratuara kombëtare e ndërkombëtare, planifikimit realist, buxhetimit, dhe ekzekutimit efikas, përmirësimit të performancës dhe rritjes së efikasitetit të kontrollit të brendshëm.
- Zhvillimit të sistemit të buxhetimit dhe kontabilizimit për të siguruar shpërndarjen dhe matjen e saktë të kostove të aktiviteteve në funksion të realizimit të objektivave.

## VI. PËRMBAJTJA E TABELAVE DHE GRAFIKËVE

### KRAHASIM I AKTIVITETEVE VITI 2012 ME 2013.




Viti →	2012	2013
Aktivitetet/Seminare	22	15
Me të rinjtë	7	6
Totali	29	21

### KRAHASIM I SITUATËS SËE SHIKUESHMËRISË TË FAQES ZYRTARE TË INTERNETIT TË KMDP-SË.

	Vizitoret Unik 2012	Vizitoret Unik 2013
Janar	489	1457
Shkurt	544	1624
Mars	565	1764
Prill	689	2162
Maj	778	1997
Qershor	600	1827
Korrik	770	1718
Gusht	1013	1389
Shtator	1227	1796
Tetor	1577	2077
Nentor	1484	2581
Dhjetor	1145	3072
Total	10881	23464


**RAPORTI VJETOR 2013**  
**KMDP**




**TË DHËNA STATISTIKORE MBI VEPRIMTARINË E NJOFTIM/REGJISTRIMIT.**

	Viti 2009	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Totali i 5 viteve
<b>Sensibilizime</b>	290	5867	5586	3511	2011	17265
<b>Njoftime</b>	37	1199	1038	1230	582	4086
<b>Regjistrime</b>	30	1012	871	1463	667	4043



### Sensibilizime






### Njoftime



### Regjistrime






KUADRI LIGJOR KRAHASIM VITI 2012-2013.




## RAPORTI VJETOR 2013

### KMDP



HETIM-INSPEKTIMI

VITI ↓	Ankesat me shkrim të trajtuara nga DH-I	Kontrollet dhe Inspektimet Administrative	Masat Administrative (Gjobja)	Rekomandime	Urdhëra	Vendime të ndërmjetme
2009	16	-	-	-	-	-
2010	13	25	13	15	2	-
2011	17	37	19	23	-	-
2012	22	91	10	42	13	1
2013	26	213	7	55	26	1



## Gjobat e Kamatat

